

UNIVERSITETI I EJL - FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE SHKENCAVE POLITIKE  
SEE UNIVERSITY -FACULTY OF PUBLIC ADMINISTRATION AND POLITICAL SCIENCES



STUDIME TË DOKTORATËS (PHD) – CIKLI I TRETË

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore “Doktor ”

TEZA E DOKTORATËS:

**”Qëndrimet e mësimdhënësve kosovarë ndaj kornizës së kurrikulës së arsimit  
parauniversitar 2016-2021 dhe qasjes së saj integruese Evropiane”**

Mentori:  
Prof. Dr. Abdulla Azizi

Kandidatja:  
Valbona Hyseni

Tetovë, qershor 2019

## **Deklaratë statutore**

Nën përgjegjësinë time deklaroj se kjo tezë është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Valbona HYSANI

---

**”QËNDRIMET E MËSIMDHËNËSVE KOSOVARË NDAJ KORNIZËS SË  
KURRIKULËS SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2016-2021 DHE QASJES SË SAJ  
INTEGRUESE EVROPIANE”**

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore “Doktor ”

Nga: MA. Valbona Hyseni

Udhëhequr nga Prof.Abdulla Azizi

Juria e vlerësimit:

- 1.....KRYETAR
- 2.....Anëtar (Mentor)
- 3..... Anëtar
- 4..... Anëtar
- 5..... Anëtar

Tetovë, 2019

## Përmbajtja

Lista e tabelave.....	3
Lista e grafikëve.....	4
Shtylla grafike.....	7
Shkurtesat.....	8
Abstrakt (shqip).....	9
Abstrakt (anglisht).....	10
<b>1. Hyrje.....</b>	<b>11</b>
1.1 Formulimi i problemit .....	12
1.2 Qëllimi i hulumtimit .....	13
1.3 Pyetjet e hulumtimit/hipotezat e ngritura .....	13
1.4 Metodologjia e hulumtimit.....	15
1.5 Kufizimet e metodave të hulumtimit.....	16
<b>2. KAPITULLI I - ARSIMI DHE ARSIMIMI.....</b>	<b>17</b>
2.1 Përkufizimet mbi arsimin dhe arsimimin.....	17
2.2.1 Arsimimi gjatë gjithë jetës.....	26
2.2.2 Arsimimi formal.....	27
2.2.2 Arsimimi joformal.....	28
2.2.3 Arsimimi autodidakt.....	31
2.2.4 Arsimimi tradicional.....	32
2.2.5 Arsimimi bashkëkohor.....	35
<b>3. KAPITULLI II - METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES .....</b>	<b>37</b>
3.1 Metodologjia e mësimdhënies tradicionale .....	37
3.2 Metodologjia e mësimdhënies bashkëkohore.....	38
3.2.1 Struktura për mësimdhënien dhe të nxënit aktiv.....	39
3.2.2 Fazat e strukturës.....	39
3.2.2 Teknikat e mësimdhënies bashkëkohore.....	41
3.2.2.1 Brainstorgming.....	41
3.2.2.2 Insert.....	42
3.2.2.3 Harta e të pyeturit.....	43
3.2.2.4 Kllasteri.....	43
3.2.2.5 Tabela e koncepteve.....	44
3.2.2.6 Ditaret e të nxënit.....	44
3.2.2.7 Kubimi.....	45
3.2.2.8 Diagrami i Venit.....	45
3.2.2.9 Pesëvargëshi.....	46

3.2.3 Mësimëdhënia bashkëkohore në shkollat e Kosovës nga paslufta e këtej.....	47
<b>4. KAPITULLI III - KURRIKULA ARSIMORE.....</b>	<b>55</b>
4.1 Definicionet mbi kurrikulën.....	55
4.2 Llojet e kurrikulës.....	58
4.3. Teoritë mbi kurrikulën.....	61
4.3.1 Pikëpamjet e Herbert Kliebard mbi kurrikulën.....	61
4.3.2 Pikëpamjet Michael Stephen Schiro mbi kurrikulën.....	63
4.3.3 Pikëpamjet e tjera mbi kurrikulën.....	64
4.4. Funksionet e kurrikulës në shoqërinë bashkëkohore.....	65
4.4.1 Kurrikula dhe tregu i punës.....	66
4.4.2 Kurrikula dhe edukimi qytetar.....	68
4.4.3 Kurrikula dhe sistemi politik dhe kulturor.....	69
<b>5. KURRIKULA KOSOVARE DHE LEGJISLACIONI.....</b>	<b>72</b>
5.1. Legjislacioni dhe dokumentet mbi kurrikulën.....	72
5.2 Ligji për Arsimin Parauniversitar të Kosovës (2011).....	74
5.3 Ligji për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës (2008).....	75
5.4 Ligji për përbërjen e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik (2006).....	76
5.5 Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë (2016).....	77
5.6 Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës (2016).....	78
5.7 Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës (2017).....	80
5.8 Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës (2016).....	83
5.9 Udhërrëfytyrë për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021.....	85
5.10 Kurrikula evropiane parauniversitare.....	86
5.11 Legjislacioni i Bashkimit Evropian mbi kurrikulën parauniversitare.....	88
5.12 Qasja Integruuese Evropiane e kurrikulës.....	89
5.14 Standardet evropiane mbi kurrikulën parauniversitare.....	92
5.15 Ndikimi i modeleve evropiane në kurrikulën kosovare.....	93
<b>6. KAPITULLI IV - REZULTATET E HULUMTIMIT.....</b>	<b>95</b>
3.1. Qëndrimet e mësimdhënësve në shkollat e nivelit klasor I-V ndaj ndryshimit të kurrikulave.....	97
3.1.1. Ndryshimet e kurrikulave.....	97
3.1.2. Modeli i kurrikulës së huaj si model kurrikular në Kosovë.....	100
3.1.3. Qëndrimet ndaj kurrikulës së vjetër dhe të re parauniversitare.....	102
3.1.4. Efekti i numrit të nxënësve dhe kohëzgjatjes së orës mësimore në zbatimin e kurrikulës së re.....	105
3.1.5. Numri i nxënësve në klasë dhe sfidat e zbatimit të kurrikulës.....	105
3.1.6. Ora e shkurtër mësimore dhe sfidat e zbatimit të kurrikulës.....	106

3.1.7. Trajnimi i mësimdhënësve dhe zbatimi i kurrikulës.....	109
3.1.8. Sfidat e zbatimit të kurrikulës.....	110
3.2.1. Sfidat më të mëdha në zbatimin e kurrikulës parauniversitare.....	111
3.2.2. Shpenzimi i kohës paraprake para zhvillimit të orës mësimore dhe kurrikula.,...	112
3.2.3. Ndikimi i llojit të kurrikulës në mësimdhënie dhe mësimnxënie.....	113
3.2.4. Efekti i përvojës në mësimdhënie dhe rezistenca ndaj kurrikulave të reja.....	114
3.2.5. Faktorët e tjerë në zbatimin efikas të kurrikulës.....	115
3.2.6. Efikasiteti i kurrikulës dhe lloji i lëndës mësimore.....	116
3.2.7. Efekti i përvojës në arsim si sfidë për pranimin e kurrikulës së re.....	118
3.2.8. Përshtatshmëria e kurrikulës dhe metoda e punës në grupe.....	119
3.2.9. Vlerësimi i nxënësve sipas kurrikulës.....	120
3.2.10. Tekstet shkollore-mësimore në zbatimin efikas të kurrikulës së re.....	122
3.2.11. Mjedisi kosovar dhe modelet kurrikulare evropiane.....	123
3.1. Qëndrimet e mësimdhënësve në shkollat e nivelit klasor VI-IX ndaj ndryshimit të kurrikulave.....	124
3.2.1. Ndryshimi i kurrikulave.....	124
3.2.2. Efekti i numrit të nxënësve dhe kohëzgjatjes së orës mësimore në zbatimin kurrikulës së re.....	131
3.2.3. Numri i mësimdhënësve dhe zbatimi i kurrikulës.....	134
3.2.4. Qëndrimet ndaj kurrikulës së re dhe të vjetër.....	135
3.2.5. Efekti i ndryshimit paraprak të teksteve mësimore para ndryshimit të kurrikulës.....	138
3.2.6. Trajnimi i mësimdhënësve për kurrikulën e re.....	139
3.2.7. Sfidat e zbatimit të kurrikulës.....	141
3.2.8. Shpenzimet në kohë për zbatimin e kurrikulës para mbajtjes së orës mësimore.....	142
3.2.9. Ndikimi i kurrikulës në cilësinë e mësimdhënies.....	143
3.2.10. Ndikimi i përvojës në arsim në pranimin e kurrikulave të reja.....	144
3.2.11. Faktorët e tjerë në zbatimin e kurrikulës.....	146
3.2.12. Lloji i lëndës dhe përshtatshmëria e kurrikulës.....	147
3.2.13. Koha e shpenzuar për përgaditjen e mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulës.....	148
3.2.14. Përshtatshmëria e kurrikulës dhe puna me nxënësit.....	149
3.2.15. Vlerësimi i nxënësve dhe kurrikula.....	150
3.2.16. Efektet e teksteve shkollore-mësimore për zbatimin efikas të kurrikulës së re.....	151
3.2.17. Infrastruktura shkollore dhe zbatimi i modeleve kurrikulare evropiane.....	152
3.3. SHQYRTIMI I HIPOTEZAVE DHE REZULTATET E HULUMTIMIT...154	
3.3.1. Sa ka dallime në qëndrimet ndaj kurrikulës parauniversitare, varësisht nga përvoja e mësimdhënësve në arsim?.....	154
3.3.2. A janë mësimdhënësit me përvojë më të gjatë se 10 vjet në arsim,	

më konservatorë në raport me reformat në kurrikulën parauniversitare?.....	155
3.3.3. Sa ndikon negativisht numri i madh i nxënësve për klasë në qëndrimet negative të mësimeve kosovare ndaj kurrikulës së re parauniversitare?.....	156
3.3.4. A kanë qëndrime më pozitive ndaj kurrikulës së re, mësuesit e shkollave fillore, apo mësuesit e shkollave të mesme?.....	157
3.3.5. Sa ndikon ora e shkurtër mësimore në rritjen e sfidave për zbatimin efikas të kurrikulës së re?.....	158
3.3.6. A do të duhej sipas mësimeve të zgjatej ora mësimore për t'u përshtatur me kurrikulën e re parauniversitare?.....	159
3.3.7. Sa shpenzojnë kohë mësuesit për t'i realizuar përgjegjësitë që kërkohen nga ta me kurrikulën e re?.....	160
<b>PËRFUNDIME</b> .....	161
<b>REKOMANDIMET</b> .....	169
<b>BIBLIOGRAFIA</b> .....	171
<b>LITERATURA</b> .....	171
<b>BURIMET ELEKTRONIKE</b> .....	173
<b>SHTOJCA 1 – PYETËSORI</b> .....	176

## LISTA E TABELAVE

1. Tabela 1. Kriteret për analizën e formave të arsimit. <i>Burimi: Melnic&amp;Botez, 2014</i> .....	24
2. Tabela 2: Lëndët e shpërndara sipas kurrikulës jugosllave – <i>Burimi: Shema, 2000</i> .....	48
3. Tabela 3. Plani mësimor i zbatuar nga viti 1941/42. <i>Burimi: Veseli, 2003</i> .....	49
4. Tabela 4. Të dhënat e përgjithshme të respondentëve dhe zonës ku është zbatuar pyetësi gjatë hulumtimit.....	96
5. Tabela 5. Sfidat e zbatimit të kurrikulës.....	111
6. Tabela 6. Sfidat më të mëdha në zbatimin e kurrikulës sipas mësimdhënësve të klasës VI-IX.....	141



## LISTA E GRAFIKËVE

1. Grafikoni 1. Pasqyrë e përgjithshme e qëndrimeve të mësimdhënësve ndaj ndryshimeve të shpeshta të kurrikulave.....	97
2. Grafikoni 2. Qëndrimet e mësimdhënësve për ndryshimin e vazhdueshëm të kurrikulave.....	98
3. Grafikoni 3. Ndryshimi i kurrikulave në përputhje me rrethanat dhe mundësitë në Kosovë.....	99
4. Grafikoni 4. Qëndrimet ndaj modelit kurrikular të Shqipërisë si model për kurrikulën në Kosovë.....	100
5. Grafikoni 5. Qëndrimet e mësimdhënësve ndaj një kurrikule mbarëkombëtare shqiptare.....	100
6. Grafikoni 6. Qëndrimet e mësimdhënësve ndaj kurrikulës së shteteve skandinave.....	101
7. Grafikoni 7. Ndryshimi paraprak i teksteve mësimore-shkollore dhe ndryshimi i kurrikulës.....	101
8. Grafikoni 8. Shkalla e kënaqshmërisë së mësuesve-eve të klasës I-V me kurrikulën e re.....	102
9. Grafikoni 9. Shkalla e kënaqshmërisë së mësuesve-eve të klasës I-V me kurrikulën e vjetër.....	102
10. Grafikoni 10. Efektet e numrit të nxënësve në zbatimin e kurrikulës.....	103
11. Grafikoni 11. Ndikimi i orës së shkurtër mësimore në zbatimin e kurrikulës.....	104
12. Grafikoni 12. Zgjatja e orës mësimore prej 45 minutash në 60 minuta.....	105
13. Grafikoni 13. Matja e efektit të numrit aktual të nxënësve dhe orës aktuale mësimore në zbatimin e kurrikulës.....	106
14. Grafikoni 14. Rritja e numrit të mësimdhënësve.....	107
15. Grafikoni 15. Zbatimi i kurrikulës dhe shkalla e cilësia e trajnimit të mësimdhënësve.....	108
16. Grafikoni 16. Shkalla e profesionalizmit të trajnuesve për kurrikulë të re.....	108
17. Grafikoni 17. Efikasiteti i kohëzgjatjes së shkurtër të trajnimeve për kurrikulë.....	109
18. Grafikoni 18. Koha e shpenzuar para zhvillimit të orës mësimore dhe zbatimi i kurrikulës.....	109

19. Grafikoni 19. Ndikimi i kurrikulës në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.	110
20. Grafikoni 20. Vlerësimi i efektit të përvojës në mësimdhënie në pranimin apo refuzimin e kurrikulave të reja.	112
21. Grafikoni 21. Qëndrimet e respondentëve rreth faktorëve që ndikojnë në zbatimin e kurrikulës.	113
22. Grafikoni 22. Lloji i lëndës dhe përshtatshmëria e kurrikulës.	114
23. Grafikoni 23. Qëndrimet e mësimdhënësve rreth shpenzimit të kohës në përgatitjen teknike për kurrikulë.	115
24. Grafikoni 24. Efektet e përvojës në arsim si sfidë në pranimin e kurrikulës së re.	116
25. Grafikoni 25. Përshtatshmëria e kurrikulës dhe puna me nxënësit.	117
26. Grafikoni 26. Kurrikula dhe kriteret për vlerësimin e nxënësve.	118
27. Grafikoni 27. Vlerësimi me kurrikulën e vjetër dhe të re.	119
28. Grafikoni 28. Tekstet shkollore-mësimore dhe zbatimimi efikas i kurrikulës së re.	120
29. Grafikoni 29. Pasqyrë e përgjithshme e qëndrimeve të mësimdhënësve ndaj ndryshimeve të shpeshta të kurrikulave.	121
30. Grafikoni 30. Qëndrimet e mësimdhënësve për ndryshimin e vazhdueshëm të kurrikulave.	122
31. Grafikoni 31. Ndryshimi i kurrikulave në përputhje me rrethanat dhe mundësitë në Kosovë.	124
32. Grafikoni 32. Qëndrimet ndaj modelit kurrikular të Shqipërisë si model për kurrikulën në Kosovë.	125
33. Grafikoni 33. Qëndrimet e mësimdhënësve ndaj kurrikulës së shteteve skandinave.	126
34. Grafikoni 34. Qëndrimet e mësimdhënësve ndaj një kurrikule mbarëkombëtare shqiptare.	127
35. Grafikoni 35. Qëndrimet ndaj kurrikulës së vjetër dhe të re.	128
36. Grafikoni 36. Efektet e numrit të nxënësve në zbatimin e kurrikulës.	129
37. Grafikoni 37: Qëndrimet e mësimdhënësve të klasës VI-IX për efektet e orës së shkurtër mësimore në zbatimin e kurrikulës.	130
38. Grafikoni 38. Qëndrimet e mësimdhënësve të klasës VI-IX rreth zgjatjes së orës mësimore në 60 minuta.	131
39. Grafikoni 39. Qëndrimet e mësimdhënësve rreth efektit të numrit të nxënësve dhe orës mësimore për pengesa në zbatimin e kurrikulës.	132
40. Grafikoni 40. Rritja e numrit të mësimdhënësve dhe zbatimimi i kurrikulës.	133

41. Grafikoni 41. Qëndrimet e mësimdhënësve të klasës VI-IX ndaj kurrikulës së re.	134
42. Grafikoni 42. Qëndrimet e mësimdhënësve të klasës VI-IX ndaj kurrikulës së vjetër.....	135
43. Grafikoni 43. Qëndrimet ndaj ndryshimit paraprak të teksteve mësimore dhe ndryshimit të mëvonshëm të kurrikulës.....	136
44. Grafikoni 44. Qëndrimet ndaj trajnimit të mësimdhënësve për kurrikulë dhe zbatimin të kurrikulës.....	138
45. Grafikoni 45. Qëndrimet ndaj trajnerëve për kurrikula.....	139
46. Grafikoni 46. Qëndrimet ndaj kohëzgjatjes së trajnimeve për kurrikulë.....	140
47. Grafikoni 47. Koha e shpenzuar para mbajtjes së orës mësimore dhe zbatimi i kurrikulës.....	140
48. Grafikoni 48. Qëndrimet mbi ndikimin e vetë kurrikulës në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.....	142
49. Grafikoni 49. Ndikimi i përvojës në arsim në pranimin e kurrikulave të reja.....	143
50. Grafikoni 50. Qëndrimet rreth sfidave për kurrikulën e re dhe lidhjes me përvojën në arsim.....	145
51. Grafikoni 51. Ndikimi i faktorëve të tjerë në zbatimin e kurrikulës.....	146
52. Grafikoni 52. Lloji i lëndës dhe përshtatshmëria e kurrikulës.....	147
53. Grafikoni 53. Koha e shpenzuar në kurrikulën e re.....	148
54. Grafikoni 54. Kurrikula dhe metodat e punës me nxënësit.....	149
55. Grafikoni 55. Shkalla e kënaqëshmërisë me kurrikulën për përcaktimin e kritereve për vlerësimin e nxënësve.....	150
56. Grafikoni 56. Vlerësimi me kurrikulë të vjetër dhe të re.....	151
57. Grafikoni 57. Tekstet shkollore dhe efekti i tyre në zbatimin eikas të kurrikulës së re.....	152
58. Grafikoni 58. Përputhja dhe mospërputhja e mjedisit kosovar me modelet kurrikulare evropiane.....	153
59. Grafikoni 59. Dallimet në qëndrimet rreth ndryshimit të kurrikulës, varësisht nga përvojat e mësimdhënësve në arsim.....	154
60. Grafikoni 60. Shkalla e refuzimit dhe pranimit të kurrikulës së re varësisht nga përvoja në arsim.....	155
61. Grafikoni 61. Ndikimi i numrit të madh të nxënësve në klasë në qëndrimet negative ndaj kurrikulës së re.....	156

62. Grafikoni 62. Matja e qëndrimeve pozitive varësisht nga cikli shkollor ku punojnë mësimeve.....	157
63. Grafikoni 63. Ndikimi i orës së shkurtër mësimore në rritjen e sfidave për zbatimin efikas të kurrikulës së re.....	158
64. Grafikoni 64. Zgjatja e orës mësimore deri në 60 minuta në zbatimin e kurrikulës..	159
65. Grafikoni 65. Koha e shpenzuar në zbatimin e kurrikulës para mbajtjes së një ore mësimore.....	160

## **SHTYLLA GRAFIKE**

1. Shtylla grafike 1. Qëndrimet rreth kushteve kosovare për zbatim të kurrikulave evropiane.....	11
--	----

## **SHKURTESAT**

AAAPK- Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional e Kosovës  
AAK- Agjencia për Akreditim e Kosovës  
AAP- Arsimit dhe Aftësimi Profesional  
AKK-Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
BE – Bashkimi Evropian  
DASH- Departamenti i Arsimit dhe Shkencës  
DESK- Designing an Education System for Kosovo  
DKA- Drejtoria Komunale e Arsimit  
EJL- Evropa JugLindore  
IPK- Instituti Pedagogjik i Kosovës  
KEAP- Këshilli i Ekspertëve për Arsimin Parauniversitar  
KEC- Qendra për Arsim e Kosovës  
KKK- Korniza Kurrikulare e Kosovës  
MASHT- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë  
MF – Ministria e Financave  
MIE – Ministria e Integritit Evropian  
MPMS- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
MTI- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
OECD- Organization for Economic Co-operation and Development  
PISA- Program for International Student Assessment  
PSAK- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016  
QKK- Qendrat e Kompetencës në Kosovë  
RKS- Republika e Kosovës  
SHFMU- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët  
SHML- Shkolla Mesme e Lartë  
TIK- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit  
UA -Udhëzim Administrativ  
ZHPM- Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve  
KE-Korniza Kurrikulare

## Abstrakt

*Kurrikula e Arsimit Parauniversitar konsiderohet një ndër sfidat më të mëdha për mësimdhënësit kosovarë, e veçanërisht ndryshimi i saj i vazhdueshëm. Varësisht nga lloji i qëndrimit që mbajnë vetë mësimdhënësit ndaj kurrikulës, varet edhe efikasiteti i zbatimit të saj. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), një ndër autoritetet kryesore dhe përgjegjëse për politikën arsimore në Kosovë, në dy dekadat e fundit, është përpjekur të ndjekë dinamikën e kohës bashkëkohore dhe evropiane, duke marrë modele nga shkollat e vendeve të ndryshme evropiane, për t'i vënë në zbatim në Kosovë. Reformat në arsimin parauniversitar janë vlerësuar gjithmonë edhe si reforma të Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar. Në vitin 2011, MASHT-i ka miratuar Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës (KKK) dhe në vitin 2016 sërish është rishikuar kjo kurrikulë, nëpërmjet të cilës synohet të mësohet me një Kurrikulum të Bazuar në Kompetenca, që ndër të tjera caktohen teknika vlerësuese që u mundësojnë nxënësve të demonstrojnë edhe aftësitë e tyre e jo vetëm njohuritë. Klasët e para dhe të gjashta, e në disa pilot-shkolla edhe klasët e treta dhe të katërta, kanë filluar fazën e aplikimit të Kurrikulës së Re të bazuar në kompetenca dhe vlerësime të përditshme. Me tërë këto ndryshime, mësimdhënësit kosovarë kanë qëndrime të ndryshme për Kurrikulën e fundit të Arsimit Parauniversitar. Prandaj, përmes këtij hulumtimi janë matur qëndrimet e mësimdhënësve me më pak se pesë vjet përvojë në arsimin parauniversitar, të atyre që kanë 10 vjet përvojë në arsim dhe tek ata/ato që kanë përvojë në arsim mbi 10 vjet. Metodologjia e përdorur për këtë hulumtim përfshiu një studim rasti me shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Prishtinës, përmes zbatimit të një pyetësori, analizën përmbajtjesore të dokumenteve të prodhuara nga MASHT-i dhe zbatimin e shkallës së Rensis Likertit për matjen e qëndrimeve. Hulumtimi tregoi se mësimdhënësit me përvojë më të gjatë në arsim, kanë qëndrime më kritike, më refuzuese dhe përballen me më shumë sfida në zbatimin e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në krahasim me mësimdhënësit me përvojë më të re, si dhe numri i madh i nxënësve ndikon në qëndrimet negative të mësimdhënësve ndaj Kurrikulës së re të Arsimit Parauniversitar.*

**Fjalët themelore:** *Qëndrime, politika arsimore, kurrikulum, sfida, reforma, metodologji, mësimdhënie, mësimdhënësit, përvojë.*

## Abstract

*The Pre-University Education Curriculum is considered one of the biggest challenges for Kosovo teachers, and especially its ongoing change. Depending on the type of attitude the teacher has on the curriculum, depends on the effectiveness of its implementation. The Ministry of Education, Science and Technology (MEST), one of the main authorities responsible for education policy in Kosovo in the last two decades, has tried to follow the dynamics of contemporary and European times, taking models from schools in different European countries, to implement them in Kosovo. Reforms in pre-university education are always valued as reforms of the Pre-University Education Curriculum. In 2011, MEST approved the Kosovo Curriculum Framework (KKK) and in 2016 this curriculum was revised, through which it is intended to be taught with a Competence Based Curriculum, which includes the evaluation techniques that were enable students to demonstrate their skills and not just knowledge. The first and sixth classes, and in some pilot schools, the third and fourth classes, have begun the application phase of the New Curriculum based on competences and daily assessments. With all these changes, Kosovar teachers have different attitudes to the last Curriculum of Pre-University Education. Therefore, this survey has measured the attitudes of teachers with less than five years of experience in pre-university education, those with 10 years of experience in education and those who have experience in education over 10 years. The methodology used for this research included a case study with primary and secondary schools in the municipality of Pristina through the implementation of a questionnaire, a substantive analysis of the documents produced by MEST and the implementation of the Rensis Likert scale for measuring attitudes. The research showed that teachers with longer experience in education have more critical, more refusing attitudes and face more challenges in the implementation of the Pre-University Curriculum compared to less experienced teachers, and the large number of students influence in the negative attitudes of teachers towards the new Curriculum of Pre-University Education.*

**Basic words:** Attitudes, educational policy, curriculum, challenges, reform, methodology, teaching, teachers, experience.

## 1. Hyrje

Menjëherë pas luftës së vitit 1999, në vitin 2001, u hartua Korniza e re Kurrikulare e Kosovës, përmes së cilës synohej t'i ofrohej një qasje integrale procesit arsimor në Kosovë. Por përsëri ndryshimet vazhduan të ndodhnin në sistemin arsimor kosovar, sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit, ku janë bërë një sërë risish në këtë sistem. Këtu përfshihen reformat në kurrikulë dhe në kornizën ligjore. Pas miratimit të Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës (KKK) në vitin 2011 dhe sërish në vitin 2016 është rishikuar kjo kornizë, qëndrimet e mësimdhënësve ndaj saj janë të ndryshme. Varësisht nga përvoja e mësimdhënësve në arsim, numri i nxënësve për çdo klasë, janë edhe llojet e ndryshme të qëndrimeve. Së këndejmi, ndryshimet e kurrikulës shoqërohen edhe me qëndrime të ndryshme të mësimdhënësve. Nëpërmjet KKK-së synohet që mësimdhënësve dhe nxënësve t'iu jepen më shumë kompetenca në zhvillimin e mësimin, duke u caktuar teknika vlerësuese që u mundësojnë nxënësve të demonstrojnë jo vetëm njohuritë por edhe aftësitë e tyre. Në hulumtimjanë matur qëndrimet e mësimdhënësve kosovarë rreth Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë dhe Qasjes Integruese Evropiane mbi kurrikulën, me theks të veçantë, studim rasti me mësimdhënësit parauniversitarë në shkollat e komunës së Prishtinës. Tezën e doktoratës e kemi strukturuar në katër kapituj. *Në kapitullin e parë*, së pari kemi shqyrtuar përkufizimet mbi arsimin dhe arsimimin, llojet e arsimimit, arsimimin gjatë jetës, arsimimin formal dhe joformal, autodidakt, tradicional dhe bashkëkohor, duke konsideruar ndërlidhshmërinë e llojit të arsimimit dhe llojit të kurrikulës. *Në kapitullin e dytë*, kemi shpjeguar në përgjithësi rreth metodologjisë së mësimdhënies, metodologjisë bashkëkohore e tradicionale, pasi që Kurrikula e Arsimit Parauniversitar varet edhe nga vetë tipi i metodologjisë së mësimdhënies. *Në kapitullin e tretë*, kemi zbërthyer nocionet mbi kurrikulën, llojet e kurrikulës, pikëpamjet e ndryshme teorike mbi kurrikulën, e veçmas pikëpamjet e Herbert Kliebard dhe Michael Stephen Schiro mbi kurrikulën. Në këtë kapitull është analizuar edhe raporti i kurrikulës me tregun e punës, edukimin qytetar, sistemin politik, etj.; kuadrin ligjor, udhëzimet, dokumentet dhe doracakët e miratuar nga MASHT-i, e veçanërisht me analizën e përmbajtjes së Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Kosovës, Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe të Mesëm të Ulët dhe Udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021, si dhe janë prezantuar rezultatet e tërësishme të hulumtimit dhe diskutimi i tyre. Ndërsa në *kapitullin e katërt dhe të fundit*, janë paraqitur rezultatet e hulumtimit empirik në shkollat e komunës së Prishtinës,



numri i nxënësve, infrastruktura fizike, kurrikula dhe tregu i punës, krahasimi i qëndrimeve të drejtorëve të shkollave dhe mësimitdhënësve rreth sfidave, si dhe dallimet e qëndrimeve të mësimitdhënësve me përvojë të gjatë me mësimitdhënësit e rinj. Pjesa e fundit, paraqet përmbledhjen e përfundimeve dhe rekomandimeve të hulumtimit, si dhe pason me literaturën dhe shtojcat e këtij hulumtimi.

## 1.1 Formulimi i problemit

Në hapësirën publike kosovare, e veçanërisht në medie, shpesh është thënë në diskutime të ndryshme se në arsimin parauniversitar janë bërë shumë eksperimente dhe reforma, duke mos u zbrëthyer arsyet dhe sfidat në zbatimin e kurrikulës. Duke kërkuar për çështjen e studimit tonë, kemi vërejtur se mungojnë po ashtu studimet shkencore rreth qëndrimeve të mësimitdhënësve ndaj kurrikulës së arsimit parauniversitar. Matja direkte e qëndrimeve të mësimitdhënësve ndaj kurrikulës na tregon më hollësisht për sfidat e zbatimit të kurrikulës së re. Mësimitdhënësit janë bartësit kryesorë të këtij procesi, ndonëse kurrikula është e miratuar nga MASHT-i. Prandaj, të kuptuarit shkencor rreth matjes së qëndrimeve të mësimitdhënësve, mund të ofron shumë informacione se cilat janë sfidat në zbatimin e kurrikulës.

Efikasiteti i zbatimit të kurrikulës varet direkt nga tipi i qëndrimit që mbajnë vetë mësimitdhënësit ndaj kurrikulës së re parauniversitare. Po ashtu, supozojmë se ka dallime të rëndësishme edhe në mesin e mësimitdhënësve ndaj kurrikulës dhe ato nuk janë homogjene. Mësimitdhënësit me përvojë më të gjatë në arsim, ka gjasa që më pak tërhiqen nga ndryshimet dhe priren për qëndrime më konservatore ndaj reformave dhe kurrikulave të reja universitare, prandaj krahasimi i mësimitdhënësve me përvojë më të gjatë dhe atyre me përvojë të re në arsimin parauniversitar, do të jepte shumë përgjigje të problemit të parashtruar në hulumtimin tonë, rreth asaj se cilat janë sfidat e zbatimit të kurrikulës së re parauniversitare dhe çfarë qëndrime mbajnë mësimitdhënësit ndaj këtyre kurrikulave dhe ndryshimeve të tyre sistematike që nga paslufta nga MASHT-i.

Duke parë deficitin e hulumtimeve kosovare rreth këtij problemi dhe diskutimi i këtyre çështjeve në medie vetëm tërthorazi, ne ofrojmë një formulim të ri të problemit, duke e gjetur problemin e kurrikulës, varësisht nga qëndrimet që kanë mësimitdhënësit ndaj kurrikulës.

Me fjalë të tjera, qëndrimet e mësimdhënësve ndaj kurrikulës janë të bazuara në përvojën e tyre në arsim, shkallës dhe shpejtësisë së përshtatjes në reformat në arsim, sfidave me numrin e madh të nxënësve për çdo klasë, orës së shkurtër mësimore dhe qëndrimeve të ndryshme konceptuale të kurrikulës dhe ndërlidhjes së dobët me tregun e sotëm të punës.

## 1.2 Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i punimit ishte matja e qëndrimeve të mësimdhënësve kosovarë ndaj Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar, duke vënë në objektiv të posaçëm shkollat e komunës së Prishtinës, komunën më të madhe në nivel vendi. Përmes këtij qëllimi, ne realizuam objektivat vijuese:

- Të përkufizuarit e nocioneve kryesore mbi arsimimin dhe kurrikulën;
- Matjen e qëndrimeve pozitive apo negative të mësimdhënësve kosovarë në përgjithësi ndaj kurrikulës parauniversitare;
- Të kuptuarit e shkallës së heterogjenitetit dhe homogjenitetit të mësimdhënësve ndaj kurrikulës;
- Gjetja e dallimeve të qëndrimeve varësisht nga përvoja e gjatë apo e shkurtër në arsim nga mësimdhënësit;
- Matja e ndikimit të numrit të madh të nxënësve për klasë në sfidat e zbatimit të kurrikulës parauniversitare;
- Ndikimin e orës së shkurtër mësimore si sfidë për aplikimin e kurrikulës së re;
- Numërimin e sfidave të tjera në zbatimin efikas të kurrikulës.

## 1.3. Pyetjet e hulumtimit / hipotezat e ngritura

Me hulumtimin e matjes së qëndrimeve të mësimdhënësve kosovarë ndaj Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës, ne iu kemi përgjigjur disa pyetjeve hulumtuese/kërkimore.

## **1. Pyetja kryesore e hulumtimit:**

*1. Cilat janë qëndrimet e mësimeve kosovare ndaj Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar dhe Qasjes Integruese Evropiane?*

### **Pyetjet ndihmëse:**

- 1.1 Sa ka dallime në qëndrimet ndaj kurrikulës universitare, varësisht nga përvoja e mësimeve në arsim?*
- 1.2 A janë mësuesit me përvojë më të gjatë se 10 vjet në arsim, më konservatorë në raport me reformat në kurrikulën parauniversitare?*
- 1.3 A janë optimistë dhe a i kanë vërejtur ndryshimet pozitive aktorët kryesorë të procesit, sikur janë veçanërisht mësuesit?*
- 1.4 Sa ndikon negativisht numri i madh i nxënësve për klasë në qëndrimet negative të mësimeve kosovare ndaj kurrikulës së re parauniversitare?*
- 1.5 A ka dallime në qëndrimet e mësimeve, varësisht nga niveli i sistemit arsimor? A kanë qëndrime më pozitive ndaj kurrikulës, mësuesit e shkollave fillore, apo mësuesit e shkollave të mesme?*

## **2. Pyetja e dytë kërkimore-shkencore:**

*2. Sa ndikon ora e shkurtër mësimore në rritjen e sfidave për zbatimin efikas të kurrikulës së re?*

### **Pyetjet ndihmëse:**

- 2.1. Sa ndikon kohëzgjatja e orës mësimore në zbatimin efikas të kurrikulës së re?*
- 2.2. A do të duhej sipas mësimeve të rritej ora mësimore për t'u përshtatur me kurrikulën e re parauniversitare?*
- 2.3. Sa shpenzojnë kohë mësuesit për t'i realizuar përgjegjësitë që kërkohen nga ta me kurrikulën e re?*

## 1.4 Metodologjia e hulumtimit

Metodat kryesore në hulumtim kanë qene: *metoda sasimore* dhe *metoda krahasuese apo komperative*. Metodologjia e hulumtimit, e tipit sasior (kuantitativ), u realizua duke zbatuar pyetësin e gjysmë-strukturuar, të përbërë me 15 pyetje. Pyetësi ishte me shumë pyetje të mbyllura, por nuk munguan edhe pyetjet e tipit të hapur. Gjatë formulimit të pyetjeve, kemi pasur parasysh edhe shkallën e Rensis Likertit, e cili kishte ofruar një shkallë të njohur për matjen e qëndrimeve rreth një çështjeje. P.sh., “Sa jeni të kënaqur me kurrikulën e arsimit parauniversitar?”, duke u shoqëruar me 7 shkallë vlerësimi, ku shkalla 1 tregon se respondentit “nuk është aspak i kënaqur”, ndërsa në shkallën 7, respondentit përgjigjet se “është shumë i kënaqur”. Në pyetësor, ndër të dhënat më të rëndësishme të respondentit, ishin ato që përputheshin edhe me pyetjet tona kërkimore-shkencore, si: mosha, gjinia, përvoja e mësimdhënësit/es në arsim, etj. Tek e dhëna mbi përvojën, i ndamë mësimdhënësit në tri grupe kryesore: mësimdhënësit me përvojë të gjatë mbi 10 vjet, me përvojë të mesme 5-10 vjet dhe me përvojë të re, nën 5 vjet përvojë në arsimin parauniversitar.

Metoda komperative u fokusua në krahasimin e kurrikulës kosovare me atë evropiane. Po ashtu, metoda kualitative, ishte jetë pjesë e hulumtimit. Analiza e përmbajtjes dhe studimi i literaturës ishin mjetet plotësuese në punën hulumtuese, duke analizuar të gjitha dokumentet e hartuara e të publikuara në faqen zyrtare të MASHT-it, por edhe literaturën në gjuhën angleze rreth kurrikulave në vendet e ndryshme të botës, për t'i krahasuar me kurrikulat e Kosovës.

Mostra e hulumtimit ishte mostër jo e rastit, e përbërë nga 300 respondentë mësimdhënës/e, me proporcion të barabartë gjinor, ku 100 pyetësorë u zbatuan në shkollat fillore, 100 në shkollat e mesme të ulëta dhe 100 në shkollat e mesme të larta në komunën e Prishtinës, duke përfshirë nivelet klasore nga klasa I deri në klasën XII. Shkollat fillore të komunës së Prishtinës, në të cilat u zbatuan pyetësorët ishin: «Pavarësia», «Xhavit Ahmeti», «Naim Frashëri». Ndërsa si shkolla të mesme të ulëta, pjesë e hulumtimit ishin shkollat vijuese: «Shkolla e Gjellbër», «7 Marsi» dhe «Xhemail Mustafa». Ndërsa shkollat e mesme të larta që u përfshinë në hulumtim ishin: «Sami Frashëri», «28 Nëntori» dhe «Abdyl Frashëri».

## 1.5 Kufizimet e metodave të hulumtimit

Kufizimet e metodave tona të hulumtimit janë në vetë llojin e metodave të përzgjedhura, apo qoftë në mungesën e hulumtimeve paraprake nga studiuesit kosovarë rreth kurrikulës parauniversitare, qoftë në mungesën e literaturës bazë në gjuhën shqipe.

Ndër kufizimet e para, ishte mungesa e materialit dhe literaturës shqipe që ndërlidhej me tezën, që krijonte vështirësitë gjatë hulumtimit, e veçanërisht aplikimit të analizës së përmbajtjes dhe studimit të literaturës. Sigurimi i materialit dhe literaturës lindi sfidat e punës hulumtuese, por kjo u plotësua kryesisht me literaturë të bollshme nga gjuha angleze, si dhe ligjet e dokumentet për kurrikulën parauniversitare, të publikuara në faqen zyrtare të MASHT-it, duke na krijuar kështu shumë lehtësime.

Në kuadër të trajtimit të tezës jemi shërbyer edhe me zbatimin e pyetësorit, si njëra nga teknikat kryesore sasiore në mbledhjen e disa të dhënave shumë të rëndësishme për punimin. Si kufizim dhe sfidë ishte hezitimi dhe mungesa e gatishmërisë së respondentëve mësimdhënës, të përgjigjen në pyetjet e parashtruara dhe karakteri i mundshëm subjektiv i përgjigjeve, pasi kishte gjasa të deklaroheshin se nuk kishin sfida, duke besuar se kështu tregonin se ishin kompetentë, profesionalë, etj., me gjasa duke paragjykuar se hulumtimi mund të vinte nga vetë shkollat, drejtorja e arsimit apo MASHT-i, për t'i testuar e monitoruar mësimdhënësit!

Kufizim tjetër ishte mungesa e kombinimeve të tjera metodologjike, si intervistat, krijimet e fokus grupeve, e kështu me radhë.

## 2. KAPITULLI I - ARSIMI DHE ARSIMIMI

### 2.1 Përkufizimet mbi arsimin dhe arsimimin

Në një nga fjalorët e gjuhës shqipe, të instaluar edhe në faqe interneti, fjalët “arsim” dhe “arsimim”, apo “arsimohem”, i gjejmë me këto kuptime: ARSIM *m.* Tërësia e njohurive dhe e shprehive që jepen me sistem e sipas një programi në shkolla e kurse të ndryshme për të mësuar e për të edukuar brezin e ri dhe masat e gjera punonjëse; sistemi i shkallëzuar nëpërmjet të cilit jepen këto njohuri; përhapja e diturive në masat, si një nga fushat e veprimtarisë shoqërore, arsimim. Arsimi popullor (kombëtar). Arsimi i përgjithshëm (profesional, politeknik...). Arsimi parashkollor. Arsimi tetëvjeçar (i mesëm, i lartë). Arsimi i ditës (i mbrëmjes, me korrespondencë). Arsimi falas. Arsimi me (pa) shkëputje nga puna. Format e arsimit politik. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Seksioni i arsimit. Inspektori i arsimit. U jap arsim. Marr arsim. Ka arsimin përkatës. (<http://www.fjalori.shkenca.org/>)

Ndërsa, fjalët *arsimim* dhe *arsimohem*, nënkuptojnë procesin e pasurimit me njohuri e dituri të reja.. ARSIMIM *m.* Veprimi sipas kuptimeve të foljeve ARSIMOJ, ARSIMOHEM. Arsimimi i gruas. Arsimimi në gjuhën amtare. ARSIMOHEM *vetv.* Marr arsim, pajisem me njohuri e dituri duke ndjekur një shkollë a një kurs. Arsimohet populli.”(www.<http://www.fjalori.shkenca.org/>)

Në *Fjalorin e pedagogjisë* (Osmani, 1983), *arsimi* përkufizohet si “sistem i caktuar njohurish dhe shprehish të përgjithësuara në shkencat mbi natyrën, shoqërinë dhe mendimin njerëzor, që jepen në mënyrë të planifikuar dhe të programuar në institucionet arsimore (shkolla, kurse, etj.), për të mësuar dhe edukuar brezin e ri dhe masat e gjera punonjëse; sistem i shkallëzuar nëpërmjet të cilit jepen njohuri, shkathtësi e shprehi; rezultati i përvetësimit të sistemit të njohurive, shprehive e shkathtësive i mishëruar në praktikën shoqërore.”(f. 38-39)

Ndërsa Jackson (2011), thotë se “arsimi është një proces i lehtësimit shoqëror i transmetimit kulturor.”(f.9)

Duke kërkuar disa përkufizime të edukimit dhe arsimimit, kemi gjetur edhe një listë të definicioneve të tyre nga personalitete të njohura nga Lindja dhe Perëndimi, prej kohërave të hershme e deri më sot. Në secilin prej definicioneve të mëposhtme, ne gjejmë ndonjë element të procesit të arsimimit apo edukimit.

“Nëse përmendim disa përkufizime të arsimit të edukatorëve të mëdhenj të Lindjes dhe të Perëndimit, ne mund të kemi një pasqyrë të qartë të natyrës dhe kuptimit të termit arsim.

•Arsimi është manifestimi i përsosmërisë veçse në njeri. Ashtu si zjarri në një copë stralli, dituria ekziston në mendje. Sugjestiononi është fërkimi; që e nxjerr atë jashtë. Sëami Vivekananda

• Me edukim nënkuptoj një tërheqje të gjithanshme nga më të mirat në trupin, mendjen dhe shpirtin e fëmijës dhe të njeriut. Mahatma Gandhi

• Arsimi më i lartë është ai që nuk na jep informacion, por e bën jetën tonë në harmoni me gjithë ekzistencën. Rabindranath Tagore

• Arsimi është diçka, që e bën një njeri të vetëdijshëm dhe të pavarur. Rigveda

• Arsimi është produkti përfundimtar i të cilit është shpëtimi. Upanishada

• Arsimi sipas traditës indiane nuk është thjesht një mjet për të fituar jetesën; as nuk është vetëm një çerdhe e mendimit ose një shkollë për qytetari. Është fillimi në jetën e shpirtit dhe stërvitjes së shpirtit njerëzorë në ndjekjen e së vërtetës dhe në praktikën e virtytit. Radhakrishnan

• Edukimi zhvillon në trupin dhe shpirtin e nxënësit të gjithë bukurinë dhe gjithë përsosmërinë që ai është i aftë për të. Platoni

• Arsimi është krijimi i mendjes së shëndoshë në një trup të shëndoshë. Ajo zhvillon vullnetin e njeriut, posaçërisht të tij në mënyrë që ai të jetë në gjendje të gëzojë meditimin e së vërtetës supreme, mirësisë dhe bukurisë. Aristoteli

• Arsimi është zhvillimi i fëmijës nga brenda. Rousseau

• Arsimi është mbikëqyrja e asaj që tashmë është e përfshirë në embrion. Është proces përmes të cilit fëmija bën të brendshmin - të jashtëm. Froebel

• Arsimi është zhvillimi harmonik dhe progresiv i të gjitha fuqive dhe vullneteve të lindura të njeriut - fizik, intelektual dhe moral. Pestalozzi

• Arsimi është zhvillimi i një karakteri të mirë moral. J.F.Herbert

• Arsimi nuk është një përgatitje për jetën, por është jetesa. Arsimi është procesi i jetesës përmes një rikonstruksioni të vazhdueshëm të përvojave. Është zhvillimi i të gjitha

këtyre kapaciteteve në individin i cili do t'i mundësojë atij të kontrollojë mjedisin e tij dhe të përmbushë mundësitë e tij. Xhon Dju

• Arsimi është zhvillimi i plotë i individualitetit të fëmijës në mënyrë që ai të mund të bëjë një kontribut origjinal në jetën e njeriut sipas më të mirës së kapacitetit të tij. T.P.Nunn.” (Satish Kumar&Sajjad Ahmad, n.d.)

Edhe me Ligjin Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor (2006) janë vënë disa nga objektivat e arsimit, përmes të cilave mund t'i japim një përmbledhje më të gjerë. “Qëllimet e ligjit për edukim parashkollor janë rregullimi normativ institucional i edukimit parashkollor në institucionet parashkollore, përmes të cilave do të arrihet : (a) Të inkurajohet aftësia që të kuptohet dhe të pranohet vetvetja dhe të tjerët; (b) Të inkurajohet aftësia për bashkëbisedime, të pranohen ndryshimet dhe të marrin pjesë në grupe; (c) Të inkurajohet aftësia për të identifikuar emocionet dhe të nxiten në shprehjen dhe manifestimin e përjetimeve emocionale; (d) Të inkurajohet kërshtëria, shpirti hulumtues, intuita dhe imagjinata dhe të zhvillohet mendimi i pavarur; (e) Të inkurajohet zhvillimi gjuhësor dhe i komunikimeve tjera për përdorimin efikas dhe kreativ të gjuhës, që më vonë të ndihmojë në lexim dhe shkrim; (f) Të inkurajohet aftësia dhe shprehja artistike; (g) Të transferohet dituria në fusha të ndryshme të shkencës dhe jetës së përditshme;. (h) Të inkurajohet zhvillimi trupor dhe psikik; (i) Të inkurajohet pavarësia e fëmijëve në higjienën personale dhe në kujdesin e shëndetit të tyre; (j) Të inkurajohet raporti pozitiv ndaj mjedisit jetësor dhe vetëdijesimi për mjedisin ekologjik. Parimet e edukimit në institucionet parashkollore Neni 4 Edukimi në institucionet parashkollore do të bazohet në këto parime: (a) Barazia; (b) Gjithë përfshirja; (c) Demokracia; (d) Autonomia e personelit; (e) Profesionalizmi dhe përgjegjësia; (f) Mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marrë parasysh ndryshimet në mes të fëmijëve; (g) E drejta për të qenë ndryshe; (h) Zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijëve.” (f. 4)

Bazuar në të gjitha defincionet e mësipërme, mund të përfundojmë se arsimimi është proces i fitimit të diturive dhe njohurive të reja, me qëllimin e përgjithshëm dhe final të arritjes së barazisë, gjithëpërfshirjes, autonomisë, profesionalizmit, ruajtjes së individualizmit dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm të personalitetit të nxënësve e studentëve.



## 2.2 Llojet e arsimimit

Arsimimi manifestohet përmes llojeve të ndryshme të përvetësimit të diturive të reja, vendit të organizimit, kohës së zhvillimit, dinamikave shoqërore të një vendi etj. etj. Arsimimi në përgjithësi ndahet në arsimin formal, joformal dhe informal. “Konceptet e mësimin formal, joformal dhe informal janë bërë terme kyçe brenda qasjes së të nxënimit gjatë gjithë jetës. Përkufizimet e mëposhtme të termave përdoren në Udhëzimet e UNESCO-s për Njohjen, Vlefshmërinë dhe Akreditimin e Rezultateve të Mësimin Joformal dhe Informal (UIL 2012).

- Të mësuarit formal bëhet në institucionet e arsimit dhe të aftësimit, duke rezultuar në diploma dhe kualifikime të tjera të njohura nga autoritetet përkatëse kombëtare. Mësimi formal është i strukturuar sipas marrëveshjeve arsimore siç janë kualifikimet e kurrikulës dhe kërkesat e mësimdhënies-mësimnxënies.

- Mësimi jo-formal është mësimi që është shtesë ose alternativë ndaj të mësuarit formal. Në disa raste, ky gjithashtu është i strukturuar sipas arsimit dhe trajnimeve, por në mënyrë më fleksibile. Zakonisht ndodh në mjediset e bazuara në komunitet, në vendin e punës dhe në aktivitetet e qytetarëve e të organizatave të shoqërisë.

- Mësimi informal është mësimi që ndodh në jetën e përditshme, në familje, në vendin e punës, në komunitete dhe përmes interesave dhe aktiviteteve të individëve. Në disa raste, termi mësim eksperiencial përdoret për t’iu referuar të nxënimit informal që fokusohet në të mësuarit nga përvoja. (Singh, 2015, f.20)

Gjatë ofertave të universiteteve të ndryshme publike dhe private, për studentët që janë të interesuar të regjistrohen, ofrohen edhe lloje të ndryshme arsimimi, prej nga mund të kuptojmë edhe aspektet aplikative të llojeve të ndryshme të arsimimit. “Ka lloje të ndryshme arsimimi. Në vijim janë llojet më të zakonshme: Ligjërata në të cilat një instruktor do të shpjegojë kursin e teorisë; Udhëzime ku punoni nën mbikëqyrjen e një mësuesi ose tutori në detyra, kjo është kryesisht për lëndët matematikore; Projektet e grupit në të cilat punoni së bashku me studentët tuaj në grupe; Arsimi i bazuar në dizajn (OGO) ku aplikoni teorinë në detyra; Video-leksionet janë paraqitje online të një leksioni të drejtpërdrejtë. Këto janë të disponueshme përmes katalogut të leksioneve...” (Fakulteti i Shkencave të VU – Universiteti Amsterdam, n.d.)

Në tabelën e mëposhtme 1, do të paraqiten dallimet në mes të llojeve të ndryshme të arsimimit formal, joformal dhe informal (Melinic&Botez, 2014).

Analizë Kriteret	Arsimi formal	Arsimi joformal	Arsimi informal
Definicioni	<p>Edukimi formal korresponon me një model të arsimit të organizuar, sistematik, të strukturuar dhe administruar sipas një grupi të caktuar të ligjeve dhe normave, duke paraqitur kurríkula mjaft të ngurta apo rigjide, perkitazi me objektivat, permbajtjen dhe metodologjinë.</p> <p>Arsimi formal ka një grup të mirëpërcaktuar të veçorive.</p>	<p>Karakteristikat e arsimit joformal janë gjetur kur strategjia e miratuar nuk kërkon ndjekjen e studentëve, duke ulur kontaktet mes mësuesit dhe studentit dhe më shumë aktivitete zhvillohen jashtë institucionit - si për shembull, lexim dhe shkresa në shtëpi.</p> <p>Proceset edukative e pajisura me kurríkula dhe metodologji fleksibile, të afta për t'iu përshtatur nevojave dhe interesave të studentëve, për të cilën kohë nuk është një faktor i paracaktuar por është kontigjent i punës së studentit, sigurisht jo</p>	<p>Arsimi informal është mjaft i ndryshëm nga arsimi formal dhe, veçanërisht, nga arsimi joformal, edhe pse në raste të caktuara është i aftë duke mbajtur një marrëdhënie të ngushtë me të dyjat. Nuk korresponon me një pamje të arsimit të organizuar dhe sistematik;</p> <p>arsimi informal domosdoshmërisht nuk përfshijn objektivat dhe lëndët, që zakonisht përfshihen nga kurríkula tradicionale.</p> <p>Arsimi informal për shembull përfshin këto aktivitete: (a) - vizita në muze</p>

		korrespondim me ato të përbëra nga arsimi formal.	ose në panairë shkencore dhe të tjera ekspozita, etj; (b) - të dëgjuarit për radio transmetimin ose shikimi i programeve televizive, tema arsimore ose shkencore; (c) - leximi i teksteve mbi shkencat, arsimin, teknologjinë, etj gazeta dhe revista; (d) - pjesëmarrja në konkurse shkencore, etj; (e) - ndjekja e ligjëratave dhe konferencave.
Përmbajtjet	Dije e sistematizuar	Dije e specializuar	Informacion nga disiplina multidisiplinare
Tipet e ndikimit	formues-educative; - sistematizuar; - organizuar; - raportohet për qëllimet.	- formative-educative ndikimet lidhen me ato nga mjedisi i shkollës shtesë	spontan; - i përhapur; - heterogjene; - pedagogikisht i paorganizuar; - pedagogikisht i papërgatitur;

			<ul style="list-style-type: none"> <li>- i vendosur në vend;</li> <li>- rastësor;</li> <li>- jo i sistematizuar;</li> <li>- nuk raportohen për qëllime të kohëzgjatjes së shkurtër</li> </ul>
Faktorët e involvuar	I realizuar në institucione të specializuara (tipe të ndryshme të shkollave)	I realizuar jashtë institucionit të shkollës	Mesazhet më të rëndësishme janë ato të lëshuara nga mediet (gazeta, revista, postera, CD)
Kategoritë e aktiviteteve	aktivitete formale	jashtë klasës (Olimpiada, qarqet tqematike); - jashtë shkollës (shfaqje, udhëtime, konferenca - të tjera aktivitete); - pasi të ketë një punë (të mësuarit gjatë gjithë jetës me aktivitete)	- aktivitete relaksuese; - situata të përditshme të trajnimit.
Rruga e arritjes/realizimit	Direkt	Direkte	individuale, e nënkuptuar
Efektet	e parashikuar, pozitive	e parashikuar, pozitive	jo-parashikuar, pozitive dhe Negative
Avantazhet	Sigurimi i futjes së studentëve brenda	Mundësitë e vlerësimit,	Përcakton ndjeshmërinë në

	kornizës së punës intelektuale të organizuar.	burimet dhe hulumtimet lokale	kontaktin me rrethin, mjedisin, duke gjeneruar një interes për njohuri
Disavantazhet	dominimi i informacionit mbi aspektet cilësore të ndryshimit	rreziku i uljes së vlerave pedagogjike, shkencore dhe formuese; mungesa e disa veprimeve sistematike vlerësuese	krijimi i një konflikti që ka përfundime edukative, morale dhe estetike

*Tabela 1. Kriteret për analizën e formave të arsimit. Burimi: Melnic&Botez, 2014*

Po ashtu, këto lloje të arsimit përmenden edhe në Ligjin Nr.2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë (2004), ku thuhet: “Neni 2 Ky ligj, ka të bëjë me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe të akteve nënligjore nga inspeksioni i arsimit në edukimin dhe arsimimin publik dhe privat për: a. Edukimin dhe arsimin parashkollor; b. Arsimin fillor; c. Arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë; d. Arsimin e lartë; e. Arsimin special; f. Arsimin joformal; g. Arsimin profesional; h. Vendstrehimet e organizuara të fëmijëve të nxënësve dhe të studentëve (çerdhet e fëmijëve, konviktet e nxënësve dhe studentëve); i. Arsimin në diasporë; dhe j. Shtëpitë korrektuese dhe burgjet.” (f.1)

Edhe në nenin 2 të përkufizimit të këtij Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë (2004), tri llojet e arsimit, si: formal, joformal dhe informal, janë përfshirë brenda tekstit. “Neni 2 Përkufizimet 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.1. Arsimi dhe aftësimi profesional (AAP) - synon të pajisë nxënësit/kandidatët me njohuri, aftësi praktike, shkathtësi dhe kompetenca të kërkuara në profesione të veçanta apo më gjerë në tregun e punës; 1.2. Institucioni i arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP) - institucion publik ose privat, që zbaton programe të arsimit dhe aftësimit profesional, në pajtim me dispozitat e këtij ligji; 1.3. Mësimi gjatë gjithë jetës - përfshinë të gjitha aktivitetet e mësimit që realizohen gjatë tërë jetës për zhvillimin e njohurive, kompetencave dhe kualifikimeve; 1.4. Arsimi

formal - mësimi që zhvillohet në një ambient të caktuar dhe strukturuar dhe është i dizajnuar në mënyrë të qartë si mësim në aspektin e qëllimeve, kohës apo resurseve. Nga pikëpamja e nxënësit, mësimi formal është i qëllimshëm; 1.5. Arsimi dhe aftësimi joformal - mësimi i cili është i shtrirë në aktivitetet e planifikuara, por i cili nuk emërtohet në mënyrë eksplicite si mësim. Nga pikëpamja e nxënësit, mësimi joformal është i qëllimshëm; 1.6. Arsimi informal - mësimi që rezulton nga aktivitetet ditore të lidhura me punën, familjen ose kohën e lirë. Nuk është i autorizuar ose strukturuar në aspektin e qëllimeve, kohës ose përkrahjes mësimore. Në shumicën e rasteve, mësimi informal është i paqëllimshëm nga perspektiva e nxënësit/kandidatit. Rezultatet mësimore informale zakonisht nuk shpijnë në certifikim por mund të validohen dhe certifikohen në kuadër të skemës së njohjes së mësimin paraprak. Mësimi informal referohet edhe si mësim praktik, plotësues apo i rastësishëm...” (f.1)

Ndërsa në nenin 3, bëhet fjalë edhe për objektivat dhe parimet e arsimimit:

“Neni 3 - Parimet e arsimit dhe aftësimin profesional 1. Parimet e arsimit dhe aftësimin profesional (në tekstin e mëtejshëm AAP) janë : 1.1. gjithëpërfshirja; 1.2. qasja, transferi dhe progresi; 1.3. mësimi teorik dhe i praktikës profesionale; 1.4. nevojat e tashme dhe të ardhshme të Ekonomisë; 1.5. mbështetja e zhvillimit të karrierës si pjesë e integruar e procesit të të mësuarit gjatë gjithë jetës. 4 Neni 4 Fushëveprimtaritë e arsimit dhe aftësimin profesional 1. Fushëveprimtaritë e arsimit dhe aftësimin profesional janë: 1.1. zhvillimi i kompetencave dhe aftësimi për punësim të individëve në përputhje me profesionin dhe karrierën e tyre sipas kërkesave të tregut të punës; 1.2. krijimi i kulturës së përgjithshme dhe profesionale në pajtim me parimet e arsimimit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimet ekonomike, shkencore dhe teknologjike; 1.3. njohja e kompetencave të individëve bazuar në standardet e profesioneve të nivelit përkatës.” (Ligji Nr.2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, 2004, f.3-4)

Në kuadër të arsimimit, arsimimi gjatë gjithë jetës mbetet ndër më të rëndësishmit. Në vijim, do të përshkruajmë veçoritë e arsimimit gjatë gjithë jetës, si një nga nocionet më të përdorura në dy dekadat e shekullit XXI.

### 2.2.1 Arsimimi gjatë gjithë jetës

Arsimimi gjatë gjithë jetës, ku individi pajiset me motivacionin, synimet dhe qëllimet e të mësuarit jo vetëm pasi të mbaron studimet diplomike, të masterit, doktoraturës e postdoktoratës, por gjatë gjithë jetës së tij. “Arsimi i lartë brenda kuadrit dhe qasjes së të mësuarit gjatë gjithë jetës është mjaft i ri... Mësimi gjatë gjithë jetës merr kuptime të shumëfishta dhe interpretime. Ky është një koncept i kontestuar që nuk shihet gjithmonë si 'një gjë e mirë'. Sipas Taylor et al. (2002), mësimi gjatë gjithë jetës është parë në mënyrë të ndryshme, si shqetësim me thelb profesionalizmin dhe performativitetin, kontrollin social dhe inkorporimin, kompleksitetin pluralist brenda kuadrit post-modern, zhvillimin dhe rritjen personale, dhe qëllimin radikal social dhe zhvillimin e komunitetit. (Sutherland&Crowther, 2008, f. 72)

Arsimimi gjatë gjithë jetës korrespondon me kohë, mënyra, qëllime dhe faza të ndryshme, sikur e thotë edhe ky përkufizim i autorëve Sutherland dhe Crowther (2008): “Kjo i mundëson nxënësve të mësojnë në kohë të ndryshme, në mënyra të ndryshme, për qëllime të ndryshme, në faza të ndryshme të jetës dhe karrierës së tyre. Të mësuarit gjatë gjithë jetës është i shqetësuar me sigurimin e mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës, gjersa zhvillon nxënësit gjatë gjithë jetës.” (f.73)

Arsimimi gjatë gjithë jetës ndërvaret edhe nga llojet e arsimit formal, edhe atë joformal e informal. “Karakteristika e parë e të mësuarit gjatë gjithë jetës është se ajo përfshin llojet e arsimit dhe trajnimit, si formale, ashtu edhe joformale/informale.” (Soni, n.d.)

Arsimimi gjatë gjithë jetës nuk kushtëzohet nga mosha kronologjike e individit, por për të gjithë dhe gjithmonë. “Një sistem i të mësuarit gjatë gjithë jetës duhet të arrijë segmente më të mëdha të popullsisë, duke përfshirë njerëzit me nevoja të ndryshme të të mësuarit. Duhet të jetë kompetencë e drejtuar në vend se të jetë e lidhur me moshën. Brenda mjediseve tradicionale institucionale, kurrikulat e reja dhe metodat e reja të mësimdhënies janë të nevojshme. Në të njëjtën kohë, duhet të bëhen përpjekje për të arritur nxënës që nuk mund të regjistrohen në programet e institucioneve tradicionale. Programet në internet dhe në distancë janë konsideruar si disa prej metodave të zbatuara për të arritur këtë qëllim... Mësimi gjatë gjithë jetës është më shumë se trajnimi ose edukimi i vazhdueshëm.” (Soni, n.d.)

## 2.2.2 Arsimimi formal dhe joformal

### 2.2.2.1 Arsimimi formal

Arsimimi sikur e shtjelluam më lart, ndahet kryesisht në atë formal dhe joformal. Këto janë dy nga format më të organizuara dhe më të strukturuar të arsimit, nëse i krahasojmë me arsimimin informal, ndonëse nëse krahasojmë arsimin formal me atë joformal, ky i fundit nuk është i ngurtë si lloji i parë i arsimit, prandaj quhet arsimim joformal.

“Arsimimi që nxënësit marrin nga mësuesit e trajnuar në klasa nëpërmjet një kurrikulumi të strukturuar quhet sistemi formal i arsimit. Edukimi formal është menduar me kujdes dhe ofrohet nga mësuesit të cilët kanë një nivel bazë të kompetencës. Kjo kompetencë është e standardizuar përmes trajnimeve formale të mësimdhënësve, për t'u siguruar atyre një certifikim që mund të jetë i ndryshëm në vende të ndryshme. Edukimi formal ofrohet kryesisht në shkencat moderne, artet dhe tregjet në rrjedhën e shkencës, më vonë duke u ndarë në inxhinieri dhe shkencë mjekësore. Nga ana tjetër, ka edhe specializim të menaxhimit dhe kontabilitetit të akredituar që studentët mund të marrin në studime të larta pas përfundimit të 16 viteve të arsimit formal.

- Arsimi formal është i njohur nga shteti, si dhe nga industria dhe njerëzit priren të gjejnë mundësi punësimi në bazë të nivelit të arsimit formal që ata kanë arritur.
- Mësimdhënësit në arsimin formal marrin trajnim formal dhe japin përgjegjësi për të dhënë mësim në bazë të kompetencave të tyre.



- Arsimi formal zhvillohet në klasa ndërsa arsimi informal zhvillohet në jetë. (*Dallimet në mes të Arsimimit Formal dhe Joformal*, 2012).

Nga kërkimet tona, gjejmë edhe dallime të tjera në mes të arsimit formal dhe atij joformal. “Ekziston një program i dizajnuar posaçërisht në arsimin formal, ndërsa nuk ka kurrikulë dhe strukturë në arsimin joformal... Arsimi formal është i bazuar në klasë, i siguruar nga mësuesit e certifikuar. Arsimi joformal ndodh jashtë klasës, në programet pas shkollës, në qendrat e kujdesit për fëmijët, në organizatat me bazë në komunitet, në muze, në biblioteka dhe në shtëpi...(Enhancing Education A Children’s Producer’s Guide, n.d.)

#### 2.2.2.2 Arsimimi joformal

Arsimimi joformal mund të definohet si “tërësi e aktiviteteve të organizuara mësimore jashtë arsimit formal”... AJF përfshinë programe në:

- shkollimin në gj. amtare
- vetëdijësimin (përfshirë ‘fuqizimin’ dhe shkathtësitë jetësore për të rinjtë dhe të rriturit)
- zhvillimi i shkathtësive për punësim në sektorin joformal dhe krijimi i të ardhurave përmes vetëpunësimit dhe arsimimi për zhvillim personal.

Objektivi i përgjithshëm i AJF fokusohet në kontributin e tij në zhvillimin e komunitetit, vetëbesimin, zvogëlimin e varfërisë dhe krijimin e të ardhurave përmes qasjes së popullsisë (të rriturve) në mundësitë relevante për mësim.

Arsimi i të rinjëve dhe të rriturve ngërthen në vete arsimimin permanent dhe vetëarsimimin. Kjo supozon arsyen dhe nevojën për ta ngritur shkallën e diturisë, në mënyrë permanente të përcillet dhe të njihet individi (punëtori, arsimtari dhe profilet tjera të shërbimeve) me të arriturat e reja në shkencë, në praktikë, në profesion dhe në krijimtari në përgjithësi. (Bajrami, n.d.)

Sipas autorit Bajrami, në bazë të referencave të përmbledhura nga burime të ndryshme, janë disa faktorë që e përcaktojnë arsimimin joformal: “Ka një numër të madh të faktorëve që determinojnë AJF, ndër to ne do t’i përmendim:

- Motivi për të nxënë – që është një faktor mjaft me rëndësi ngase për të mësuar vazhdimisht njeriu duhet të ketë motiv, nxitje që e shtyn për të mësuar;

- Vetëdija për nevojën për të nxënë – njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm për atë që din, për atë që mëson e që duhet ta mësojë në të ardhmen;

– Pasqyrë e qartë për dituritë që duhet nxënë – njeriu duhet ta ketë të qartë atë që duhet të mësojë, atë që ka nevojë për të mësuar;

– Dituritë e fituara t’i zbatojë në praktikë – që dituritë të mbesin më gjatë në kujtesën tonë dhe të ndikojnë në punën tonë, ato duhet të ushtrohen në praktikë;

– Dituritë e fituara t’i përforcojmë – që dituritë të mbrijnë efektin e tyre ato duhet që vazhdimisht të përforcohen dhe freskohen me dituri të reja;

– Dituritë e marra të kenë dobi të drejtpërdrejta – është e rëndësishme që rezultatet, sukseset të arrihen për një periudhë të shkurtër, pra shumë shpejt;

– Plotësimin, zgjerimin dhe progresimin e diturive – dituritë e fituara duhet vazhdimisht të plotësohen me informacione të reja, të zgjerohen si dhe të futen risitë nga fusha të ndryshme;

– Imponohet si domosdoshmëri e cila mundëson lidhjen e së tashmes me të ardhmen – theksohet lidhja e së shkuarës, së tashmes dhe të së ardhmes;

– Eksplodimi dhe ekspansioni i diturive nxisin aspiratat për AJF – shtimi i shpejtë i diturive, dyfishimi i tyre për një kohë të shkurtër bën që njeriu të mësojë vazhdimisht ngase kjo i imponohet për një punë dhe jetë më të mirë. (Bajrami, n.d.)

Ndërsa sa i përket detyrave të arsimimit joformal, autori i lartcituuar numëron disa prej tyre, si këto më poshtë:

– Trajnimi dhe aftësimi i të rinjëve dhe të rriturve për punësim;

– Trajnimin e njerëzve për punë bujqësore dhe industriale;

– Organizimi i kurseve për zhvillimin dhe rritjen e vlerave materiale ekonomike (kurse të rrobaqepësisë, për kompjuter, për gjuhë të huaj, etj.);

– Përmirësimi i kualitetit të jetës;

– Përforcimi dhe ngritja e nivelit të njohurive;

– Zhvillimin e aftësive të një numri të madh të të papunëve;

– Rritjen e punësimit brenda vitit;

– Ngritjen dhe zhvillimin e kapacitetit të gruas dhe të rinjëve;

– Trajnime dhe kësillime shëndetësore dhe kujdesin higjienik;

– Këshillim dhe edukim parashkollor. (Bajrami, n.d.)

Edhe në kuadër të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Republikës (MKRS) së Kosovës, përkatësisht brenda Departamentit të Rinisë, edhe themeluar sektori i veçantë, i quajtur me emërtimin “Edukimi joformal. Në faqen zyrtare të MKRS-së, shpjegohet ky mision dhe qëllimet/objektivat, zhvillimi dhe metodologjia e edukimit jo-formal.

“Shkalla e ekonomisë së tanishme dhe ndërrimeve shoqërore, si dhe tranzicioni i shpejtë në një shoqëri që bazohet në njohuri dhe presionet demografike që rezultojnë nga popullata e re në Kosovë, të gjitha këto janë ndërrime, të cilat kërkojnë një qasje të re në edukim dhe në trajnim. Në kontekst të këtyre sfidave, Edukimit Joformal i është dhënë një prioritet i madh edhe nga vendet e Bashkimit Evropian, Edukimi Joformal është përkufizuar si: i tërë aktiviteti mësimor i realizuar gjatë tërë jetës, me qëllim të përmirësimit të njohurive, shkathtësive dhe kompetencës në kuadër të perspektivës personale, qytetare, shoqërore dhe atë të lidhur me punësimin.

#### Qëllimet/Objektivat:

- Ngritja e shkathtësive të lidershit rinor përmes Edukimit Joformal.
- Njohja e certifikimit nga ana shoqërore dhe institucionale e Edukimi Joformal
- Përkrahja e Qendrave Rinore dhe atyre profesionale që merren me Edukimin Joformal.
- Stimulimi i shërbimeve shoqërore përmes punës vullnetare dhe shkëmbimeve rinore jashtë vendit.
- Ngritja e kapaciteteve rinore organizative dhe menaxhuese.

#### Strategjia:

- Të hartojë udhëzime për themelimin dhe përkrahjen e Qendrave Rinore/Profesionale me Komunitat dhe partnerët e tjerë.
- Të sigurojë fonde dhe trajnime për drejtuesit e Qendrave Rinore/Profesionale.
- Mbajtja e kampeve rinore edukative.

#### Metodologjia e Implementimit:

- Qëndrueshmëria e Qendrave Rinore/Profesionale dhe rrjetëzimi i tyre.
- Sigurimi i kurseve, trajnimeve për zyrtarët e rinisë, drejtoritë komunale dhe OJQ rinore në Kosovë.

#### Zhvillimi i Edukimit Joformal:

Partneret:

Qendrat Rinore, Drejtoritë Komunale, OJQ lokale dhe ndërkombëtare, Agjenci të UN etj.” (MKRS, n.d.)

Dallimet e edukimit formal dhe joformal, në bazë të përshkrimeve dhe zbërthimeve veç e veç, janë të mëdha, por jo edhe në qëllimet dhe synimet finale. “Në përgjithësi, klasat kanë të njëjtit fëmijë dhe mësues çdo ditë. Programet pas-shkollore shpesh janë në rënie, prandaj pjesëmarrja është e paqëndrueshme dhe stafi mund të ndryshojë nga dita në ditë. Aktivitetet në klasë mund të zgjasin disa ditë. Programet pas-shkollore duhet të përfundojnë një aktivitet brenda një dite, sepse një grup i ndryshëm i fëmijëve mund të jetë i pranishëm nesër. Ju mund të supozoni se mësuesit në klasë kanë një nivel të caktuar të trajnimit në filozofinë arsimore, strategjitë efektive të mësimdhënies, menaxhimin e klasës dhe përmbajtjen. Ofruesit pas-shkollorë dhe ofruesit e kujdesit të fëmijëve, nga ana tjetër, ndryshojnë në përvojën dhe njohuritë e teknikave të mësimdhënies, ekspertizës së përmbajtjes dhe menaxhimit të grupit. Në mënyrë tipike, materialet për programet pas-shkollore dhe shumë përkujdesje për fëmijët përfshijnë një strukturë shumë më të madhe. Mësuesit me bazë në shkollë duhet të plotësojnë standardet arsimore dhe t'i përmbahen një kurrikule të caktuar, gjë që mund ta bëjë të vështirë për ta të inkorporojnë përmbajtje jo-tradicionale. Programet pas-shkollore, nga ana tjetër, mund të jenë më fleksibile me përmbajtjen e tyre, siç mund të jenë edhe qendrat për kujdesin e fëmijëve.” (Enhancing Education A Children’s Producer’s Guide, n.d.)

### 2.2.3 Arsimimi autodidakt

Lloj tjetër i arsimimit për kohë të gjatë është i njohur në literaturën pedagogjike, edhe arsimimi autodidakt. “Nga etimologjia e saj, një autodidakt duket të jetë ai që e mëson veten e tij apo të saj...” (Joan, 2003, f.71)

Nga titulli i veprës së Joan Solomon-it(2003), do të mund ta përmbledhnim arsimimin autodidakt edhe në këtë mënyrë: “Arsimimi autodidakt mund të përkufizohet edhe si pasion për të mësuar. Solomon ka dhënë definicione direkte mbi autodidaktizmin në librin e tij.

“Unë e identifikoj shumë nocionin e vetë-mësimdhënies, ose autodidaktizmit, me idenë e të mësuarit informal, të mësuarit që ne angazhohemi përmes veprimeve tona dhe motivim dhe jo si marrës të mësimit të specifikuar dhe të siguruar për ne nga të tjerët...”(Joan, 2003, f.71)

Disa e shpjegojnë një lidhje të fuqishme të autodidaktizmit dhe zhvillimit aq të madh të teknologjisë. “Ka përfitime të jashtëzakonshme për autodidaktin modern të ditës. Interneti po lulëzon me burime falas arsimore. Përgjigja për çdo pyetje është vetëm një kërkim i Google-s. Ritmi në të cilin nxitojnë nxënësit në Google për t’iu përgjigjur çdo pyetjeje të tyre, do të vazhdojë. iPhone do të vazhdojë të bëhet më i vogël dhe më i vogël, ndërsa në të njëjtën kohë duke u bërë më afër gojës, syve dhe veshëve tanë që të lejojnë qasje më të lehtë. Ky po lëviz më pranë fytyrës dhe më tej nga xhepi. Qasja në informacion do të bëhet më i përshtatshme me kalimin e kohës. Sistemi tradicional arsimor, nga ana tjetër, ka nevojë për reformim serioz. Edukimi i shekullit 21 ka nevojë për rishikim, një model të ri; për fat të mirë, kjo është diçka që mund të filloni vetë: quhet autodidaktizëm dhe ka qenë rreth e rrotull për vite. Ekziston një potencial i madh në të mësuarit të vetë-drejtuar dhe e ardhmja është e ndritshme. Teknologjia po luan një rol vendimtar në zhvillimin e arsimit. Kompanitë si Apple kanë krijuar produkte që bashkohen me klasa. iPad është duke zëvendësuar tekstin, fletoret, lapsin dhe stilolapsin... Rrjetet inovative si Coursera dhe Khan Academy kuptojnë se universiteti i së ardhmes është online. Të dy institucionet po rriten shpejt dhe zgjerojnë bazën e tyre të konsumatorit. Vetë-edukimi është e ardhmja. Ata që mësojnë nga komoditeti i shtëpisë së tyre ose në lëvizje janë në një avantazh të pagabueshëm mbi studentin e bllokuar në klasë. Rrjetëzimi social do të vazhdojë të zhvillohet dhe të gjejë mënyra të reja për ndërveprim shoqëror në grup...”(Stansfield, n.d.)

Ndërsa një fjalor tjetër elektronik, e elaboron nocionin e personit autodidakt në këtë mënyrë: “...një person i cili ka mësuar një lëndë pa përfitimin prej një mësuesi ose një edukimi formal; një person i vetë-mësuar.” (Dictionary, n.d.)

Edhe në fjalorin elektronik të gjuhës shqipe, jepet ky shpjegim mbi autodidaktin. “1. Që mëson shkrim e këndim dhe shkollohet vetë, pa mësues; që bëhet specialist në një fushë të caktuar duke mësuar vetë, pa ndjekur shkollë të rregullt. Njeri autodidakt. Filozof autodidakt. Në mënyrë autodidakte. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit.” (<http://www.fjalori.shkenca.org/>)

## 2.2.4 Arsimimi tradicional

Arsimimi tradicional ka marrë kuptime të ndryshme, por së pari duhet ta sqarojmë që në fillim termin “tradicional”. Tradicional sipas Fjalorit Shqip Online – Shkenca (n.d.), nënkupton: “Që është mbështetur në traditën, që është ngulitur prej traditës, që vjen nga tradita; që bëhet sipas traditës, që zhvillohet sipas zakonit; i trashëguar nga e kaluara. Kultura tradicionale. Festë tradicionale. Parakalimi (manifestimi) tradicional i Një Majit. Mbrëmja tradicionale e Vitit të Ri.”(<http://www.fjalori.shkenca.org/>)

Arsimimi tradicional ngatërrohet me metodologjinë tradicionale e të dikurshme për dallim nga metodologjia bashkëkohore me në qendër nxënësin. Ndërsa, me zhvillimin e teknologjisë, arsimimi tradicional, ka marrë kuptimin tjetër, të cilin do ta shpjegojmë më poshtë, mbështetur në citimin vijues: “Arsimimi tradicional është përcaktuar si shpërndarje e mësimdhënies në qendër të mësimdhënësve për klasat e studentëve që janë marrësit e informacionit. Shkollat tradicionale në përgjithësi theksojnë praktikat themelore të edukimit dhe presin zotërimin e mësimit akademik në lëndët bazë të matematikës, leximit, shkrimit, shkencës dhe studimeve shoqërore.” (Huson, n.d., para.2)

Si dallim tjetër sipas Edwards (2011), mund të merret lloji i motivimit: “Në komunitetet e të mësuarit përdoret motivimi i brendshëm, ndërsa në shkollat konvencionale mbizotëron motivimi i jashtëm...”(f.115)

Arsimimi tradicional ka disa përparësi dhe mangësi, të cilat do t’i shkoqisim bazuar edhe në autorë të tjerë. “...Është fakt se arsimi tradicional është mënyra më e mirë e arsimit, por gjithashtu ka disa të meta që mund të eliminohen me planifikimin dhe zbatimin e duhur të këtyre politikave. Në këtë artikull janë diskutuar për avantazhet dhe disavantazhet e arsimit tradicional. *Përparësitë:*

Mësim aktiv - Arsimi tradicional është një mënyrë aktive e të mësuarit... Pjesëmarrja aktive e nxënësve dhe mësimdhënësve;

- Studentët marrin pjesë aktivisht në aktivitetet në klasë... Ata bëjnë pyetje nga mësuesit nëse kanë ndonjë problem në studime. Pjesëmarrja aktive është shumë e rëndësishme për të kuptuar qartë teorinë e diskutuara në klasë;

Komunikim - Ekziston një komunikim i mirë mes nxënësve dhe mësuesve dhe midis nxënësve. Kjo është shumë thelbësore për rritjen e nivelit të besueshmërisë së studentëve. Një komunikim i mirë i bën studentët komunikues të mirë dhe mësimdhënësit gjithashtu ndihen kompetentë pasi marrin komente nga studentët;

- Aktivitete rekreative - Aktivitetet e rregullta rekreative rifreskojnë studentët dhe ata marrin pak lehtësim nga stresi i studimeve. Ata gëzojnë dhe argëtohen për shkak të këtyre aktiviteteve rekreative. Këto aktivitete janë të dobishme përveç studimeve;

Planifikimi - Pjesa më e mirë e edukimit tradicional është se është i planifikuar dhe është kryer siç duhet. Orari dhe kohëzgjatja e leksioneve janë planifikuar të gjitha. Kjo ndihmon në bërjen e studentëve të disiplinuar dhe të civilizuar.” (Avantazhet dhe Disavantazhet e Arsimimit Tradicional, 2017)

Por arsimimi tradicional karakterizohet edhe me shumë mangësi apo të meta:

“Ushqimi me lugë - Nxënësit gjithmonë varen nga mësuesit e tyre në çdo çështje studimore. Kjo i bën ata të varur nga mësuesit. Kjo veçori e fsheh anën kreative të personalitetit të tyre dhe ata kurrë nuk njihen me forcat e tyre;

Favoritizëm - Mësuesit tregojnë favorizim, që shkatërron personalitetet e studentëve të lënë anash. Ata ndihen të paafte dhe me vlerë më të ulët. Ky qëndrim zhvillon ndjenja inferiore në studentët e tjerë. Mësuesit duhet t'i trajtojnë të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë. Aktivitetet jashtëshkollore shtrembërojnë nxënësit ... Është e vështirë për studentët të mbajnë ekuilibrin midis studimeve dhe aktiviteteve jashtëshkollore;

Grupet negative - Ka shanse që studentët të kënaqen me grupet negative. Grupi negativ shkatërron studimet e studentit dhe personaliteti i tij ndikohet gjithashtu nga shoqërimi me këto grupe negative...;

I kushtueshëm - Edukimi tradicional është i kushtueshëm. Pagesa e shkollimit është shumë e lartë. Për më tepër, librat e kurseve dhe gjërat e tjera të shkollës janë mjaft të shtrenjta. Kushton aq shumë. Prindërit duhet të përballen me vështirësi në pagimin e tarifës së shkollimit dhe shpenzimeve të tjera të shkollave...” (Avantazhet dhe Disavantazhet e Arsimimit Tradicional, 2017)

Disa dobësi të arsimimit tradicional, i përmendin edhe autorë të tjerë. Ja disa mangësi të tjera të përmendura si më poshtë: “Në një mjedis tradicional të klasës, fëmijët bëhen të mërzitur ose të frustruar. Disa fëmijë mësojnë më mirë me mjete vizuale, të tjerët do të mësojnë më mirë me mjete audituese, dhe ende të tjerët do të mësojnë më mirë me një qasje praktike. Ka shumë të tjerë që kanë vështirësi të mësojnë në këtë mjedis, duke bashkëvepruar me kolegët që janë rreptësisht në rangun e tyre të moshës, ose që kërkojnë më shumë vëmendje dhe kohë për të kuptuar koncepte të caktuara.” (Gupta, n.d., f.4-6)

Dobësitë e tjera lidhen edhe me çmimin, metodologjinë, raportet mësimdhënës-nxënës, llojin e lëndëve mësimore etj. “Metoda tradicionale e mësimdhënies është më e lirë

sesa metodat moderne të mësimdhënies që e bëjnë atë më të përshtatshme në shkollat e zonave rurale.

- Disa lëndë si matematika ose kimia mësohen më së miri në një dërrasë të zezë pasi ekziston një nevojë e shpjegimit të konceptit në çdo hap.

- Ka më shumë ndërveprim mes mësimdhënësit dhe nxënësit në metodat tradicionale të mësimdhënies në krahasim me metodat moderne të mësimdhënies. Mund të themi gjithashtu në mësimdhënien tradicionale ka më shumë disiplinë në klasë.

- Në metodat tradicionale të mësimdhënies mësuesi nuk kërkon ndonjë njohuri të veçantë teknike dhe mund të fokusohet më shumë në temën e tij për dhënien e njohurive më të mira studentëve....(Gupta, n.d., f.6)

Në vazhdim do të merremi edhe me llojin tjetër të rëndësishëm të arsimit të sotëm, arsimin bashkëkohor.

### 2.2.5 Arsimimi bashkëkohor

Arsimimi bashkëkohor është i lindur me veçoritë e shoqërisë, përkatësisht fundit të shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI. Zhvillimi i globalizmit, teknologjisë dhe ekonomisë së ndërvarur të popujve, ka bërë që të ndryshojnë edhe metodologjitë, edhe objektivat e arsimit të mijëvjeçarit të ri.

“Përkufizimi: Mësimdhënia bashkëkohore përcaktohet më së miri si zbatimi i mësimin të aktiviteteve, të cilat merren me përvojat e studentëve, si brenda ashtu edhe jashtë klasës, duke i ndihmuar ata të pranojnë se po zhvillojnë aftësi specifike për të cilat ata i perceptojnë të jenë të rëndësishme për botën jashtë shkollës pasi e shohin atë. Termi "të mësuarit bashkëkohor" përdoret për të përfaqësuar një shumëllojshmëri të gjerë të elementeve të mësimdhënies që synojnë të sjellin botën moderne në klasë. Kjo qasje ka katër karakteristika themelore: 1. Aftësia e të mësuarit të integruar;

2. Personalizimi;

3. Përfshirja e nxënësit

4. Kthimi i menjëhershëm.”

(<http://faculty.weber.edu/psaunders/ed3780/3780bookpartI.09.06.pdf>, f.3)

Në fjalorin elektronik shqip “shkenca.org”, e gjejmë këtë përkufizim të nocionit “bashkëkohor”. “1. Që i përket kohës sonë, që është i epokës sonë, i sotëm. Letërsi



bashkëkohore. Shtypi bashkëkohor. Temë bashkëkohore. Probleme bashkëkohore...”  
(<http://www.fjalori.shkenca.org/>)

Arsimimi bashkëkohor është i ndërlidhur edhe me edukimin vleror të shoqërisë bashkëkohore dhe demokratike...”(i) të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë mendje të gjalla dhe kureshtare; duke u dhënë atyre aftësinë për të pyetur dhe për të argumentuar në mënyrë racionale...;(ii) për të rritur respektin për vlerat morale, për njerëzit e tjerë dhe për veten,dhe tolerancën e racave, feve dhe mënyrave të jetës; (iii) për të ndihmuar fëmijët të kuptojnë botën në të cilën jetojmë, dhe ndërvarësia e kombeve; (iv) për të ndihmuar fëmijët të përdorin gjuhën në mënyrë efektive dhe imagjinative, në lexim, shkrim dhe të folurit; (v) për të ndihmuar fëmijët të vlerësojnë se si vendi fiton dhe mban standardin e tij të jetesës dhe duhet të vlerësojë rolin esencial të industrisë dhe tregtisë në këtë proces; (vi) të sigurojë një bazë matematikore, shkencore dhe teknike të njohurive, duke mundësuar djemtë dhe vajzat të mësojnë aftësitë esenciale e të nevojshme në një botë me shpejtësi të ndryshueshme të punës; (vii) t'u mësojë fëmijëve për arritjet njerëzore dhe aspiratat në arte, shkenca, në fe, dhe në kërkim të një rendi më të drejtë shoqëror; (viii) për të inkurajuar dhe nxitur zhvillimin e fëmijëve të cilëve disavantazhet sociale ose mjedisore dëmtojnë kapacitetin e tyre për të mësuar, nëse është e nevojshme, duke siguruar ato burime shtesë në dispozicion.”(Gardner&Cairns&Lawton, 2000, f.151)

### **3. KAPITULLI II - METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES**

#### **3.1 Metodologjia e mësimdhënies tradicionale**

Se a e kemi të bëjmë më mësimdhënien tradicionale apo bashkëkohore, para së gjithash e përcakton edhe lloji i metodologjisë. Për shkak të rëndësisë kryesore të llojit të metodologjisë së aplikuar dhe llojit të arsimimit, e kemi vënë në prioritet elaborimin e shkurtër të dy llojeve kryesore të metodologjisë: tradicionale dhe bashkëkohore.

“Metodat tradicionale të mësimdhënies, të karakterizuara nga ofrimi pasiv i njohurive të ligjëruesve për studentë, pa përfshirjen e pjesëmarrësve të klasës në një diskutim aktiv, me dy drejtime ose me mundësinë për të marrë ndonjë lloj reagimi prej tyre, nuk plotësojnë nevojat arsimore të një shoqërie konkurruese (Berrett 2012; Damodharan dhe Rengarajan 2007; Hannan dhe Silver 2000).

Mësimdhënia tradicionale zhvillohet në arsimimin tradicional. “Arsimimi tradicional: Mësimi ndodh brenda një klase tradicionale, pa iu përshtatur interesave të studentit apo stilet e të mësuarit. Studentët kanë një sërë përvojash të të nxënit në shkollë, në internet dhe në komunitet. Arsimi i bazuar në kompetencë: Partnerët e ndryshëm krijojnë të mësuarit individual, rrugët për të përshtatur interesat e studentëve dhe stilet e të mësuarit.”(

<http://www.knowledgeworks.org/sites/default/files/u1/cbe-versus-traditional-education.pdf>

n.d.)

### 3.2 Metodologjia e mësimdhënies bashkëkohore

Metodologjia e mësimdhënies bashkëkohore fokusin kryesor e ka nxënësin, studentin, e jo burim absolut i diturive të konsiderohet mësimdhënësi.

“Ndryshe nga metodologjia tradicionale, metodologjia moderne është shumë më e përqendruar në studentë. Sipas Jim Scrivener, roli kryesor i mësuesit është të "ndihmojë të mësuarit të ndodhë", që përfshin "përfshirjen" e studentëve në atë që po ndodh "duke u mundësuar atyre të punojnë me shpejtësinë e tyre, duke mos dhënë shpjegime të gjata, duke i inkurajuar ata të marrin pjesë, të flasin, të ndërveprojnë, të bëjnë gjëra, etj..."(Boumová, 2008, f.20)

Në metodologjinë e mësimdhënies bashkëkohore, mësimdhënësi merr rolin e një lloj menaxherit apo drejtuesit të procesit edukativo-arsimor. “Roli i mësuesve bie gjerësisht në gjashtë kategoritë e listuara më poshtë.

Ofruesi i informacionit - Një përgjegjësi tradicionale e mësuesit është të kalojë informacionin, njohurinë dhe të kuptuarit e përmbajtjes së studimit. Ky informacion mund të dorëzohet duke përdorur metoda të ndryshme mësimore. Zgjedhja është sfida në mësimdhënie.

Roli i modelit - Një mësues duhet ta ilustronjë atë që duhet të mësohet. Ata duhet të jenë modele jo vetëm si ata mësojnë, por si ata kryejnë detyrat e tyre.

Lehtësuesi - Ndërsa lëvizim në pikëpamjen e përqendruar tek nxënësi për të mësuar rolin e mësuesit duke ndryshuar atë të një lehtësuesi të të mësuarit...

Vlerësuesi - Mësimdhënësi vlerëson nxënësin dhe kurrikulën. Vlerësimi i kompetencës së nxënësve përmes ekzaminimeve. Mësimdhënësit vlerësojnë planprogramin nga monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit të mësimdhënies së kurseve.

Planifikuesi - Mësimdhënësit planifikojnë kurrikulën dhe kurset që duhet të mësohen, si dhe zbatimin e tyre.

Zhvilluesi i burimeve - Mësuesit zhvillojnë burimet që përdoren gjatë shpërndarjes së kurrikulës. Ata zhvillojnë ndihmat e tyre mësimore, përfshijnë teknologji të reja në teknikat e mësimdhënies, përgatisin udhëzimet e studimit dhe ata gjithashtu janë krah për krah me çdo ndryshim të njohurive.”(Ndirangu, 2017, f.57)

Metodologjia e mësimdhënies bashkëkohore bazohet edhe në punë grupore, përveç punës individuale dhe në çifte. Puna grupore i ka disa përparësi, të cilën e identifikuan edhe autorë që në vitin 1960. “Te pjesa e parë e punës së grupit ushtrohen bisedimet në grupe të vogla, kurse përvoja na ka tregue se kjo kështu nxitë bisedimet në qarkun e klasës sa që sot duhet të paraqitet kërkesa parimore që t’i jepet prioritet me çdo kusht punës në grup.”(Vidak, 1960, f.21)

### **3.2.1 Struktura për mësimdhënien dhe të nxënit aktiv**

Struktura për mësimdhënien dhe të nxënit aktiv po ashtu ndryshon në mësimdhënien bashkëkohore, duke u thelluar edhe më tej dallimet me mësimdhënien tradicionale. “Struktura për të menduarit dhe të nxënët është një procedurë përmes së cilës mësuesit udhëheqin drejt arsyetimit. Ajo vetëm mund të përshkruhet për çdo pjesë të saj, por mund të perceptohet edhe si një strategji e ndërfutur dhe mjaft e lidhur. Struktura për të menduarit dhe të nxënësit është ndërtuar sipas parakushtit të mëposhtëm:*Njohuritë që një njeri zotëron janë kushti i parë për ato që mund të mësojë.* Struktura, këtu, është zhvilluar rreth përmbajtjes së një mësimi. Ajo nuk është e kufizuar vetëm në përmbajtjen e mësimi, por është e zbatueshme në të gjitha situatat e të nxënit.” (Borich, 2003, f.115).

### 3.2.1.1 Fazat e strukturës

Fazat e strukturës janë tri: evokimi, realizimi i kuptimit dhe reflektimi. Si mund ta kuptojmë fazën e evokimit? Përgjigja është edhe në mënyrën e parashtrimit të pyetjeve gjatë kësaj faze:

“E. I. *Evokimi* (diskutimi para përmbajtjes). Cila është tema? (dalloje atë) 2. Çfarë dini rreth saj? (radhiti në tabelë) 3. Çfarë prisni, dëshironi ose kenë nevojë të mësoni rreth saj? (radhiti në tabelë) 4. Çfarë doni të mësoni rreth saj?

R. II. Realizimi i kuptimit. I bërë prej nxënësit, në kohën kur kërkon informacion relativ në parashikimet.

R. III. Reflektimi (diskutimi pas përmbajtjes). 1. Çfarë mësuat? (zgjeroni pyetjet, sa më shumë të mundni) 2. Bëni pyetje me kundërpërgjigje, për të nxjerrë informacionin e papërmendur në fazën e evokimit. 3. Pas përgjigjeve të pyetjeve, mund të pyesni: “Pse mendoni kështu?”

Zbatimi i strukturës ndryshon në varësi të moshës dhe nivelit të nxënësve.”(Borich, 2003, f.115)

Struktura E.R.R. është e mirëmbajtur nga synimi për zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve. “Në ç’mënyrë është e lidhur kjo strukturë për mësimdhënien dhe të nxënët, me mendimin kritik? Sikurse kemi treguar, mendimi kritik kërkon aftësi për të gjykuar dhe për të reflektuar, se çfarë di dhe mendon dikush. Përpara se të ndodh kjo, nxënësit duhet të sjellin më parë njohuritë dhe arsyetimin e tyre në nivel të vetëdijshëm.... Reflektimi dhe analiza kritike kërkon qëndrim të vëmendshëm dhe krijues rreth mënyrës se si mund të zbatohen njohuritë në arsyetimin e mëparshëm dhe se si arsyetimi i mëparshëm mund të ndryshohet për të përshtatur informacionin e ri...”(Borich, 2003, f.115-116)

Struktura E.R.R. u jep mundësi të mëdha nxënësve, e jo vetëm mendimin. “Struktura “E.R.R.” është një kuptim i shkëlqyer i udhëheqjes së nxënësve në të gjitha kategoritë e niveleve përmes tekstit shkollor, i cili në shumicën e rasteve është përshkrues dhe ekspozues. Në fakt, sa më kompleks të jetë teksti, aq më i dobishëm është procesi. Pyetjet, të cilat janë të hapura, por drejtojnë të lexuarit e nxënësit, mund t’i japin kuptim materialit të ndërlikuar, duke siguruar një strukturë brenda së cilës ata mund të ndërtojnë të kuptuarit. Duke qenë e hapur, struktura nuk pengon analizën kritike dhe fton parashikimin dhe mendimin e hapur. Duke drejtuar të lexuarit dhe të nxënët, përmes përdorimit të strukturës ERR përmbushen detyra të ndryshme të rëndësishme të mësimdhënies. Në këtë mënyrë struktura ERR:

- U lejon nxënësve të vendosin qartë qëllimet.

- Ruan angazhimin aktiv.
- Provokon diskutimin e hapur.
- Nxiti nxënësit të krijojnë dhe të bëjnë pyetjet e tyre.
- Ndhmon shprehjen e mendimeve të nxënësve.
- Ruan motivimin e nxënësve për të lexuar. • Siguron një atmosferë ku respektohen mendimet.

- U lejon nxënësve të zhvillojnë simpatinë për dukuritë gjeografike. • Krijon një shtresë për reflektim në atë që nxënësit vlerësojnë.

- Shërben si stimulim për ndryshim.
- Ngjall shpresë për angazhimin kritik të nxënësve.
- Ndhmon mendimin kritik në nivele të ndërlikuara.” (Borich, 2003, f.115-116)

### 3.2.2 Teknikat e mësimdhënies bashkëkohore

Teknikat e mësimdhënies bashkëkohore janë të llojllojshme dhe të shumta. Disa nga teknikat më të njohura dhe më të aplikuara janë: Stuhi mendimesh ose “Brainstorming”, Insert, Kllaster, Harta e të Pyeturit etj.

#### 3.2.2.1 Brainstorming

“Brainstorming” u lejon nxënësve të japin sa më shumë asociacione, ide, pikëpamje, mendime dhe të shtjerrin krejt informacionin që kanë për një temë të caktuar, duke ia nxitur kështu edhe mendimin kritik.

“Kjo fjalë në anglisht - shqip do të thotë “stuhi mendimesh”. Brainstorming-u është një veprimtari që shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera. Qëllimi i përdorimit të Brainstorming-ut është të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë. Ka shumë rëndësi:

- Koha e shkurtër e zhvillimit të tij, 5-10 minuta.
- Sasia e zgjidhjeve. Brainstorming kërkon të mbahet parasysh:
- Asnjë prej zgjidhjeve e ideve të mos kritikohet.

- Të nxiten nxënësit të shprehin ide.
- Diskutimi të zhvillohet për gjëra të njohura.
- Të aktivizohen edhe nxënës të drojtur.
- Të shërbejë si nxehe e trurit.

Përdorimi i braistroming është i dobishëm.

- Zhvillon aftësitë pjesëmarrëse të të gjithë nxënësve.
- Rrit pavarësinë e gjykimit të nxënësve.
- Inkurajon nxënësit të shprehin atë që dinë.
- Jepen zgjidhje të parashikuara.
- Sugjeron arsye për të vazhduar diskutime në forma të tjera.
- Zbulon preferencat e nxënësve.
- Kërkon burime të pakta dhe të thjeshta. Brainstorming-u nuk mund të zhvillohet:
- Kur nxënësit nuk kanë njohuri për çështjen që shtrohet.
- Kur çështja (pyetja) kyç që ju përdorni për brainstorming nuk është formuluar mirë

(ka mangësi).

• Kur çështja (pyetja) kyç që ju përdorni, ka pak alternativa (ide) për zgjidhjen e problemit.”(Trëndafili, 2008, f.17-18)

### 3.2.2.2 Insert

Teknikë tjetër me rëndësi është edhe teknika e emërtuar “Insert”. “Insert është një metodë që i lejon nxënësit të kontrollojnë gjallërisht shkallën e tyre të të kuptuarit gjatë leximit. Nëpërmjet kësaj teknike sigurohet pjesëmarrja e qendrueshme e nxënësve në mësim. Gjatë leximit nxënësit udhëzohen që të vendosin shenjat e mëposhtme: “√”

Vendosni shenjën “√” (kontrollo), nëse diçka që lexoni pohon atë që dini ose mendoni se dini. “+”

Vendosni një “+” (plus), nëse një pjesë e informacionit që ndeshni është i ri për ju. “\_”

Vendosni një “\_” (minus), nëse një ose disa prej informacionit që lexoni kundërshton ose është e ndryshme nga ajo që dini ose mendoni se dini. “?”

Vendosni një “ ? ” (pikëpyetje), nëse ka informacion që është i paqartë për ju ose ka diçka që ju duhet të dini më shumë rreth këtij informacioni. Informacioni i shenjësuar, hidhet pastaj në tabelën insert sipas shenjave përkatëse. “ √ ” “ + ” “ - ” “ ? ”

Kjo teknikë përdoret në fazën e realizimit të kuptimit. Zbatimi i saj zgjat rreth 20-25 minuta.”(Trëndafili, 2008, f.19)

“Një formë e ngjashme e teknikës INSERT është teknika “Di/ Dua të di/ Mësoj”, skema e të cilës është paraqitur më poshtë. Di Dua të di Mësoj Në kolonën e parë, “Di”, nxënësit do të shkruajnë atë informacion që nga leximi u duket si i njohur. Në kolonën e dytë, “Dua të di”, do të shkruhen pyetje ose kërkesa të nxënësve, rreth çështjeve për të cilat ata kërkojnë të dinë më tepër. Në kolonën e tretë, “Mësoj”, nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje të informacionit të ri që përvetësuan nga teksti. Ka më tepër efektivitet kur përdoret me nxënësit e klasës V, VI.” (Trëndafili, 2008, f.19)

### 3.2.2.3 Harta e të pyeturit

Harta e të pyeturit ndihmon dhe lehtëson procesin e orientimit të lehtë të nxënësve në shqyrtime logjike të përmbajtjes mësimore. “• Teknika më bashkëkohore e të pyeturit në mësimin e gjeografisë është harta e të pyeturit. Ajo është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimin, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit. Përdormi i kësaj teknike ka disa përparësi:

- Hap rrugën për diskutim.
- Ndihmon nxënësit për të zhvilluar aftësi më të mëdha të të menduarit.
- Tërheq nxënësit në punët e pavaruara.
- Rrit rolin e nxënësve në mësim.
- Nxit të menduarit logjik.
- Nxit dhe tërheq nxënësit pasivë.”(Trëndafili, 2008, f.21)

### 3.2.2.4 Kllasteri



Kllasteri është teknikë tjetër e nxitjes së mendimit kritik dhe përpjekjes për të kapur potencialet e mëdha të nxënësve, lidhur me dituritë ekzistuese që kanë dhe refleksionit logjik të lidhjes midis tyre.

“Kllasteri, ose grupimi i mendimeve që, ndonjëherë, në literaturë emërtohet “harta e mendimeve”, është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, sidomos për ata nxënës që u mungon një dëshirë e tillë. Hapat për realizmin e klasterit janë të thjeshta dhe të lehta për t’u mbajtur mend:

- Shkruhet një fjalë në qendër të fletës, (dërrasës së zezë, apo sipërfaqes ku mund të shkruhet).
  - Shkruhen fjalë apo fraza që vijnë në mend rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
  - Kur idetë vijnë në mend të kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë nxënësit nuk duhet të shqetësohen për gabimet në shkrim apo në shqiptim.” (Trëndafili, 2008, f.22)

### 3.2.2.5 Tabela e koncepteve

Krahasimi është operacion i të menduarit mbi gjetjen e dallimeve dhe ngjashmërive ndërmjet dy dukurive, fenomeneve, objekteve, situatave etj. Tabela e koncepteve si teknikë e mësimdhënies aktive bashkëkohore, bazohet mbi këtë princip. “Është një teknikë racionale për të organizuar informacionin gjeografik. Përdoret veçanërisht kur jepen njëkohësisht më shumë se një koncept a dukuri. Ndhmon së tepërmi të kuptuarit, përmes strukturimit të materialit, pas leximit dhe në realizmin e skemave të qarta, që sigurojnë qendrueshmërinë e dijeve. Kjo teknikë përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit. Tabela e koncepteve hartohet duke renditur konceptet e dukuritë, që duhet të krahasohen dhe në kolona renditen tiparet apo karakteristikat mbi bazën e të cilave bëhet ky krahasim.” (Trëndafili, 2008, f.24)

### 3.2.2.6 Ditaret e të nxënësve

Nxitja e të menduarit kritik dhe të nxënimit aktiv nuk mund të mendohet edhe pa nxitjen e qëllimshme të nxënësve për të lexuar tekstet e për të ndarë përvojat e tyre përgjatë këtyre leximeve dhe interpretimeve tekstuale. Një teknikë e bazuar edhe në këtë përmbajtje, quhet “Ditaret e të nxënimit”.

“Ditaret e të nxënimit janë ditare dy ose tri pjesësh, që përdoren për të nxitur nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme, të lidhin ngushtë materialin e tekstit me kureshtjen dhe përvojat e veta. Përdoren në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit. Për të bërë ditarin dy pjesësh, hiqet një vijë vertikale në mes të fletës së fletores. Në anën e majtë shkruhen ato pjesë të tekstit, që i tërheqin më shumë vëmendjen nxënësit. Ndoshta ato që kujtojnë diçka, që i intrigojnë më shumë ose ndoshta ato mendime dhe opinione me të cilat ai nuk pajtohet. Në anën e djathtë të fletës shkruhen komente për pjesën.

Citati

Komenti

- Ç’elemente kishte citati që i intrigoji më shumë?
- Ç’i bëri të mendonin ai citim?
- Çfarë pyetjesh lindën prej tij?” (Trëndafili, 2008, f.24)

### 3.2.2.7 Kubimi

Kubimi është teknika tjetër me radhë e të nxënimit aktiv në klasë. “Kubimi është një teknikë që ndihmon shqyrtimin e një teme nga këndvështrime të ndryshme. Ai përfshin përdorimin e një kubi me lëvizje të shpejta për të menduarin, të shkruarin në secilën faqe të kubit. Mund të ndërtohet duke mbuluar një kuti të vogël me letër. Mënyra e zbatimit Në secilën faqe të kubit shkruhen 6 kërkesa të shkurtëra: Përshkruaje, krahasoje, shoqëroje, analizoje, argumentoje (pro ose kundër). Në fillim paraqitet tema. Më pas nxënësit udhëzohen të mendojnë për t’u dhënë përgjigje pyetjeve të mësuesit dhe ta përshkruajnë atë: (format, shenjat, përmasat, ngjyrat etj.).

*Përshkruaje:* Format, shenjat, përmasat, ngjyrat.

*Krahasoje:* Më kë ngjason? Nga se ndryshon?

*Shoqëroje:* Çfarë ju bën të mendoni? Çfarë ju vjen në mendje?

*Analizoje:* Si është ndërtuar? Nga se përbëhet?

*Zbatoje:* Ç’mund të bëni me të? Si mund të përdoret?

*Argumentoje:* Merr një qëndrim, pro ose kundër tij.” (Trëndafili, 2008, f.28)

### 3.2.2.8 Diagrami i Venit

Diagrami i Venit është një teknikë tjetër mësimore, e cila shfrytëzohet sidomos në faën e reflektimit, sipas strukturës E.R.R. “Diagrami i Venit është një teknikë, më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve, dukurive natyrore e shoqërore, peizazheve, rajoneve, shteteve, kontinenteve etj. • Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rathëve. • Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit, pothuajse në çdo orë mësimi. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimit, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to. • Veprimtaria zgjat 10’-20’, por është në varësi të temës, moshës dhe kohës së përgjithshme në dispozicion.”(Trëndafili, 2008, f.28)

### 3.2.2.9 Pesëvargëshi

Pesëvargëshi ndonëse e ndërtuar si teknikë me premisa të gjuhës, ajo në esencë është e ndërtuar në mendimin kritik. “Pesëvargëshi është një teknikë, e cila kërkon sintetizimin e burimeve të informacionit dhe një shprehje të saktë, që përshkruan apo reflekton idenë kryesore të një teme të caktuar. Pesëvargëshi është një vjershë me pesë rreshta. Pesëvargëshi ka një strukturë të caktuar

- Rreshti i parë është përshkrimi me një fjalë i temës (zakonisht emër);
  - Rreshti i dytë është përshkrimi në dy fjalë i temës (dy mbiemra);
  - Rreshti i tretë përman tri fjalë që shprehin veprime të temës (tri folje);
  - Rreshti i katërt është një fjali me katër fjalë që shprehin qëndrimin dhe ndjenjën për temën (fjali);
  - Rreshti i pestë është një fjalë sinonime që ripërcakton thelbin e temës (sinonim).”
- (Trëndafili, 2008, f.32)

Ka edhe shumë teknika të tjera për mësimdhënien bashkëkohore dhe të nxënësve aktiv, por nuk do të zgjerohemi më tej.

### 3.2.3 Mësimëdhënia bashkëkohore në shkollat e Kosovës nga paslufta e këtej

Kosova nuk ka pasur një traditë të gjatë të arsimit dhe funksionimit të shkollave sikur te popujt e tjerë të Ballkanit Perëndimor. Pa hyrë në historikun më të gjatë të arsimit kosovar, do të ndalemi pak vetëm në disa momente të rëndësishme të viteve para luftës së fundit, ku politika përcaktonte edhe llojin e lëndëve dhe planprogramin mësimor. Datë me rëndësi për propozimin e bërthamave të përbashkëta programore ishte viti 1986, tri vjet para suprimimit të autonomisë së Kosovës.

“Në bazë të konkluzioneve të Komisionit ndërrepublikan – ndërkrahinor për reformën e edukimit dhe të arsimit në RSFJ, më 27 dhe 28 shkurt 1986, në Beograd është mbajtur mbledhja e Grupit punues për hartimin e propozimit të bërthamave të përbashkëta programore të Gjuhës amëtare dhe të letërsisë. Me atë rast janë shqyrtuar këto çështje:

Propozimi i bërthamave të përbashkëta programore të Gjuhës amëtare dhe të letërsisë për edukimin dhe arsimin fillor,

Propozimi i bërthamave të përbashkëta programore të Gjuhës amëtare dhe letërsisë për edukimin dhe arsimin e mesëm të orientuar,

Këshillimi lidhur me aktivitetet e ardhshme të këshilltarëve të Gjuhës amëtare dhe të letërsisë (programet, normativat, përsosja profesionale e arsimtarëve etj.).” (Shema, 2000, f.40)

Sipas shënimeve të kohës, regjimi i atëhershëm jugosllav e përcaktonte edhe llojin e shkrimtarëve shqiptarë që do të ishin pjesë e kurrikulës së letërsisë shqipe në shkollat e Kosovës. “Janë hequr shumë krijime dhe autorë nga letërsia e traditës, por edhe nga ajo bashkëkohore shqiptare. Nga letërsia e sotme nuk janë përfshirë në programin mësimor disa autorë më të afirmuar, siç janë: Din Mehmeti, Jakov Xoxa, Rrahman Dedaj, Ramiz Kelmendi, Rexhai Surroi, Murat Isaku, Anton Pashku, Kolë Jakova etj.”(Shema, 2000, f.46)

Edhe në lekturën shtëpiake, po ashtu ishin reduktuar titujt të cilët nuk pëlqeheshin nga regjimi i atëhershëm diktatorial. “Lektura shtëpiake jo vetëm që është reduktuar pa kurrëfarë kriteri profesional (këtu është reduktuar letërsia shqiptare), por ka ndodhur edhe absurdi i tillë, që s’do ta lejonte askush, që sadopak merret me letërsinë dhe me mësimin e letërsisë në shkollë. Në lekturën shtëpiake në katër klasat e arsimit të mesëm, gjithsejt janë paraparë 35 tituj, prej tyre, 10 tituj bëjnë pjesë në letërsinë botërore, 13 të tjerë në letërsinë e popujve të Jugosllavisë dhe vetëm 12 njësi i përkasin letërsisë shqiptare. Në klasën e katërt, bie fjala,

prej gjithsejt 9 titujve të lekturës shtëpiake, vetëm një përmbledhje poezish i përket letërsisë shqiptare. Me këtë rast po e japim tabelën ku shihet qartë raporti i veprave letrare të propozuara në lekturën shtëpiake:

Klasa	Letërsia botërore	Letërsia jugosllave	Letërsia shqiptare	Gjithsej
I	3	4	4	11
II	1	3	4	8
III	1	3	3	7
IV	5	3	1	9
Gjithsej	10	3	12	35

*Tabela 2: Lëndët e shpërndara sipas kurrikulës jugosllave – Burimi: Shema, 2000.*

Nga lektura shtëpiake janë hequr këta autorë dhe këto vepra:

Ali Abdihojha: “Një vjeshtë me stuhi”

Nasi Lera: “Të jetosh kohën”

“Antologjia e letërsisë së vjetër shqiptare” (klasa I)

Azem Shkreli: “Pagëzimi i fjalës”

Santori: “Emira” (klasa II)

Migjeni: “Vargjet e lira”

Din Mehmeti: “Zog i diellit”

...” (Shema, 2000, f.47)

Në vitet e 90-ta të dekadës së fundit të shekullit XX, rrethanat e arsimit kombëtar në Kosovë ishin shumë të vështira, pasi filloi një “jetë paralele” e shqiptarëve, duke u larguar dhunshëm nga të gjitha fabrikat, institucionet gjyqësore, policore, kulturore, universitare etj. Në vijim, paragrafi i mëposhtëm na rikthen në ato vite, kur edhe arsimi ishte në gjendje skajshmërisht i shtypur.

“Arsimi kombëtar shqiptar sot është duke u zhvilluar në rrethana shumë të vështira dhe komplekse. Në Republikën e Kosovës arsimi si veprimtari e rendësishme, në të gjitha nivelet funksionon edhe në kushte të okupimit dhe të represionit të vazhdueshëm. Regjimi serb shqiptarëve ua mbylli shkollat, fakultetet dhe institucionet e tjera kulturore dhe shkencore. Janë uzurpuar lokalet shkollore, bibliotekat, laboratorët, konviktet e nxënësve dhe

të studentëve, sallat dhe terrenet sportive. Janë përjashtuar me dhunë nga puna punonjësit arsimore dhe shkencorë si dhe personeli tjetër administrativ e teknik...”(Shema, 2000, f.59)

Por arsimi në Kosovë, nuk e kishte bazën kurrikulare vetëm në kohën e udhëheqjes së Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe gjatë viteve 1941/1942 ishin bërë dhe hartuar disa plane mësimore edhe për territorin e Kosovës.

“Në Kosovë shkollimi i detyrueshëm fillor ishte 5-vjeçar. Këto shkolla punonin sipas të njëjtit program si ato në Shqipëri. Ky sistem 5-vjeçar pritej të zbatohet edhe nëpër fshatra ku do të ishte e mundshme. Për vitin shkollor 1941/1942 parashihej që më tepër të bëhej mësimi i gjuhës shqipe, i historisë dhe gjeografisë, i aritmetikës dhe i këngës...”(Veseli, 2003, f.21)

Në atë periudhë, mbizotëronte koha e luftërave të mëdha dhe nuk dihej se në cilat zona do të mbetej kjo apo jo pjesë e Kosovës. Situata globale dhe lokale ishte e paqartë, varësisht edhe nga zhvillimet që po ndodhnin me shpejtësi në Evropë e kudo tjetër. Plani mësimor edhe në atë kohë ndryshohej vazhdimisht, por jo edhe shumë, varësisht nga rrethanat politike dhe arsimore.

“Plani mësimor i shkollës fillore pesëklasëshe në Kosovë, qysh më 13.6.1941 pësoi pak ndryshime në fondin e orëve mësimore, duke shtuar atë në favor të gjuhës shqipe dhe duke zvogëluar të lëndët reale. Si i tillë, filloi të zbatohet në Kosovë që nga viti shkollor 1941/42:

Lëndët mësimore	Plani mësimor për shkollën fillore-fondi i orëve brenda javës				
	Kl. I	Kl. II	Kl. III	Kl. IV	Kl. V
Gjuhë shqipe	14 orë	14	14	13	13
Mësim jete e njohuri vendlindje	4/2	4/2	3	-	-
Artimetikë	5	6	6	6	6
Histori, gjeografi e mësim shtetnor	-	-	-	3	3
Mësim natyre e sendesh	-	-	-	2	2
Vizatim e punëdore	2/2	2/2	2/2	1	1
Kangë	2/2	2/2	2/2	1	1
Kangë	3	2	2	2	2
Gjithsej	25	26	27	28	28

*Tabela 3. Plani mësimor i zbatuar nga viti 1941/42. Burimi: Veseli, 2003.*

Pavarësisht se lufta ishte gjithandej, gjermanët sulmuan Beogradin e shumë ngjarje të tjera rajonale e globale, rindërtimi i institucioneve arsimore dhe përpilimet e zbatimet e planprogrameve mësimore vazhdonin të ishin pjesë e arsimit në Kosovë.

“Gjatë vitit shkollor 1940/41, në ditët e shkatërrimit të Jugosllavisë nga ushtritë gjermane dhe bullgare në trojet shqiptare në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore dhe në Mal të Zi ekzistonte një rrjet tejet i dendur i shkollave fillore në gjuhën serbe. Në këtë hapësirë shqiptare punonin gjithsej 417 shkolla fillore në gjuhën serbe: në Prishtinë me rrethinë 27 shkolla fillore, në Gjilan me rrethinë 21 shkolla fillore, në Ferizaj me rrethinë 16 shkolla fillore; në Prizren me rrethinë 30 shkolla fillore; në Dragash me rrethinë 10 shkolla fillore; në Suharekë me rrethinë 8 shkolla fillore; në Gjakovë me rrethinë 21 shkolla fillore; në Rahovec me rrethinë 21 shkolla fillore; në Serbicë (Skënderaj) me rrethinë 15 shkolla fillore; në Pejë me rrethinë 19 shkolla fillore...”(Veseli, 2003, f.15)

Edhe në atë kohë gjatë Luftës së Dytë Botërore, edhe gjatë viteve të '90-ta të shekullit XX, arsimimi i shqiptarëve ishte në gjendje shumë të vështirë. Madje, Veseli (2004) thekson se, “shkolla fillore jugosllave në viset me shumicë shqiptare ishin të rralla. Sipas politikës serbe, në vend të shkollave duhej hapur stacionin e xhandarmërisë. Me ligjin jugosllav çdo fëmijë i moshës 7-13 ishte obligues i shkollës fillore. Mirëpo, pikërisht mësuesit nuk e zbatonin këtë ligj arsimor, por merrnin mito prej 400-500 dinarësh për lirim të fëmijëve të tyre nga shkolla nga prindërit shqiptarë.” (f. 14)

Fakulteti i Edukimit që përgatiste mësimdhënësit e së ardhmes nuk e ka një histori të gjatë në Kosovë sikur kishin vendet evropiane. Ato u hapën disa vjet më vonë, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. “Shkolla e parë e lartë: Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë në vitin 1958... Shkolla e Lartë Pedagogjike “Bajram Curri” në Gjakovë më 1 tetor 1967... Shkolla e Lartë Pedagogjike “Skënderbeu” në Gjilan më 25 shtator 1975...”(Bajraktari, 2003, f.93-94)

Pas vitit 1999, nga Kosova largohen ushtria jugosllave dhe shqiptarët festojnë çlirimin e ndihmuar edhe nga SHBA, vendet e Bashkimit Evropian etj. Kosova doli nga një jetë paralele prej 10 vjetësh gjatë viteve të '90-ta në “shtëpitë shkolla”, në një infrastrukturë të shkatërruar të objekteve arsimore, qoftë nga lufta, qoftë nga vetë materiali i tyre i dikurshëm ndërtimor. Kosova pas vitit 1999 ndërton dhjetra shkolla anembanë Kosovës, riparon shumë prej tyre dhe adapton sistemin e Bolonjës në arsim. Bëhen shumë reforma në arsim, mësimdhënësit trajnohen nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare, vendore e

ndërkombëtare për mësimdhënien me në qendër nxënësin, duke u larguar nga praktikat e dikurshme që mësimdhënësi vetëm flet dhe nxënësi vetëm dëgjon. Ndryshon edhe mentaliteti i mësimdhënësit, por edhe i nxënësit, nën dritën e ndryshimeve të mëdha politike, shoqërore, ekonomike, kulturore, në nivel vendi, rajoni e globi; shoqërisë së hapur, kontakteve me botën e jashtme, përdorimi masiv i internetit nga shumica e popullsisë së Kosovës. Kurrikulat ndryshojnë me shpejtësi, mësimdhënësit herë licencohen për “kurrikulën e vjetër”, e herë me kurrikulën e re e të bazuar në zhvillimin e kompetencave të nxënësit.

Kosova gati për një dekadë drejtohej nën administrimin ndërkombëtar të UNMIK-ut dhe në vitin 2008, shpallet deklarata e pavarësisë. Kosovës nga një sistem i kompetencave të plota në fushën e arsimit dhe fushat e tjera prej UNMIK-ut, i barten kompetencat në duart e saj. Edhe pse Kosova para shpalljes së pavarësisë udhëhiqej nga UNMIK, kishte disa ligje me të cilat funksiononte arsimi parauniversitar dhe universitar, por pas vitit 2008, ndryshohen dhe plotësohen shumë ligje për arsimin.

Kosova bazuar në faqen zyrtare të organit më kompetent rreth arsimit, Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, ka këtë dokumentacion shkollor të rëndësishëm:

#### **“1. Shkolla fillore, klasa 1 - 5**

- 1.1 libreza,
- 1.2 dëftesa,
- 1.3 ditari,
- 1.4 libri amë dhe
- 1.5 fletëkalimi.

#### **2. Shkolla e mesme e ulët, klasa 6 - 9**

- 2.1 libreza,
- 2.2 dëftesa,
- 2.3 ditari,
- 2.4 libri amë dhe
- 2.5 fletëkalimi.

#### **3. Shkolla e mesme e lartë, klasa 10 - 12/13**

- 3.1 gjimnazi
  - 3.1.1 dëftesë, viti i 10-të,
  - 3.1.2 dëftesa, viti i 11-të,
  - 3.1.3 dëftesa, viti i 12-të,



- 3.1.4 dëftesa, viti i 13-të,
- 3.1.5 diploma,
- 3.1.6 ditari,
- 3.1.7 libri amë dhe
- 3.1.8 regjistri për certifikatat dhe diplomat e lëshuara.

### **3.2 Shkollat profesionale**

- 3.2.1 dëftesa, viti i 10 - të,
- 3.2.2 dëftesa, klasa e 11-të,
- 3.2.3 dëftesa, klasa e 12-të,
- 3.2.4 dëftesa, klasa e 13-të,
- 3.2.5 certifikata,
- 3.2.6 diploma,
- 3.2.7 ditari,
- 3.2.8 libri amë dhe
- 3.2.9 Regjistri për certifikatat dhe diplomat e lëshuara.

### **3.3 Shkolla artistike e muzikës**

- 3.3.1 ditari për mësim individual

### **3.4 Shkolla fetare- medreseja**

- 3.4.1 dëftesat dhe
- 3.4.2 diploma.

### **3.5 Aftësimi profesional**

- 3.5.1 dëftesa dhe
- 3.5.2 diploma.”(MASHT, n.d.)

Ndërsa sipas sistemit të vjetër shkollor, është ky dokumentacion:

“4 Dokumentacioni sipas sistemit të vjetër shkollor

- 4.1 Dëftesa për kryerjen e shkollës fillore klasa 1- 8,
- 4.2 Dëftesa për gjimnaze,
- 4.3 Dëftesa për shkolla profesionale,
- 4.4 Diploma për gjimnaze dhe

#### 4.5 Diploma për shkolla profesionale.”(MASHT, n.d.)

Ky dokumentacion shkollor është jo vetëm në gjuhën shqipe, pasi që në Kosovë njihen të drejtat e pakicave dhe respektimi i gjuhës së tyre.

“Dokumentacioni shkollor është hartuar dhe botuar sipas sistemit dhe kurrikulit të ri arsimor. Dokumentacioni shkollor është botuar në gjuhën shqipe, gjuhën boshnjake dhe në gjuhën turke. Dokumentacioni është botuar nga shtëpia botuese “Libri shkollor” dhe “Dukagjini” dhe gjenden në shitje në libraritë e “Librit shkollor” dhe të “Dukagjinit”...”(MASHT, n.d.)

Sistemi arsimor parauniversitar bazohet sidomos në Ligji Nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, i miratuar me ndryshime, më 29 gusht 2011. Por fusha e arsimit parauniversitar ishte e rregulluar me ligj pak vjet pas luftës së fundit në Kosovë, duke u shkëputur nga sistemi i atëhershëm arsimor jugosllav. “Arsimi parauniversitar rregullohet me Ligjin mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, nr.2002/2 të datës 31 dhjetor 2002. Fushat të cilat nuk janë paraparë me Ligjin mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm, janë plotësuar me akte nënligjore si :

- Përtëritja e dokumentacionit shkollor të asgjësuar nga Lufta,
- Mundësia e avancimit të nxënësve të talentuar,
- Ekuivalenca dhe nostrifikimi i dokumenteve shkollore të ardhur nga shtete jashtë Kosove,
- Kalimi i nxënësve të shkollave të mesme të larta prej një profili në profilin tjetër arsimor,
- Mësimi i gjuhëve të komuniteteve të cilët nuk e kanë gjuhën shqipe gjuhë amtare,
- Regjistrimi i nxënësve në klasat e 10-ta,të adhur nga vendet tjera, me sistem të vjetër arsimor,
- Mbarimi i shkollimit me sistem të vjetër arsimor,
- Themelimi i shkollave dhe i paraleleve të ndara fizike,
- Emërtimi dhe riemërtimi i shkollave,
- Kodi i mirësjelljes për nxënësit e shkollave të mesme të larta, etj.”(MASHT, n.d.)

Të gjitha ligjet më me rëndësi në fushën e arsimit, të cilat janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë:

- LIGJI Nr. 05/L -018 Për Provimin e Maturës Shtetërore, i miratuar më 14 dhjetor 2015;
- Ligji Nr. 03/L-018 Për Provimin Përfundimtar dhe provimin e Maturës Shtetërore, i miratuar më 6 nëntor 2008;
- Ligji Nr. 03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare, i miratuar më 7 nëntor 2008;
- Ligji Nr. 03/L-068 Për Arsimin në Komunatë Republikës së Kosovës, i miratuar më 21 Maj 2008;
- Ligji Nr. 02/L-67 Për Botimin e Teksteve Shkollore, Mjeteve Mësimore, Lektyrës Shkollore dhe të Dokumentacionit Pedagogjik, i miratuar më 29 qershor 2006 dhe akoma nuk ka ndryshuar, që nga baza e Kreut 5.1 (e) dhe 9.1.26 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjes të Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001);
- Ligji mbi Edukimin Parashkollor, i miratuar më 6 mars 2006, periudha e UNMIK-ut;
- Ligji Nr.04/L-138 Për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, 28 shkurt 2013;
- Ligji Nr.2004/37 Për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, 8 shtator 2004, periudha e UNMIK-ut;
- Ligj për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, 29 gusht 2011;
- Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, 29 gusht 2011.”(MASHT, n.d.)

Pas miratimit të ligjeve, hartimi dhe përpilimi i kurrikulave arsimore ishte ndër hapat më të rëndësishëm. Dokumentet kryesore kurrikulare në arsimin parauniversitar të Kosovës janë:

- Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë (2016)
- Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës (2016)
- Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës (2016)
- Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës (2017)
- Udhërrëfytyesi për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021

## 4. KAPITULLI IV – KURRIKULA ARSIMORE

### 4.1 Definicionet mbi kurrikulën

Kurrikula është bërë ndër konceptet më të përdorura nga arsimtarët e mësimdhënësit e nivelit parauniversitar. Duke u shfrytëzuar si nocion në shkolla, ka marrë përmasa të mëdha njohëse edhe në hapësirën e gjerë publike, duke u zënë në gojë nga gazetarë, politikanë etj. Por ç’kuptim ngërthen më vete nocioni “kurrikul”? Përgjigjet nuk janë edhe aq të lehta, pasi që edhe vetë origjina e kuptimit të saj, mund të duket e largët për të kuptuarit e sotëm. Po ashtu, edhe për të ka pikëpamje të ndryshme përkufizimi. “Për kurrikulën ka mendime të ndryshme dhe si nocion në arsim ka filluar të përdoret në ShBA në vitet ’60-ta të shekullit të kaluar (shek. XX). Ndërsa në Kosovë ky nocion në terminologjinë pedagogjike ka filluar të përdoret pas vitit 2000.”(Neziri, 2018, f. 30)

Sipas dokumenteve të rëndësishme të Bashkimit Evropian, “kurrikula mund të kuptohet si:(a) një përshkrim të një trupi të njohurive ose të një grupi aftësish;  
(b) një plan të mësimdhënies dhe mësimi;  
(c) një standard ose kontratë të rënë dakord - një standard i detyrueshëm ose normativ që autorizon dhe rregullon mësimdhënien dhe të nxënit;  
(d) përvojën e nxënësve me kalimin e kohës.

Në varësi të qëllimit të hulumtimit, kurrikula mund të përkufizohet në termat e një, disa ose të gjitha këtyre dimensioneve. Në studimin e Cedefop:...kurrikula përcaktohet si çdo shkrim-dokument që rregullon ose drejton planifikimin e përvojave të të nxënit: 'A është kurrikula një dokument normativ (ose një koleksion i dokumenteve) që përcakton korniza për planifikimin e përvojave të të mësuarit (siç e përmend Cedefop, 2010a, f. 20). European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in*

Sipas përkufizimeve të ndryshme nocioni *kurrikul* mund të përfshijë çdo përvojë dhe veprimtari të punës së njeriut. Fjala *kurrikul* rrjedh nga gjuha latine dhe si e tillë do të thotë “jetërrjedha, përvoja jetësore”...(Neziri, 2018, f. 30) Një nga shpjegimet e zakonshme që jepet edhe për kurrikulën, është edhe bazuar në këtë etimologji të huaj latine, por kuptimet e saj kanë evoluar shumë deri më tash. Nëse i kthehemi këtij kuptimi, atëherë kemi këtë përgjigje: “Lat: curriculum, nga fjala currere-vrapoj, rend; d.m.th. ecuria e vitit – fjalë e përdorur në arsim me kuptimin e planit mësimor me qëllime të caktuara.” (Neziri, 2018, f. 30)

Autori Neziri (2018) jep pesë pikëpamje apo përkufizime të ndryshme: “Kurrikula mund të përkufizohet si një plan për veprim që përfshin strategjinë për arritjen e objektivave ose qëllimeve të dëshiruara, ky është një përkufizim bihevorist.”(f. 30) Ndërsa përkufizimi tjetër sipas Nezirit (2018) është: “J. Galen kurrikulën e përkufizon si një plan për sigurimin e disa mundësive të të mësuarit për njerëzit që do të arsimohen” (siç e përmend Saulor, Alexander & Lewis, 1939). Ndërsa Neziri (2018) duke e cituar autorin tjetër për përkufizimin e kurrikulës, thotë: “David Prat shkruan: Kurrikula është një tërësi e organizuar synimesh për arsimim dhe formim zyrtar. Megjithatë kurrikula mund të përkufizohet si fusha që trajton përvojat e nxënësve, të gjitha përvojat që fëmijët përfitojnë nën udhëzimet e mësuesve (siç e përmend Dewey, 1938).

Autori Neziri (2018) e përmbledh dhe paraqet edhe një nga përkufizimet e tjera mbi kurrikulën, që është mjaft relevant për ta paraqitur edhe këtu. “Ndërsa Shepherd dhe Ragan mendojnë se kurrikula përbëhet nga përvoja e vazhdueshme e fëmijëve nën orientimin e shkollës. Ajo përfaqëson një mjedis të veçantë që i ndihmon fëmijët të arrijnë vetërealizimin nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në shkollë (siç e përmend Shepherd & Ragan). Dhe në fund, autori Neziri (2018) citon edhe autorët e tjerë: “Në bisedat tona për kurrikulën duhet të kemi kujdes të përdorim “gjuhën dialektore standarde”. Ne duhet të jemi të sigurt se hartuesit e kurrikulës nuk do të vendosin elemente politike (siç e citon Posner) për të hartuar një dokument kurrikular të zbatueshëm dhe efektiv ekspertët do të vendosin para vetes disa pyetje themelore. Këto pyetje shërbejnë si bazë për shqyrtimin e çështjeve dhe problemeve kurrikulare për atë kohë (siç e përmend Harold Rugg, G. M. Whipple, 1930).”

Kur flitet ndonjëherë për kurrikulën dhe lëndët përkatëse, si për shembull, matematikën, kurrikula shihet si mënyrë se si nxënësit arrijnë të marrin një rol interaktiv dhe si të kuptojnë në mënyrën më efektive. “Vëmendja në kurrikulën u përqendrua në atë se si nxënësit në mënyrë efektive interpretuan, tërhoqën, dhe kuptuan grafikët e duhur në nivelet e tyre të klasës duke u mbështetur në intuitat e tyre dhe imazhet, duke përfshirë rolin e rëndësishëm të metaforave të krijuara në mënyrë individuale, si në ndërtimin e përgjithësimeve, ashtu edhe në zhvillimin dhe mbajtjen e domethënies apo kuptimeve.”(Rivera, 2011, f. 8)

Ka edhe pikëpamje të tjera kur diskutohet për kurrikulën, duke e vënë atë në kontekst të mësimin formal, joformal dhe informal. Singh (2015) e thotë këtë mendim: “Struktura e kurrikulës mund të vlerësohet në këtë mënyrë reagimi ndaj bashkëveprimit midis kurrikulave formale dhe rezultateve nga joformalizimi dhe të mësuarit informal.”(f. 25) Të njëjtën pikëpamje e shprehin edhe Melnic dhe Botez (2014), duke bërë dallimin e tri formave të edukimit, edhe përmes kurrikulës. Sipas tyre, kurrikula bën pjesë në formën e parë të edukimit – edukimit formal. “Edukimi formal korrespondon me një model sistematik, të arsimit të organizuar, të strukturuar dhe administruar sipas një grupi të caktuar ligjesh dhe normash, duke paraqitur një kurrikulë mjaft të ngurtë, përkitazi me objektivat, përmbajtjen dhe metodologjinë formale...”(f. 114)

Sipas të gjitha përkufizimeve, kurrikula është e organizuar, e sistematizuar, e planifikuar, e përcaktuar, e menaxhuar dhe e përmbledhur nga hapi i parë gjer në hapin e fundit. Kurrikula është përmbledhje dhe strukturim idesh, përmbajtjesh, veprimesh, metodash dhe planesh rreth ecurisë së punës mësimore, në mënyrë që nxënësit të arrijnë ato rezultate që i përcaktojmë në një vend dhe kohë të caktuar. Kurrikula për nga vetë natyra, edhe nga definicioni i lartcituari, është më pak elastike dhe fleksibile, ndonëse me kurrikulat e reja, parashihet edhe një liri dhe autonomi më e madhe e mësimdhënësve në mënyrat e veprimit të tyre, nëse përmes tyre arrihen rezultatet e kërkuara. Me rëndësi parësore, sipas kurrikulës së re dhe të fundit në nivelin parauniversitar, janë rezultatet.

Prandaj, përkufizimi më i pranueshëm për kurrikulën do të ishte se nuk është tërësisht e ngurtë, për të mos u pajtuar me definicionin e lartshënuar, por në përgjithësi duket e ngurtë në pamje të parë, dhe në pamje të dytë, me disa hapësira të lira veprimi nga mësimdhënësit,

për t'iu përshtatur jo vetëm ata dhe ato kësaj kurrikule, por edhe kurrikula t'i përshtatet vetë mësimdhënësve.

## 4.2 Llojet e kurrikulës

Kurrikulat mund të jenë të llojllojshme, varësisht nga kriteret që vëmë për t'i klasifikuar dhe tipologjizuar ato. Në hulumtimin empirik me mësimdhënësit e shkollave në Komunën e Prishtinës, zakonisht mësimdhënësit i referoheshin dy llojeve të kurrikulave: kurrikulave të vjetra dhe kurrikulave të reja. Me kurrikula të vjetra, nënkuptonin kurrikulat para vitit 2016, ndërsa ato me kurrikula të reja, ato që janë vënë së fundi në praktikë dhe atë, vetëm në disa klasë apo nivele të arsimit parauniversitar. Madje, ka pasur raste kur klasave me kurrikula të vjetra, iu kanë referuar edhe si “klasa pa kurrikulë”, në kuptimin që nuk janë me kurrikulat e reja e të fundit, të miratuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Por kjo që po shkruajmë, i referohet praktikave të ngushta të një komuniteti të mësimdhënësve lokalë, ndërsa teoricientët e kurrikulave, përpiqen që klasifikimet e kurrikulave, t'i bëjnë me kritere sa më universale dhe gjithëpërfshirëse. Sudiues të ndryshëm kanë klasifikuar lloje të ndryshme kurrikulash. Në shkrimin e publikuar (Wilson, n.d.) ka disa tipa të kurrikulës, të cilat do t'i rendisim si më poshtë:

“1. Kurrikula e shmangur, e qartë ose e shkruar

Është thjesht ajo që shkruhet si pjesë e mësimi formal të përvojave shkollore. Ajo mund t'i referohet një dokumenti kurrikulumi, teksteve, filmave dhe materialeve mbështetëse mësimore të cilat janë të zgjedhura hapur për të mbështetur axhendën mësimore të një shkolle të qëllimshme. Kështu, kurrikula e hapur zakonisht kufizohet në ato kuptime dhe udhëzime të shkruara të përcaktuara zyrtarisht dhe të shqyrtuara nga administratorët, drejtorët e kurrikulumeve dhe mësuesit, shpesh kolektivisht.

## 2. Kurrikula shoqërore (ose kurrikula sociale)

Siç përcaktohet nga Cortes (1981). Cortes e përkufizon këtë planprogram si: ... programin masiv, të vazhdueshëm, joformal të familjes, grupeve të bashkëmoshatarëve, lagjeve, kishave, organizatave, profesioneve, mediave dhe forcave të tjera shoqërore që "edukojnë" të gjithë në gjatë gjithë jetës sonë. Ky lloj i kurrikulave tani mund të zgjerohet për të përfshirë efektet e fuqishme të mediave sociale (YouTube, Facebook, Twitter, Pinterest etj) dhe si ndihmon në mënyrë aktive në krijimin e perspektivave të reja dhe mund të ndihmojë në formimin e opinionit individual dhe publik.

## 3. Kurrikula e "fshehur" apo e "mbuluar"

Ajo që nënkuptohet nga vetë struktura dhe natyra e shkollave, shumica e asaj që sillet rreth rutinave të përditshme ose të vendosura. Longstreet dhe Shane (1993) ofrojnë një përkufizim të pranuar përgjithësisht për këtë term - "kurrikula e fshehur", e cila i referohet llojeve të të mësimave të fëmijëve rrjedhin nga natyra dhe dizajni organizativ i shkollës publike, si dhe nga sjelljet dhe qëndrimet e mësuesve dhe administratorëve .... " Shembujt e kurrikulës së fshehtë mund të përfshijnë mesazhet dhe mësimet e nxjerra nga thjesht organizimi i shkollave... mesazhe të disiplinuar ku përqendrimi barazohet me sjelljet e nxënësve nëse ata janë të ulur drejt dhe janë vazhdimisht të qetë; studentët që hyjnë dhe qëndrojnë në radhë në heshtje; studentët në heshtje ngritën duart për t'u thirrur; konkurrenca e pafundme për klasat dhe kështu me radhë. Kurrikula e fshehur mund të përfshijë mesazhe pozitive ose negative, varësisht nga modelet e ofruara dhe perspektivat e nxënësit ose të vëzhguesit... Pjesa më e madhe që kalon për arsimin nuk është arsim fare por ritual...

## 4. Kurrikula e pavlefshme ose zero

Eisner (1985, 1994) përshkroi dhe përkufizoi aspekte të kësaj kurrikule. Ai thotë: Ka diçka të një paradoksi të përfshirë në shkrimin e një kurrikulumi që nuk ekziston. Megjithatë, nëse jemi të shqetësuar me pasojat e programeve shkollore dhe rolin e kurrikulës në formësimin e këtyre pasojave, më duket se ne jemi të këshilluar që të marrin në konsideratë jo vetëm programet mësimore eksplicite dhe të nënkuptuara të shkollave por edhe atë që shkollat nuk mësojnë. Është teza ime se ajo që shkollat nuk japin mësim mund të jetë po aq e rëndësishme sa ajo që ato mësojnë... Nga këndvështrimi i Eisnerit kurrikula zero është thjesht ajo që nuk mësohet në shkolla.

## 5. Kurrikula fantome



Mesazhet mbizotërojnë në dhe nëpërmjet ekspozimit ndaj çdo lloji të medias. Këto komponente dhe mesazhe luajnë një rol të madh në enkulturimin e studentëve në meta-kulturën mbizotëruese, ose në akulturimin e nxënësve në nënkultura më të ngushta ose subkultura...

#### 6. Kurrikula e njëpasnjëshme

Çfarë mësohet, ose theksohet në shtëpi, ose ato përvoja që janë pjesë e përvojave të familjes ose përvojat përkatëse të sanksionuara nga familja. (Ky lloj i kurrikulit mund të merret në kishë, në kontekstin e shprehjes fetare, mësimet mbi vlerat, etikën ose moralin, sjelljet e formuara ose përvojat shoqërore bazuar në preferencat e familjes.)

#### 7. Kurrikula retorike

Elementet nga kurrikula retorike përbëhen nga idetë e ofruara nga politikëbërësit, zyrtarët e shkollës, administratorët ose politikanët. Ky planprogram mund të vijë edhe nga profesionistët e përfshirë në formimin e koncepteve dhe ndryshimet e përmbajtjes; ose nga ato nisma edukative që rezultojnë nga vendimet e bazuara në raporte kombëtare dhe shtetërore, në fjalime publike ose nga tekste që kritikojnë praktikën e vjetruara arsimore. Kurrikula retorike mund të vijë edhe nga veprat e publikuara që ofrojnë përditësime në njohuritë pedagogjike.

#### 8. Kurrikula në përdorim

Kurrikula formale (e shkruar ose e hapur) përfshin ato gjëra në tekstet shkollore, si dhe përmbajtjet dhe konceptet në udhëzimet e kurrikulumit të qarkut. Megjithatë, ata elementë "formalë" shpesh nuk mësohen. Kurrikula në përdorim është kurrikula aktuale që dorëzohet dhe paraqitet nga secili mësimdhënës.

#### 9. Kurrikula e marrë ose e pranuar

Këto gjëra që nxënësit në të vërtetë nxjerrin nga klasat; ato koncepte dhe përmbajtje që mësohen me të vërtetë dhe kujtohen.

#### 10. Kurrikula e brendshme

Proceset, përmbajtja, njohuria e kombinuar me përvojat dhe realitetet e nxënësit për të krijuar njohuri të reja. Ndërsa edukatorët duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë program, ata kanë pak kontroll mbi planprogramin e brendshëm, pasi që është unik për secilin nxënës. Edukatorët mund të eksplorojnë këtë kurrikulë duke përdorur vlerësime instruksionale...,

ushtrimet reflektuese ose diskutimet e diskutimeve për të parë se çfarë nxënësit me të vërtetë e kujtojnë nga një mësim. Shpesh është shumë ndriçues dhe befasues për të gjetur se çfarë ka kuptim për nxënësit dhe çfarë jo.

#### 11. Kurrikula elektronike

Këto mësimet të nxjerra nëpërmjet kërkimit të Internetit për informacion, ose përmes përdorimit të e-formave të komunikimit. (Wilson, 2004) Ky lloj i kurrikulës mund të jetë formal ose joformal, dhe mësimet e qenësishme mund të jenë të hapura ose të fshehta, të mira ose të këqija, të sakta ose të pasakta në varësi të pikëpamjeve të tyre. Nxënësit që përdorin internetin në mënyrë të rregullt, si për qëllime rekreative (si në blogje, wikis, chatrooms, listserves, përmes lajmëtarëve të menjëhershëm, bisedave on-line, ose nëpërmjet e-mail personale dhe faqet si Twitter, Facebook, ose Youtube) dhe për hulumtime personale dhe mbledhje informacioni në internet bombardohen me të gjitha llojet e mediave dhe mesazheve. Pjesa më e madhe e këtyre informatave mund të jenë faktikisht korrekte, informuese, madje edhe argëtuese ose frymëzuese. Por ka edhe shumë informacione të tjera elektronike që mund të jenë shumë të pasakta, të dala, të kaluara, të njëanshme, të çoroditura apo madje manipuluese. Leslie Owen Wilson. Ed. D. (n.d.). *Types of Curriculum.* Marrë prej <https://thesecondprinciple.com/instructional-design/types-of-curriculum/>

### 4.3. Teoritë mbi kurrikulën

Teoritë mbi kurrikulën kanë pësuar transformime të mëdha prej fillimit e gjer në ditët e sotme. Xhon Dju ishte ndër nismëtarët e teorive kurrikulare. Fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX konsiderohen edhe nga autorë e hulumtues të tjerë para nesh, të cilët kanë pasur si objekt studimi kurrikulën, se është ndër periudhat e fillimeve të strukturuar teoritizuese mbi kurrikulat. Këta janë edhe teoriticienët që mësohen dhe citoen edhe nga doktorantët të tjerë rreth kurrikulës (Xhomara, 2015), e që janë: Elisabet dhe Xhorxh Macia, Mauric Xhonson, Xhejms Mekdonalld, Herbert Kliebard, Majkëll Stefën Shiro etj. Ne do të ndajmë shkurtimisht dy nga teoriticienët e fundit.

Neziri (2018) në shqyrtimin e teorive mbi kurrikulën mësimore thotë: “Një numër i studimeve të reja për zhvillimet kurrikulare (në vitin 1970) ka filluar të merren me kuptime të

reja dhe të shumëllojshme kurrikulare. Pinar me revistën e tij *Journal of Curriculum Theorizing* ishte forca kryesore e ndryshime kurrikulare të kohës.” (f. 32)

#### 4.3.1 Teoria e Herbert Kliebard mbi kurrikulën

Herbert M. Kliebard, ka një pikëpamje të njohur se, kurrikula ndikohet nga disa dinamika sociale, politike dhe ekonomike, të cilat e përcaktojnë përmbajtjen e kurrikulës. “Kurrikula është një fushëbetejë në arsim (Spring, 1996). Grupet e biznesit, reformatoret radikalë, organizatat fetare, krahët e krahut të majtë ... të krahut të djathtë dhe shumë grupe të tjera duan që shkollat publike t'u mësojnë lëndët dhe programet e drejtpërdrejta për t'i shërbyer interesave të tyre. Gjatë viteve 1900, dhe deri më sot, kurrikula ka ndryshuar për motivet politike, ekonomike dhe sociale.” School of Education-Oregon State Universit. (1998). *Integration of the Disciplines Politics of Education*. Marrë prej <http://oregonstate.edu/instruction/ed555/zone2/politics.htm>

Në teorinë e Herbert M. Kliebard janë të njohura katër lloje të kurrikulave. “Në Luftën për Kurrikulën Amerikane, 1893-1958, Herbert M. Kliebard identifikon katër lloje të kurrikulave që kanë mbizotëruar në dominimin në shkollat amerikane. “*Kurrikula e Efiçencës Sociale* mbështetet nga ata që kryesisht dëshirojnë që shkollat t'i shërbejnë nevojave të ekonomisë. Ajo është projektuar për të përgatitur studentët për forcë pune. *Humanizmi* ka për qëllim që të ketë kurrikulën t'i njohë studentët me traditat kulturore të shoqërisë. Një humanist hedh poshtë idenë se roli i shkollës është të përgatisë studentët për forcën e punës dhe të punojë drejt zhvillimit të aftësive të përgjithshme intelektuale. Shpesh humanisti dëshiron që kurrikula të organizohet rreth lëndëve akademike si letërsia, historia, gjuha e huaj, artet dhe shkenca. *Meliorizmi social* kërkon që kurrikula të sjellë përmirësim dhe ndryshim social. Meliorizmi social reflekton lëvizjen e reformës në arsimin amerikan. Ndonjëherë kjo do të thotë se edukimi i studentëve është të sjellë ndryshime të përgjithshme politike dhe ekonomike, por më shpesh kjo do të thotë avokim i kurseve për të zgjidhur probleme të tilla si SIDA, racizmi, abuzimi i drogës dhe seksizmi. *Zhvillimorizmi* organizon kurrikulën rreth zhvillimit psikologjik të nxënësit. Kjo do të thotë se kurrikula fokusohet në nevojat e nxënësit individual. Nga këto katër lloje të kurrikulave, zhvillimi ka pasur ndikimin më të vogël në programet shkollore publike. Kurrikula e nxënësve në qendër të zhvillimit të

zhvilluesve shpesh refuzohet nga mbështetësit e tre llojeve të tjera të kurrikulave për të qenë antiintelektual dhe nuk i japin nxënësit aftësitë e nevojshme për të funksionuar në shoqëri dhe në botën e punës.” School of Education-Oregon State Universit. (1998). *Integration of the Disciplines Politics of Education*. Marrë prej <http://oregonstate.edu/instruction/ed555/zone2/politics.htm>

Pikëpamjet e Kliebard janë me qasje integruese, inkluzive dhe sintetizuese. Ai nuk ishte fanatik i asnjërës kurrikulë të mësipërme, por kërkonte që t’i gjitha t’i integronte dhe të mos i ndante, apo njëra ta dominonte tjetrën dhe anasjelltas. “Katër modelet e paraqitura më sipër nuk duhet të jenë të ndara dhe të pavarura. Një ambient cilësor i mësimit kontekstual duhet të artikulojë këto katër qëllime të kurrikulës. Një mjedis mësimor kontekstual duhet t’u shërbejë nevojave të ekonomisë dhe të përgatisë studentët për forcën e punës. Një mjedis mësimor kontekstual duhet të zhvillojë aftësitë intelektuale. Një mjedis mësimor kontekstual duhet të avokojë për zgjidhjen e problemeve reale të shoqërisë. Një mjedis kontekstual duhet të përqendrohet në nevojat e nxënësit individual. Këto modele nuk duhet të jenë segraguara. Me një gatishmëri për të provuar dhe një mendim pak, këto modele mund të integrohen në një mjedis mësimor kontekstual për të mirën e nxënësit dhe shoqërisë.” School of Education-Oregon State Universit. (1998). *Integration of the Disciplines Politics of Education*. Marrë prej <http://oregonstate.edu/instruction/ed555/zone2/politics.htm>

#### **4.3.2 Pikëpamjet Michael Stephen Schiro mbi kurrikulën**

Majkëll Stefën Shiro (Michael Stephen Schiro) është ndër kontribuesit më të rëndësishëm të përmbledhjes së historikut të zhvillimit të teorisë mbi kurrikulën dhe po ashtu ndër teoricienët më të njohur mbi kurrikulën. Ai e ndërlidh kurrikulën me llojin e ideologjisë dhe në veprat e tij, zakonisht do ta hasni këtë nocion, për ta shpjeguar ideologjinë edhe si çdo lëvizje në botë mbi ndryshimet kurrikulare. Shiro (2013) lidhur me të gjitha ndryshimet dhe lëvizjet mbi kurrikulat, si dhe teoritë mbi to, shprehet përmbledhtazi si më tutje:

“Secila prej ideologjive të kurrikulumit ka një histori. Njohja e traditave jashtë nga të cilat secili prej tyre krijon një ndjenjë të rëndësishme të perspektivës. Edhe pse origjina dhe evolucioni i çdo ideologjie siguron një studim interesant në vetvete, ky libër do të brengoset vetë me ideologjitë vetëm pasi ato kanë ekzistuar që nga viti 1880. Ideologjia e Akademisë

Shkollë, do të shqyrtohet duke eksploruar periudhën e zhvillimit të kurrikulës që rezultoi nga puna e çarls Elliot dhe Komiteti i Dhjetë në vitet 1890, Lëvizja "kurrikula e re" e viteve 1960 dhe Lëvizja e literaturës kulturore të E. D. Hirsch në fund të shekullit të 20-të. Natyra e ideologjisë së Efiçencës Sociale do të hulumtohen duke shqyrtuar traditën që lidh Franklin Bobbittin, Ralf Tajllerin dhe Garën në Fondin e Fundit (dhe paraardhësi i tij, Asnjë Fëmijë i Lënë Prapa Aktit). Gjurmimi i evolucioni të ideologjisë së përqendruar tek nxënësi do të na çojë në një ekzaminim të vazhdimësisë së besimit të bashkuar në punën e Francis Parker në shekullin e 19, Lëvizja Progresive Arsimore në gjysmën e parë të shekullit të 20-të, dhe Arsimin e hapur, praktikën e duhur zhvillimore, dhe Lëvizjet konstruktive të 50 viteve të fundit. Ekzaminimi i ideologjisë së Rindërtimit Social do të përfshijë një hulumtim të traditës, e nisur publikisht nga Xhorxh Kounts, që ka evoluar në të tashmen Lëvizjen e Drejtësisë Sociale.” (f. 8)

#### 4.3.3 Pikëpamjet e tjera mbi kurrikulën

Ndër teoritë nga e cila ndikoheshin edhe teoriticientët e sipërpërmendur ishte Xhon Djuj (John Dewey). Sipas teorisë së tij, kurrikula nuk duhet të jetë jashtë asaj që e jeton fëmija. Kurrikula duhet t'i përshtatet botës së fëmijës, duke e kushtëzuar lidhjen e ngushtë, reciproke dhe konkrete, në mënyrë krejt të pandashme, në mes të lëndëve dhe jetës së fëmijës. “Në fakt, Dewey mendonte se kishte thjesht shumë lëndë të ndryshme që mësohen në shkollë dhe atë lëndë të reja po përfshiheshin në kurrikulë vazhdimisht dhe lëndët e vjetra po shkonin duke u ndarë. Duket të jetë ajo që ai e quajti një "mbingarkesë në kurrikulën "(siç e përmend Dewey 1966, f.185). Si, pyeti ai, munden të gjitha këto lëndë të integrohen dhe të bëhen për të përforcuar njëra-tjetrin? "Fëmija fillon, "tha Dewey," para se të shkojë në shkollë të paktën, me një unitet të përvojës, jo me një numër lëndësh ose studimesh të ndryshme. Problemi themelor atëherë është se si ka ardhur ky unitet i përvojës të ndahet në këtë numër studimesh të izoluara shkollë.” Ontario Institute for Studies in Education/University of Toronto. (Qasur nga Instituti më 30.7.2014 dhe pa datë të publikimit). *Curriculum Theory: Give Me a “For Instance” nga Herbert M. Kliebard*. Marrë prej <https://talkcurriculum.files.wordpress.com/2014/09/kliebard-h-1977-curriculum-theory-give-me-a-for-instance.pdf>

Dewey i konsideronte lëndët e përfshira në kurrikulë, thjesht nga nevojat njerëzore, praktikat njerëzore për jetesë. “Një fushë si matematika, argumentoi Dewey, "u përhap lart, jo jashtë tokës, jo jashtë natyrës, por nga jeta njerëzore dhe nevojat njerëzore. ... [Degët e matematikës] ishin mjete të nevojshme për të bërë gjëra që duhej të bëheshin, po aq sa plugu dhe vllaça.... "... Edhe sikur të ishim dakord që një subjekt si matematika tani ka një pavarësi dhe vetë-ekzistencë, është thjesht rezultat i një procesi zhvillimi nga matematika si një mjet bazë.” Ontario Institute for Studies in Education/University of Toronto. (Qasur nga Instituti më 30.7.2014 dhe pa datë të publikimit). *Curriculum Theory: Give Me a “For Instance” nga Herbert M. Kliebard.* Marrë prej <https://talkcurriculum.files.wordpress.com/2014/09/kliebard-h-1977-curriculum-theory-give-me-a-for-instance.pdf>

Ka edhe disa pikëpamje të tjera mbi kurrikulën. Pikëpamja konstruktiviste është mjaft e rëndësishme për ta përmbledhur brenda këtij punimi. “Konceptimi i kurrikulës dhe udhëzimit nga një pikëpamje konstruktiviste, ndërthuren në mënyrë produktive me praktikat e arsimit gjithëpërfshirës. Konstruktivizmi nxit idetë që të gjithë njerëzit janë gjithmonë duke mësuar, procesi është në vazhdim, dhe ndërveprimi mes nxënësve me aftësitë e ndryshme nxisin rritjen konceptuale. Mendimi konstruktivist nënkupton se të mësuarit është idiosinkratik dhe ka nevojë për pak, nëse ka, parakushte për të ndërtuar kuptimin. Mësuesit përpiqen të takojnë nxënësit në shkollën e tyre, me nivelin e tanishëm të të kuptuarit dhe më pas t'i ndihmojnë ata të lidhen dhe zgjerojnë konceptet, pa u fokusuar në rehabilitimin. Inherent në këtë qasje teorike është besimi se të gjithë nxënësit hyjnë në shkollë me njohuri të ndryshme që ndikohen nga sfondi, përvojat, dhe praktika kulturore. Rrjedhimisht, mësuesit duhet të marrin këta faktorë duke i llogaritur dhe të sigurojnë që informacioni i ri është kuptimplotë lidhur me njohuritë ekzistuese të nxënësve.”(Villa & Thousand, 2005, f. 99)

#### **4.4. Funkcionet e kurrikulës në shoqërinë bashkëkohore**

Shoqëria bashkëkohore është e karakterizuar me forca të reja të tregut të punës, me lëvizje të fuqisë punëtore nga një vend në vendin tjetër, me globalizim të punës dhe profesioneve, prandaj kurrikula duhet t'i përshtatet edhe shoqërisë bashkëkohore në dinamikat e saj globale dhe transnacionale. Kurrikula në shoqërinë bashkëkohore duhet t'i përfshijë më vete diversitetin dhe pluralizmin në gjuhë dhe në kulturë. Kurrikulat nuk duhet

të kufizohen vetëm në kërkesa kombëtare, lokale e provinciale, por në shoqërinë bashkëkohore, duhet të zgjerohet, të ndryshohet, të plotësohet dhe mbushet me perspektivat e reja globale, qoftë për vlerat universale dhe etike, qoftë për profesionet e reja, qoftë për dinamikat e reja tekniko-teknologjike, qoftë për globalizimin në të gjitha fushat e jetës. Sot në shoqërinë bashkëkohore, njerëzit duke përdorur teknologjinë, internetin dhe mediet sociale, po kontaktojnë me njëri-tjetrin në distanca të mëdha fizike, duke hequr barrierat e tyre gjeografike. Kjo ka bërë që shoqëria bashkëkohore të dallohet me komunikimet e intensifikuara ndërkulturore, ndëretnike, ndër-racore, ndër-fetare etj. Kërkesat e shekullit të ri për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore botërore, për ruajtjen e ambientit, biodiversitetit, florës dhe faunës etj., janë dhe mbesin prioritete të përfshira edhe në kurrikulën e arsimit parauniversitar. Edukimi global, qytetaria aktive, vlerat universale, të drejtat dhe liritë e njeriut, diversiteti, janë ndër prioritetet e shoqërisë bashkëkohore. Njerëzit nga një kënd i botës në tjetrin, bashkohen, organizohen dhe mobilizohen, për një kauzë të përbashkët, e cila thyen kufijtë lokalë. Prandaj, shoqëria bashkëkohore, kërkon domosdoshmërisht që kurrikula e arsimit parauniversitar, t'i përmbajë brenda vetes, edhe kërkesat e shekullit XXI, mijëvjeçarit të ri, globalizmit dhe edukimit mediatik e teknologjik të brezit të ri. Kurrikula në shoqërinë bashkëkohore ka jo vetëm funksione të tregut të punës, ndonëse kjo e fundit shihet si më e rëndësishmja, por edhe shumë funksione të tjera të natyrës etike, sociale, kulturore dhe humane.

#### **4.4.1 Kurrikula dhe tregu i punës**

Tregu i punës është bërë pjesa më e pandashme, më e rëndësishme dhe më synuese edhe në rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe Qasjes Integruese Evropiane për kurrikulë. “Komisioni i Komunikimit Evropian 2020 për strategjinë evropiane për rritje të mençur, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse parashtron shtatë iniciativa kryesore, dy prej të cilave janë shumë të lidhura ngushtë me modernizimin e kurrikulave: "Bashkimi i inovacionit" dhe "Agjenda për shkathtësi të reja dhe vende pune". Në të parën, Komisioni u bën thirrje Shteteve Anëtare të sigurojnë një furnizim të mjaftueshëm të të diplomuarve të shkencave, matematikës dhe inxhinierisë dhe të përqendrojnë kurrikulat e shkollave mbi kreativitetin, inovacionin dhe sipërmarrjen; në këtë të fundit, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që kompetencat e nevojshme për t'u angazhuar në mësimin e mëtejshëm dhe në tregun e punës të

fitohen dhe të njihen në të gjithë arsimin e përgjithshëm, profesional, të lartë dhe të rritur, përfshirë mësimin joformal dhe informal.” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Tregu i punës si pjesë e synimve dhe objektivave kryesore në kurrikulat arsimore, është pjesë e shumicës së vendeve të sotme evropiane. Le të shërbejemi me rastin e Belgjikës, si shembull: “Në Belgjikë (Flanders), edhe pse qasja e rezultateve të mësimit nuk është e re, zbatimi ka qenë shumë i ndryshueshëm: në disa sektorë, i përditësuar dhe i detajuar. Ekzistojnë profile të kompetencave për çdo grupim profesional, ndërsa në sektorë të tjerë, profilet e kompetencës mungojnë ose janë të vjetëruara. Kjo do të thotë se përparimi i zbatimit praktik ndryshon, sidomos kur shikohet përkthimi i profileve të kompetencës në arsimin në zhvillim të kompetencës (mësimdhënie, metodologjitë dhe praktikat e vlerësimit)...Një qasje e bazuar në kompetenca është e integruar mirë dhe siguron një pikë referimi për kërkesat profesionale në tregun e punës.” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Tregu i punës është ndër përcaktuesit më transformues dhe me ndikimin më të madh në ndryshimet më të shpeshta të kurrikulave të vendeve evropiane. “Shumë vende rregullisht shqyrtojnë dhe përditësojnë kurrikulat nën dritën e ndryshimeve në nevojat e tregut të punës dhe aftësive. Në Spanjë, për shembull, të gjitha standardet e profesioneve rishikohen çdo pesë vjet, dhe ky proces çon në ndryshime në kurrikula.” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Se kush ndikon në hartimin e kurrikulave, cili agjent shoqëror, cila organizatë, cili përfaqësues, cili grup i interesit, edhe këtu ka ndryshime ndërmjet vetë shteteve evropiane. “Në një numër vendesh, p.sh. Lituania, Polonia dhe Sllovakia raportuan se, edhe pse punëdhënësve u është dhënë zyrtarisht mundësi për të kontribuar në hartimin e kurrikulave, mundësitë e tilla rrallëherë merren në praktikë. Në Poloni, për shembull, grupet e punës që përgatisin kurrikulën janë të përfaqësuar kryesisht nga edukatorët; zakonisht marrin pjesë partnerët socialë gjatë fazës së konsultimit.” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)



Diku tjetër, kanë ndikim disa organizata të tjera në hartimin e kurrikulave, si për shembull, në Angli. “Përgjegjësitë që lidhen me hartimin e kurrikulit janë alokuar në institucione të ndryshme në vende të ndryshme. Në Angli, për shembull, atje janë organizata të pavarura për dhënien e përgjegjësive për hartimin dhe administrimin e vlerësimit. Këto organizata kanë një fokus të veçantë duke e mbajtur vlerësimin të besueshëm dhe me kosto efektive, sepse ato konkurrojnë me të tjera organizata pjesëmarrëse për një pjesë të tregut.” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

#### 4.4.2 Kurrikula dhe edukimi qytetar

Edukimi qytetar si një nga orientimet më të rëndësishme në shoqëritë demokratike duhet të jetë pjesë edhe e kurrikulës së arsimit parauniversitar. Edukimi qytetar para së gjithash është edukim për qytetari demokratike. Edukimi për qytetari demokratike bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe shtetit të së drejtës. Ai lidhet, para së gjithash, me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin qytetar, pjesëmarrjen dhe përkatësinë, respektin për diversitetin. Si i tillë ai përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe sektorët e shoqërisë. (Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë - Drejtoria e Zhvillimit të Kurrikulës, 2005)

Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë - Drejtoria e Zhvillimit të Kurrikulës (2005), e cila është e ngjashme me synimet e MASHT-it në Kosovë, qytetaria demokratike bazohet në një metodë shumëpërmasore, që ka në bazë procesin dhe përfshin:

⇐ Përmasën politike, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik;

⇐ Përmasën ligjore, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësive të qytetarëve; ⇐ Përmasën kulturore, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore;

⇐ Përmasën shoqërore dhe ekonomike, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike;

⇐ Përmasa evropiane, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian;

⇐ Përmasën globale, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvarësisë dhe të solidaritetit global. Synime Edukimi për qytetari demokratike synon:

⇐ të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;

⇐ të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;

⇐ të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;”

#### **4.4.3 Kurrikula dhe sistemi politik dhe kulturor**

Sistemi kurrikular nuk shkëputet dot nga sistemi politik dhe kulturor i një vendi. “Është e rëndësishme të theksohet se sistemet e arsimit dhe trajnimit janë dinamike dhe se procesi politik vazhdimisht balancohet dhe riabilizohet me elemente brenda këtyre sistemeve në përgjigje të një game të gjerë presionesh. Edhe pse ardhja e kurrikulës së orientuar drejt rezultateve duket të jetë e rëndësishme, ndryshimi strukturor në arsimin fillestar dhe trajnimin, formën e saktë dhe funksioni i kurrikulës bazuar në rezultatet e të nxënësve në çdo vend është subjekt i rregullimit të vazhdueshëm. Kurrikula në Finlandë, Holandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar, për shembull, janë rishikuar në disa raste për të arritur ekuilibrin e duhur...” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012).

*Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes.* Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Sistemi politik përfshin ideologjinë, rrethanat politike, lëvizjet e ndryshme politike, partitë politike etj. Për të treguar ndikimin e sistemit politik në kurrikulë, do të përkujtojmë pikëpamjen e lidhjes së ideologjisë me kurrikulën. “Një tjetër punë e thyer ishte ideologia dhe kurrikula nga Michael Apple, botuar në vitin 1979. Mes të parëve që krijojnë një lidhje mes kurrikulës dhe ideologjisë së saj të nënkuptuar politike, vuri në dukje Apple është se jo vetëm shkolla si një institucion, por vetë kurrikula shërbeu si një mjet për të riprodhuar shoqërinë, kulturën dhe modelet ekonomike të shoqërisë. Kështu, shkollat u angazhuan në ruajtjen dhe shpërndarjen pronës simbolike e kapitalit kulturor. Ai argumentoi se ne kishim nevojë për një kuptim më të mirë të "pse dhe si aspekte të veçanta të kulturës kolektive paraqiten në shkollë si njohuri objektive, faktike. Si konkretisht, dija zyrtare mund të përfaqësojë ideologjinë e konfigurimit të interesave mbizotëruese në një shoqëri? Si shkollat i legjitimojnë këto standarde të kufizuara dhe të pjesshme të njohjes si të vërteta të padiskutueshme?” (Evans, 2011, f. 70)

Sistemi politik, por edhe ai kulturor, shpesh japin peisazhin e përgjithëshëm të kurrikulës së një vendi. “Një mënyrë alternative për të kuptuar struktura të ndryshme për dizajnimin kurrikula është të argumentohet se variacionet e tilla pasqyrojnë ndryshimet kulturore në lidhje me si kuptohen kompetencat dhe rezultatet e të nxënësve. Për shembull, është argumentuar se gjermanët nuk kanë standarde profesionale në gjuhën angleze... koncepti gjerman i Handlungskompetenz është përcaktuar bazuar në përfshirjen trepalëshe dhe konsensusin e arritur ndërmjet punëdhënësve, tregtisë, sindikatave dhe shtetit. Sistemi gjerman nuk i koncepton standardet profesionale si në pronësi të punëdhënësve dhe formimin e fondacionit mbi të cilat është ndërtuar kurrikula. Në vend të kësaj, detyra e definimit të arsimit vokacional (Berufsausbildung) ndahet midis punëdhënësve, sindikatave, mësuesve dhe shoqatave artizanale...” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes.* Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Pavarësisht se synohen të arrihen disa standarde evropiane në kurrikula, e të cilat vendet e Ballkanit Perëndimor, si Kosova, në rrugëtimin e tyre integruar-evropian, përpiqen t'i inkorporojnë në kurrikulat e tyre kombëtare, sërish ka veçori të mëdha politike, kulturore dhe gjuhësore, në mes të vetë vendeve të Bashkimit Evropian, dhe ka qasje të ndryshme mbi

zhvillimin kurrikular. “Nëse shikojmë praktikën e hartimit të kurrikulave të orientuara drejt rezultateve në vende të ndryshme evropiane, ne mund të dallojmë një numër të dallimeve në qasje:

(i) numri i etapave ndryshon midis vendeve. Disa vende kanë procese thelbësisht të diferencuara, të ndara në shumë faza të dallueshme të karakterizuara nga nënproceset e ndryshme, ndërsa të tjerët kanë pak faza të dallueshme;

(ii) funksioni i secilit standard varion midis vendeve. Kjo është pjesërisht sepse ka numra të ndryshëm të fazave; mund të ndodhë edhe sepse gjatësia e fazave varion midis vendeve;

(iii) terminologjia ndryshon pasi gjuhët ndryshojnë në Evropë dhe pasqyrojnë kontekste kombëtare. Për shembull, disa vende si Gjermania, Franca, Hungaria dhe Luksemburgu nuk e përdorin termin e të mësuarit në kurrikulat...” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Se çfarë ndikimi ka sistemi kulturor në kurrikulat shkollore, mjafton të kthehemi edhe te një pjesë e fjalimit të Margaret Thetçer.

“Shkrimi i krishterimit në këtë diskurs, duke artikuluar nocionet e kombësisë, historisë dhe identitetit me fenë, është shprehur në mënyrë eksplicite në ekstraktin e mëposhtëm nga një fjalim i dorëzuar nga Margaret Thetçer në vitin 1988: Në të vërtetë, ka pasur debate të mëdha rreth edukimit fetar. Unë besoj fuqishëm që politikanët duhet të shohin se edukimi fetar ka një vend të duhur në kurrikulën e shkollës. . . Feja e krishtere. . . Është një pjesë themelore e trashëgimisë sonë kombëtare. . . Për shekuj ka qenë shumë gjaku i jetës sonë. Dhe me të vërtetë ne jemi një komb, idealet e të cilit janë të bazuara te Bibla . . . dhe kjo është rasti i fortë praktik për të siguruar që fëmijëve në shkollë u janë dhënë udhëzime adekuate në pjesën që tradita e krishterë-judenje ka luajtur në formimin e ligjeve, sjelljeve dhe institucioneve tona...” (Thobani, 2010, f. 119)

Synimet e kurrikulave kombëtare dhe evropiane, po ashtu janë integrimi i vlerave të diversitetit kulturor dhe ndëretnik, të cilat shndërrohen në vlera universale të edukimit. “Sistemet e vlerës janë një pjesë integrale e çdo konteksti kulturor dhe ku takohen disa kontekste kulturore, siç bëjnë ata në shoqëritë pluraliste dhe multietnike, pyetjet lindin në mënyrë të pashmangshme në lidhje me ekzistencën e vlerave universale dhe vlerave kulturore

(relativiste), dhe si një ekuilibër mund të arrihet mes të dyjave kur bëhet fjalë për zhvillimin e kurrikulës së vlerave që duhet të ketë një apel të përbashkët.”(Gardner, Cairns, & Lawton, 2000, f. 261)

## **5. Kurrikula kosovare dhe legjislacioni**

### **5.1. Legjislacioni dhe dokumentet mbi kurrikulën**

Kosova ka hartuar disa ligje dhe dokumente mbi kurrikulën e sistemit parauniversitar, me të cilat do të merremi shkurtimisht me secilën prej tyre. Kurrikula në Kosovë ndryshoi rrënjësisht sidomos pas vitit 1999 dhe rritjes së pranisë së personelit të huaj ndërkombëtar gjatë administrimit. “Në Kosovë, që nga viti 2003, është bërë një punë intensive në fushën e arsimit dhe veçanërisht në drejt të ndryshimeve kurrikulare. Korniza e Kurrikulës përbëhet nga një tërësi e dokumenteve dhe masave të përcaktuara për zbatimin e saj.”(Neziri, 2018, f. 19)

Kjo bëri që edhe nocionet nga gjuhët e huaja, të gjejnë përdorim më të gjerë, qofshin edhe këto nocione të vjetra latine apo greke, por që nuk përdorshin aq në vendin tonë. “Zhvillimi i kurrikulave, si në çdo vend tjetër, edhe në Kosovë është çështje me rëndësi të veçantë si për politikbërësit ashtu edhe për zbatuesit e saj. Në terminologjinë pedagogjike,

përkatësisht në fushën e edukimit, pas vitit 2000 ka një prirje për të përdorur terminologji të huaja në konceptet e reja ndër të cilat edhe termi kurrikul.”(Neziri, 2018, f. 20)

Kurrikulat sikur e përshkruajnë dhe e shpjegojnë teorinë mbi to, janë të ndikuara shumë nga ndryshimet e mëdha sociale, ekonomike, teknologjike etj. “Ndryshimet e mëdha sociale, ekonomike, teknologjike etj., ndikuan edhe në plotësimin dhe ndryshimin e planeve dhe programeve (kurrikulave) mësimore, duke pasur parasysh përshtatshmërinë me moshën dhe aftësitë kuptimore të nxënësve dhe interesat e tregut. Bartës i këtyre ndryshimeve kurrikulare është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë.”(Neziri, 2018, f. 21)

Zhvillimi i kurrikulës dhe reformat e ndryshme arsimore erdhën duke ndryshuar vazhdimisht. “Nga këndvështrimi historik, dokumentet kurrikulare, si Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë pas kompletimit të punimeve dhe studimeve janë miratuar më 29 gusht 2011 (siç e përmend Korniza e Kurrikulës, 2011), e cila synon ndryshimin e vazhdueshëm dhe progresiv të sistemit arsimor parauniversitar në Kosovë. Gjithashtu rrit cilësinë e shërbimeve arsimore për të gjithë nxënësit dhe njëherësh ndërlihd sistemin e arsimit të Kosovës me reformat aktuale arsimore ndërmjet sistemeve më të zhvilluara.” (Neziri, 2018, f. 21)

Në vitet e fundit, Korniza e Kurrikulës në formë dhe përmbajtje është ndikuar tejmas nga të huajt. “Sipas Kornizës së Kurrikulës (KK) për secilin nivel të sistemit të arsimit parauniversitar u miratuan dokumente shtesë si Kurrikula Bërthamë, të cilat u zyrtarizuan më 22 tetor 2012 (siç e përmend MASHT, 2012). Sipas Kurrikulës Bërthamë për nivelin I-V ky dokument do të shërbej si bazë për hartimin dhe zbatimin e disa dokumenteve të tjera, planeve dhe programeve mësimore, teksteve shkollore dhe udhëzuesve tjerë pedagogjik për zhvillimin e arsimit në ciklin fillor. Për të gjitha këto dokumente kurrikulare kontribut të veçantë kanë dhënë të gjithë donatorët ndërkombëtarë në Kosovë.” (Neziri, 2018, f. 21)

Në Kosovë u përpiluan disa ligje që rregullojnë veprimtarinë arsimore në nivelin parauniversitar dhe universitar, në nivel komunal, si për kurrikulat, si për organizimin e brendshëm dhe të jashtëm, si për nivelet e sistemit arsimor, si për zbatimin e kurrikulave etj.

Në vijim do të bëjmë fjalë për të gjitha ligjet dhe dokumentet më relevante të kurrikulave në Kosovë:

- Ligji për Arsimin Parauniversitar të Kosovës (2011), Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës (2008);

- Ligji për për Botimin e Teksteve Shkollore, Mjeteve mësimore, Lektyrës Shkollore dhe të Dokumentacionit Pedagogjik (2006);
- Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë (2016);
- Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës (2016),
- Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës (2016);
- Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës (2017);
- Udhërrëfyese për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021 etj.

## **5.2 Ligji për Arsimin Parauniversitar të Kosovës (2011)**

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Kosovës (2011), Neni 1, përcaktohet qartë qëllimi. “1. Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele. 2. Qëllimet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar janë: 2.1. zhvillimi i personalitetit, talentit dhe aftësisë mendore e fizike të nxënësit deri në potencialin e tij të plotë; 2.2. avancimi i krijimit të njohurive themelore shkencore, shkathësive të komunikimit, vrojtimin dhe shkathësive analitike, kreativitetit, mëvetësisë dhe aftësive të ndërlidhura të mësimnxënies; 2.3. zhvillimi i respektit të nxënësi për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe për parimet e përcaktuara me Kartën e Kombeve të Bashkuara, me konventat përkatëse dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës; 2.4. zhvillimi i respektit të nxënësit për prindërit dhe mësimdhënësit, për identitetin kulturor, gjuhën dhe vlerat e komunitetit të tij, për vlerat e Republikës së Kosovës, për shtetin nga i cili mund të ketë prejardhjen dhe për respektimin e diversitetit; 2.5. përgatitja e nxënësit për jetesë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore

dhe në miqësi me pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, e më gjerë; 2.6. të zhvillojë te nxënësi respektin për mjedisin.” (f. 1-2)

Ligji për Arsimin Parauniversitar të Kosovës (2011), duke specifikuar nivelet e organizimit, decentralizon kompetencat edhe për shkollat dhe për programet jashtëkurrikulare. Këshilli drejtues i shkollës në nivelet 1,2 dhe 3 të ISCED-së, ka detyrat dhe kompetencat si vijon dhe ndër të tjerash, është edhe paragrafi 11.5: “të miratojë aktivitetet jashtë kurrikulare të shkollës, sipas propozimit të drejtorit të shkollës...”

Po ashtu, sipas këtij ligji (2011), “Drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë: detyrat lidhur me kurrikulumin...”

Me këtë ligj, i sigurohen përgjegjësi të mëdha rreth kurrikulimit, edhe Agjencisë së Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim. “1. Agjencia e Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim (AKKSV) themelohet si agjenci për të udhëhequr çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e kurrikulimit, standardeve dhe vlerësimit. 2. AKKSV është agjenci ekzekutive që vepron nën Ministrinë. 3. Statusi dhe puna e AKKSV-së rregullohet me akt nënligjor. 4. AKKSV zhvillon Kornizën e Kurrikulimit të Kosovës dhe kurrikulumin e lëndëve përmes një procesi të rregullt të diskutimit me përfaqësuesit e mësimdhënësve dhe komunave, me organizatat përfaqësuese të komunitetit, si dhe me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe rekomandimet për: 4.1. përmbajtjen e kurrikulimit bërthamë, përfshirë metodologjinë qendrore dhe programet mësimore të lëndëve; objektivat, rezultatet e të mësuarit për secilën lëndë që lidhet me fazat kryesore të kurrikulimit dhe kompetencat kryesore që duhet të arrihen në fund të nivelit 3 të ISCED-së; 4.2. matjen dhe vlerësimin e standardizuar të suksesit të nxënësve në intervale të përcaktuara dhe kriteret për përparimin e nxënësve që janë në përputhje me kushtet e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve për vlerësim që çojnë në dhënien e kualifikimeve; 4.3. listën e teksteve të rekomanduara si dhe burime të tjera mësimore, përfshirë këtu materiale të përshtatshme për përdorim nga nxënësit që kanë vështirësi në mësim apo ata me aftësi të kufizuara.” (Ligji për Arsimin Parauniversitar të Kosovës, 2011, f. 25)

Po aq me rëndësi, është edhe Neni 24, Korniza e Kurrikulimit e Kosovës. Sipas këtij neni, parashihet: “1. Ministria përmes Agjencisë së Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim (AKKSV), harton Kornizën e Kurrikulimit të Kosovës (KKK). 2. Përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve duhet të përfshihen në zhvillimin apo rishikimin e KKK-së. 3. KKK përbëhet nga kurrikulumi bërthamë dhe kurrikulumi me bazë shkolle për secilin nivel të



arsimit parauniversitar dhe përcakton fushat mësimore. 4. KKK shërben si bazë për hartimin e kurrikulumeve lëndore...”(Ligji për Arsimin Parauniversitar, f. 23)

### **5.3 Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës (2008)**

Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës (2008) ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë arsimore në nivel lokal. “1.1 Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e arsimit publik në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë në komunitet e Republikës së Kosovës.”(f. 1)

Me këtë ligj përcaktohen kompetencat e komuniteteve në zhvillimin e arsimit parauniversitar, ndërtimin e objekteve shkollore, regjistrimin dhe pranimin e nxënësve, punësimin e mësimitdhënësve etj. Në Kreun IV të këtij ligji, Neni 10, Licencimi, Regjistrimi dhe Punësimi i Mësimitdhënësve, përcaktohen edhe procedurat dhe kriteret e licencimit të mësimitdhënësve. “10.1 Mësimitdhënësit mund të regjistrohen dhe punësohen vetëm nëse ata plotësojnë kriteret dhe standardet arsimore të caktuara me ligj. 10.2 MASHT-i organizon proces të para regjistrimit në shkallë vendi, duke u bazuar në kritere të drejta dhe transparente për të krijuar listën e mësimitdhënësve të licencuar të mësimitdhënësve të ardhshëm, kjo listë azhurnohet për çdo vit. 10.3 Të gjithë mësimitdhënësit e ardhshëm të cilët janë të para regjistruar licencohen nga MASHT-i. 10.4 Pas krijimit të procesit të para regjistrimit dhe licencimit në shkallë vendi, dhe pas publikimit të listë së pare të hapur, komunitet mund të regjistrojnë dhe punësojnë vetëm kandidatët, të cilët janë të përfshirë në listën e caktuar në paragrafin 2 të këtij neni. 10.5 Procesi i licencimit i përcaktuar në këtë nen, i kushton vëmendje të veçantë nevojave të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në Kosovë, përfshirë edhe mundësinë efektive për dërgimin e mësimitdhënësve nga shtetet e huaja.” (Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, 2008, f. 6)

Më sipër, e lexojmë në ligj për standardet arsimore dhe kjo po ashtu përfshin zbatimin e kurrikulave të miratuara nga MASHT. Po ashtu, MASHT dhe shumica e shkollave sa herë kanë ndryshime të kurrikulave, mbajnë dhe organizojnë trajnime për kurrikulat për të gjithë mësimitdhënësit, për të plotësuar standardet arsimore, të parapara edhe me këtë ligj, por edhe me ligjet e tjera të arsimit në Kosovë.

#### **5.4 Ligji për Botimin e Teksteve Shkollore, Mjeteve mësimore, Lektyrës Shkollore dhe të Dokumentacionit Pedagogjik (2006)**

Ligji me rëndësi për Tekstet Shkollore, Mjetet mësimore, Lektyrën Shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, është mjaft i rëndësishëm, pasi është përpiluar “me qëllim të krijimit të infrastrukturës ligjore për zhvillimin e veprimtarisë së botimit të teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik.”(Ligji për Botimin e Teksteve Shkollore, Mjeteve mësimore, Lektyrës Shkollore dhe të Dokumentacionit Pedagogjik, 2006, f. 1)

Sipas këtij ligji (Kuvendi i Kosovës, 2006), Neni 3, përcakton: “Kërkesat që duhet t’i përmbushin tekstet shkollore, mjetet mësimore, lektyra shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik 3.1. Tekstet shkollore, mjetet mësimore, lektyra shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik i përmbushin kërkesat edukative, shkencore, pedagogjike, psikologjike, didaktiko-metodike, etike, gjuhësore, artistike dhe teknike në pajtim me standardet dhe me objektivat e planeve dhe të programeve mësimore. 3.2. Nuk lejohen tekstet shkollore, mjetet mësimore, lektyrat shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik që bëjnë propagandë kundër Kosovës, që cenojnë të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore dhe që nxisin urrejtje politike, nacionale dhe fetare. 3.3. Në mësimin parashkollor, në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta përdoren tekstet shkollore, mjetet mësimore, lektyra shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik i lejuar nga MASHT-i. 3.4. Lektyra shkollore zgjidhet në përputhje me planin dhe me programin mësimor.”

Kurrikula e re në Kosovë, ndër sfidat që ka për t’u zbatuar, është edhe mospërputhja e teksteve mësimore me kurrikulën. Sipas Ligjit të mësipërm (2006), është ky definicion për tekstin shkollor: “Teksti shkollor” për shkolla fillore, shkolla të mesme të ulëta dhe për shkolla të mesme të larta është libër themelor dhe i obligueshëm që shërben si mjet themelor dhe burim i dijes për fushën e caktuar dhe me përdorimin e të cilit arrihen objektivat edukativoarsimorë të përfshira në plan dhe program mësimor. Teksti shkollor është i hartuar në bazë të planit dhe të programit mësimor dhe i formësuar në pikëpamje didaktike, duke marrë parasysh aftësitë psikofizike të nxënësve dhe veçoritë e lëndës mësimore.”

## 5.5 Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë (2016)

Me Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të miratuar në vitin 2011, kishte disa ngjashmëri edhe Korniza e Rishikuar e Arsimit Parauniversitar e miratuar në vitin 2016. Edhe me Kornizën e parë, edhe me të dytën, ndër qëllimet e arsimit parauniversitar, janë arritjet e disa kompetencave kryesore. “Në përputhje me qëllimet e arsimit kosovar, kompetencat kryesore të parapara për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
- Kompetenca e të menduarit;
- Kompetenca e të mësuarit;
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis;
- Kompetenca personale;
- Kompetenca qytetare.”(Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2011)

Por Korniza e fundit parauniversitare, e miratuar në vitin 2016, para dy vjetësh, ndryshoi vetëm në disa aspekte të fushave kurrikulare dhe rezultateve të të nxënit, pa ndonjë ndryshim të madh. “Në këtë kontekst, qëllimet e arsimit janë:

- kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore
- promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare
- zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit
- aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore
- zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm
- aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.” (Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2016)

Edhe në faqen 16 të kësaj kurrikule të rishikuar, përcaktohen kompetencat kryesore, të cilat parashihen edhe me kornizën e mëhershme. Përveç kompetencave, janë me rëndësi, edhe fushat e kurrikulës. “Për zhvillimin e gjithanshëm të kompetencave duhet të ketë një ndërlidhje ndërmjet fushave, lëndëve dhe moduleve të Kurrikulës. Fushat e Kurrikulës janë:

- Gjuhët dhe komunikimi
- Artet
- Matematika
- Shkencat natyrore
- Shoqëria dhe mjedisi
- Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
- Jeta dhe puna

Fushat e kurrikulës përfshijnë një ose disa lëndë apo module mësimore. Lëndët dhe modulet duhet të ndjekin/realizojnë qëllimin dhe rezultatet e të nxënës të përcaktuara për fushën përkatëse të kurrikulës. Disa lëndë të një fushe të kurrikulës mund të mësohen si të integruara në shkallë të ndryshme të kurrikulës. Për secilën fushë kurrikulare në dokumentet tjera kurrikulare përcaktohen rezultatet e të nxënës, të cilat do të mundësojnë arritjen e kompetencave.”(Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2016)

Përveç kompetencave, fushave kurrikulare, janë me rëndësi, edhe shkallët e kurrikulës. “Korniza kurrikulare është e strukturuar në gjashtë shkallë kryesore, të cilat paraqesin periudhat me karakteristika të përbashkëta për sa i përket zhvillimit të fëmijëve dhe kërkesave të kurrikulës. Ato përbëhen prej një, dy ose tre viteve/klasëve. Për secilën shkallë përcaktohen kërkesat standarde të progresit të të nxënës, organizimi i përvojave mësimore, qasja dhe kriteret e vlerësimit për kompetencat e caktuara në këtë dokument.”(Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2016)

Për shkallën 1, parashihet përvetësimi themelor; për shkallën 2, përforsim dhe zhvillim; për shkallën 3, zhvillim i mëtejshëm dhe orientim; për shkallën 4, përforsim dhe orientim; për shkallën 5, arsim i përgjithshëm dhe profesional; dhe për shkallën 6, konsolidim dhe specializim. Korniza parasheh edhe ndryshimet në mënyrën e vlerësimit.

“Korniza Kurrikulare përcakton dy lloje të vlerësimit:

Vlerësimi i brendshëm;

Vlerësimi i jashtëm.

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel shkolle/klase nga mësimdhënësit e shkollës dhe sipas përshkrimit të procedurave e kriterëve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluara me akte nënligjore. Vlerësimi i brendshëm bëhet për disa qëllime, si për

përparimin dhe arritjen në të nxënë, për planifikim të punës me nxënës, për identifikimin e prirjeve dhe talenteve të nxënësve, etj. Vlerësimi i brendshëm duhet t'u mundësojë të gjithë nxënësve të shprehin njohuritë e reja dhe të tregojnë nivelin e zotërimit të kompetencave duke përfshirë: o Gjerësinë dhe thellësinë e tyre; o Gatishmërinë për t'iu përgjigjur sfidave të nivelit të përcaktuar me rezultatet e të nxënit; o Aftësinë për t'i zbatuar ato në situata dhe rrethana të reja. Fokusi kryesor i vlerësimit të brendshëm duhet të jetë mbështetja e të nxënit të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave dhe kjo arrihet më së miri nga kombinimi i vlerësimit formativ (për nxënie) dhe vlerësimit përmbledhës (i të nxënit).”(Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2016)

Pastaj bëhet edhe ndarja e vlerësimit të brendshëm në tri lloje. “Korniza Kurrikulare përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm:

- Vlerësimi i vazhdueshëm
- Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësimi për shkallë

Korniza përcakton periudhën e realizimit të secilit lloj të vlerësimit, bartësit/përgjegjësit e vlerësimit, qëllimet kryesore dhe mënyrat e dokumentimit/evidentimit të arritjeve të nxënësve.”(Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2016)

Korniza e Kurrikulës (KK) nuk është e plotësuar me detaje të tjera, prandaj shoqërohet më vonë edhe me të gjitha dokumentet e tjera, për çdo nivel dhe shkallë kurrikulare. “Përveç KK-së, për ta zbërthyer më tutje kurrikulën hartohen edhe dokumente të tjera kurrikulare, si në vijim: Kurrikula Bërthamë për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (lindje–5 vjeç, për grupmoshat 0–3 dhe 3–5), Kurrikula Bërthamë për Arsimin Fillor, Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët, Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë – gjimnaze, Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë - shkolla profesionale. Planet dhe programet lëndore nga klasa përgatitore deri në kl. XII, duke mbuluar të gjitha fushat /lëndët mësimore për secilën klasë.” (Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2016)

## **5.6 Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës (2016)**

Kurrikula Bërthamë merr shumë pjesë nga Korniza e Kurrikulës, por vetëm se ka fokusin në Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor. Kompetencat, fushat kurrikulare, rezultatet e të nxëniet për çdo lëndë, janë të përbashkëta, por vetëm jepen këto për nivelin prej Klasës Përgatitore e deri në Arsimin Fillor. “Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor, krahas dokumenteve tjera kurrikulare, e bën të zbatueshme Kornizën e Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar, të miratuar nga MASHT-i, në gusht 2016. Me këtë dokument përcaktohen rezultatet për kompetenca dhe rezultatet për fusha të kurrikulës, të shprehura në njohuri shkathtësi, qëndrime dhe vlera që duhet të zhvillohen dhe arrihen nga nxënësit deri në fund të periudhave të caktuara kohore si dhe qasjen metodologjike të zbatueshmërisë, përfshirë mësimdhënien, mësimnxënien dhe vlerësimin. Gjithashtu, ky dokument përcakton shpërndarjen e kohës mësimore (orëve mësimore) për fusha të kurrikulës dhe ndërlidhjen e tyre të cilat mundësojnë progres në zhvillimin e kompetencave të nxënësit.” (Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës, 2016)

Këto janë nivelet e arsimit parauniversitar, të cilat janë të inkorporuara në këtë kurrikulë:

- Kurrikula Bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme (lindje -5 vjeç);
- Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor; o Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët;
- Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë-gjimnaze, dhe
- Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë-shkolla profesionale.” (Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës, 2016)

## **5.7 Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës (2017)**

Struktura e Kurrikulës Bërthamë të Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës ka po ashtu të përbashkëtat me ato të Klasës Përgatitore dhe Arsimit Fillor, por veçohet me disa synime të tjera, në përputhje me zhvillimin dhe moshën përkatëse të fëmijëve më të rritur. “Kurrikula Bërthamë e arsimit të mesëm të ulët (AMU) përfshin klasat VI-IX, të cilat shtrihen në

shkallët kurrikulare 3 dhe 4. KB është dokument i detyrueshëm, i hartuar në bazë të Kornizës së Kurrikulës, në të cilin bazohen lëndët mësimore, përmbajtja sipas fushave kurrikulare, rezultatet e të nxënësve, mësimi me zgjedhje, ecuria e mësimdhënies, nxënies, metodologjisë dhe vlerësimit.”(Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës, 2017)

Kjo kurrikulë e Arsimit të Mesëm të Ulët, i takon shkallës 3 dhe 4, prandaj disa nga synimet, objektivat dhe orientimet e saj mund të jenë më të dallueshme prej atyre në shkallën 1 dhe 2. “Në arsimimin e mesëm të ulët nxënësve u ofrohet mundësi gjithëpërfshirëse për zhvillimin e aspektit njohës, fizik, personal, social dhe moral. Kërshëria e tyre nxitet e natyrshëm për t’u siguruar që njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e zotëruara janë bazë e qëndrueshme për zhvillim në shkallët e tjera të arsimit. Qëllimi kryesor i shkallës 3-4 është përgatitja e nxënësit për shkollim të mëtejshëm dhe orientim për karrierë, duke u përkrahur me mentorë/këshilltarë profesionalë. Ky nivel, po ashtu, nxënësit i ndihmon që t’i zhvillojnë interesat personale dhe i definojnë pritjet e tyre për të ardhmen në mënyrë sa më të përshtatshme. Realizimi i procesit mësimor zhvillohet në mënyrë të integruar bazuar në fusha kurrikulare, duke i ndërlidhur me punën dhe jetën e përditshme të fëmijëve, për t’iu mundësuar që ta kuptojnë drejt marrëdhënien e tyre me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu.” (Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës, 2017)

Në shkallën 3 kurrikulare, nxënësit aftësohen për mendime, zhvillime dhe shkathtësi më specifike. “Nxënësi përgjatë kësaj shkalle aftësohet për:

- të menduarit abstrakt dhe kompleks (p.sh., shkathtësi të larta intelektuale), që është i nevojshëm për ta njohur botën dhe veten si dhe për zgjidhje të problemeve;
- kultivimin e interesimit për njohje më të thellë të vetes, të tjerëve dhe të mjedisit natyror e shoqëror;
- zhvillimin e shkathtësive për vlerësim dhe vetëvlerësim;
- zhvillimin e shkathtësive për komunikim efektiv, përfshirë edhe kodet matematike dhe shkencore;
- zgjerimin e shkathtësisë për komunikim verbal dhe në të shkruar në gjuhën amtare, në gjuhën angleze dhe në gjuhë tjetër të huaj/njëren nga gjuhët zyrtare;
- zhvillimin e përgjegjshmërisë për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe për mbrojtje aktive të mjedisit.

Por në shkallën 4, ndonëse kanë diçka të përbashkët me shkallën 3, ato janë akoma e më specifike. “Në shkallën 4 nxënësit orientohen për mundësitë e ndryshme të karrierës. Në këtë shkallë ata përgatitën për:

- shfrytëzimin e burimeve të informacionit dhe për qasje kritike ndaj të dhënave të ndryshme;
- zhvillimin e interesimit për jetën publike nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në aktivitete jashtëshkollore/shoqërore;
- përballje me zgjidhjen e çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me tema nga jeta reale përmes projekteve që do t’u mundësojnë konsolidimin e dijeve të tyre dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathtësive dhe të qëndrimeve;
- familjarizimin me mundësi të ndryshme të studimit dhe orientimit në karrierë;
- përgatitjen praktike dhe aktivitetet orientuese që u mundësojnë nxënësve të qartësojnë aspiratat e tyre;
- përforsimin e shkathtësisë për vetëvlerësim dhe vlerësim;
- përforsimin e kompetencave për punë të pavarur dhe ekipore;
- për identifikimin e qartë të aftësive dhe talenteve të veçanta të nxënësit.”(Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës, 2017)

### **5.8 Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës (2016)**

Arsimi i mesëm i lartë përfshin nxënësit më të rritur dhe më të pjekur, ngase mosha e tyre kalendarike është në një fazë tjetër të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe motivues. Në këtë fazë, nxënësit janë më afër orientimit, këshillimit dhe informimit të tyre profesional, duke menduar më shumë për të ardhmen e tyre profesionale dhe jetësore. “Arsimi i mesëm i lartë në Kosovë përfshin nivelin e tretë dhe të katërt të arsimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, përkatësisht gjimnazet dhe arsimin e aftësimin profesional / shkollat profesionale/. Ky nivel i arsimit përbëhet prej dy shkallëve kryesore kurrikulare, shkallës së pestë (klasa X dhe XI) dhe shkallës së gjashtë (klasa XII). Bazuar në këtë strukturë janë përgatitur Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë – gjimnaze dhe Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë - arsimin e aftësimin profesional /shkollat



profesionale/. Ky dokument i referohet arsimit të mesëm të lartë - gjimnazeve.” (Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës, 2016)

Kjo kurrikulë bërthamë merr parasysh orientimin dhe kualifikimin profesional të nxënësve, sfidat e orientimit në karrierë dhe botën e tyre profesionale, si dhe për të krijuar shprehje dhe shkathhtësi të të mësuarit gjatë gjithë jetës. “Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (gjimnazet), është dokument bazë, i cili rregullon organizimin e arsimit në këtë nivel, ecurinë e mësimdhënies, të mësimnxënies, të metodologjisë, të vlerësimit etj. Ky dokument, dispozitat e të cilës vendosen nga MASHT-i, është obligues për të gjitha institucionet edukative arsimore në Republikën e Kosovës dhe u shërben mësimdhënësve, nxënësve, prindërve, drejtorëve të shkollave dhe komunitetit në përgjithësi. Arsimi i mesëm i lartë bazohet në një proces më të gjerë, më të thellë dhe më të specializuar të të nxënësve. Në këtë nivel duhet pasur parasysh: a) zhvillimin e përgjithshëm dhe profesional të nxënësve b) orientimin e nxënësve për studime akademike, kualifikimeve profesionale dhe/apo inkuadrimit në tregun e punës, si dhe c) nevojën për t’i përgatitur ata për të nxënë gjatë gjithë jetës. Në këtë nivel, si në shkollat e përgjithshme (gjimnazet), ashtu edhe në shkolla profesionale, procesi i përvetësimit të dijeve dhe zhvillimit të shkathhtësive, vlerave dhe qëndrimeve bazohet në nevojën e të rinjve për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre, për të marrë pjesë si qytetarë aktivë dhe kompetentë në zhvillimet shoqërore dhe për t’u inkuadruar me sukses në tregun e punës. Prandaj, nxënësit i nënshtrohen një procesi më sfidues të përvetësimit të dijeve, zhvillimit të potencialit të tyre intelektual, shoqëror, socio - emocional dhe fizik.” (Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës, 2016)

Arsimi i mesëm i lartë ka disa lloje gjimnazesh dhe shkollash profesionale. “Në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, është përcaktuar që arsimi i mesëm i lartë të ndahet në gjimnaze dhe shkolla profesionale. Në kuadër të gjimnazeve janë përcaktuar tri lloje: 1. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore 2. Gjimnazi i shkencave natyrore, dhe 3. Gjimnazi i specializuar. Gjimnazet e specializuara themelohen në bazë të nevojave dhe prioriteteve shoqërore dhe shtetërore. Mënyra e themelimit dhe kurrikula e tyre përcaktohet me legjislacion /vendim të veçantë.” (Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës, 2016)

Në këtë kurrikulë, përcaktohen edhe lëndët e përgjithshme dhe të veçanta, si dhe lëndët në gjuhë amëtare dhe të huaj. Në këtë kurrikulë bërthamë dhe Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar, një dallim tjetër nga kornizat e para disa vjetëve në Kosovë, është

edhe orientimi që si gjuhë e parë e huaj të jetë gjuha angleze, ndërsa si gjuhë e dytë e huaj, të jetë gjuha gjermane. Dikur gjuha frënge, gjuha latine etj., kishin zënë vend të veçantë në kurrikulat e arsimit të mesëm të lartë, ndërsa pas vitit 1999, me rritjen e pranisë së faktorit ndërkombëtar, përvetësimit masiv të gjuhës angleze nga të rinjtë, globalizimit të gjuhës angleze, përhapjes së teknologjisë dhe ndërlidhjes me gjuhën angleze etj., gjuha angleze është bërë pjesë kryesore e kësaj kurrikule. Po ashtu, për shkak të tregut të punës, interesimit për të punuar në Gjermani, si dhe për shkak të lidhjes më të fuqishme të kosovarëve me Gjermaninë si shteti më me ndikim ekonomik në Evropë, gjuha gjermane ka marrë mbështetje të madhe, për t'u bërë pjesë e kësaj kurrikule. “Fusha - Gjuhët dhe komunikimi në nivelin e tretë (klasa 10-12), bazuar në Kornizën Kurrikulare, përmban këto lëndë: gjuhë amtare, gjuhë e parë e huaj (gjuhë angleze), gjuhë e dytë e huaj (gjuhë gjermane/frënge) si dhe gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare. Kjo fushë nxënësit i përgatit për komunikim efektiv, të qartë dhe përmbajtësor. Nëpërmjet lëndëve të kësaj fushe nxënësve u mundësohet t'i zhvillojnë dhe avancojnë shkathësitë kryesore të gjuhës: të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit, me qëllim të arritjes së kompetencave të cilat i përdor në jetën e përditshme.” (Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës, 2016)

## **5.9 Udhërrëfyeni për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka përpiluar edhe udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021. Një ndihmë në një udhërrëfyes të tillë për zbatim, e ka publikuar edhe Instituti Pedagogjik i Kosovës. Arsyeja kryesore e këtij udhëzuesi është zbatimi më efikas i Kornizës së Kurrikulës. “Udhëzuesi mbështet zbatimin e KK-së, respektivisht KB-ve dhe programeve lëndore, për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në shkollë. Shembujt e modeleve praktike të planifikimeve mësimore, të metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit, ndihmojnë ndërlidhjen e kurrikulës me proceset e mësimin në shkollë.” (Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016) Udhëzuesi si i tillë, u jep më shumë mundësi profesionale dhe praktike, të gjithë mësimdhënësve, për ta zbatuar kurrikulën e re. “Udhëzuesi në fillim përdoret si material trajnues i mësimdhënësve për të zhvilluar më tej aftësitë profesionale të mësimdhënësve për zbatim të KK-së, respektivisht të KB dhe programeve lëndore për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Në të ardhmen llogaritet që

ky udhëzues, krahas me udhëzuesit për përmirësimin e praktikave në klasë (MASHT & SËAP, 2012) dhe udhëzues të tjerë, t'ju shërbejnë mësimdhënësve gjatë punës së pavarur në realizimin e kurrikulës së re.” (Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016)

“Duke pasur parasysh çështjet që trajtohen në udhëzues dhe strategjitë që praktikohen gjatë trajnimit, pritet që mësimdhënësi të arrijë këto rezultate:

- Identifikon qasjet e arritjes së qëllimeve të arsimit të përcaktuara me KK;
- Identifikon qasjet e respektimit të parimeve në procesin arsimor, duke përfshirë planifikimet, metodologjitë dhe vlerësimin;
- Identifikon elementet e domosdoshme të përmbajtjes së planifikimeve mësimore për zbatimin e KB – programeve mësimore;
- Prezanton modelet e planifikimeve mësimore në të cilat përfshihen elementet e domosdoshme të KB-së – programeve mësimore;
- Prezanton modelet e strategjive të mësimdhënies dhe të nxënit, duke respektuar parimet e KK-së, KB-së dhe programeve mësimore;
- Prezanton modelet e përgatitjes dhe shfrytëzimit të materialeve mësimore;.
- Zbaton strategjitë, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit konform parimeve të Kurrikulës dhe specifikave të programeve mësimore;
- Zbaton strategjitë e bashkëpunimit kolegjal brenda dhe jashtë shkollës, si kurorëzim i suksesit të shkollës.” (Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016)

### **5.10 Kurrikula evropiane parauniversitare**

Pavarësisht se shtetet e BE-së i nënshtrohen interpretimit dhe mirëkuptimit kombëtar, ato po japin një platformë të përbashkët për të komunikuar ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Kurrikula evropiane parauniversitare mbështetet kryesisht në nevojat e ekonomisë, tregut të punës, por edhe dinamikave të përgjithshme të shkencës e mjekësisë. Baroncelli, Farneti, Horga, dhe Sophie Vanhoonacker (2014) mbështetur në një citim të autores Christine McGuire, thonë se, ajo “vuri në dukje se trupi i njohurive në mjekësi gati dyfishohet çdo 8

vjet. Si pasojë, do të ishte e pamundur që shkollat mjekësore të mbulonin të gjitha njohuritë e nevojshme në kurrikula.”(siç e përmend Christine McGuire, 1996) Objektivat ekonomike dhe konkurrenca në zhvillimin e aftësive, po ashtu janë fundamentale për kurrikulën evropiane parauniversitare. “Objektivat ekonomike lidhen me politikën e kërkimit për të përmirësuar konkurrencën kombëtare përmes zhvillimit të aftësive. Kjo përkthehet në përmirësimin e lidhjeve në mes sistemeve të arsimit dhe trajnimit dhe industrisë. Ky objektivi është nxitja e reformës së përgjithshme të kurrikulës në formë apo në një tjetër në çdo vend të rishikuar... Në shumë vende, është gjithashtu në lidhje me sistemet e ri-inxhinierisë në mënyrë që ata të mund të bëjnë më shumë, sistematikisht, të plotësojnë nevojat e biznesit modern. Rezultatet e të nxënësve janë komponente të rëndësishme të sistemeve të zhvillimit të kurrikulimit që mund të përgjigjen shpejt për të ndryshuar nevojat dhe mund të pajisë njerëzit me kompetenca më të gjera në një kontekst ku punësimi është shumë më pak i parashikueshëm dhe ku punëdhënësit kërkojnë një përzierje të kompetencave teknike dhe kyçe...” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Në vendet evropiane, ka qasje të ndryshme brenda shteteve, sa i përket miratimit të kurrikulave të reja. Në shumë vende evropiane, rishikimi dhe shkrimi i kurrikulave i nënshtrohet një procesi konsultativ në mes të akterëve të ndryshëm në shoqëri, por në shumicën e vendeve, përgjegjësia zyrtare i takon qeverisë, sikur që është në Kosovë, Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASHT). “Në shumicën e vendeve, përgjegjësia formale për të miratuar kurrikulën qëndron në qeverinë. Megjithatë, në disa vende, qeverisja e dizajnit të procesit të kurrikulit është shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjithë nivelet rajonale dhe lokale, ndërsa në të tjerat, ajo është e përqendruar kryesisht në autoritetet e qeverisë qendrore. Në Francë, për shembull, dizajni i kurrikulimit udhëhiqet nga administrata, zyrtarë të ministrisë përkatëse. Punëdhënësit përfshihen në kuadër të Komisionit Profesional Konsultativ (Komisioni Profesional Konsultativ, CPC), i cili është organi që është përgjegjës për procesin e zhvillimit. CPC formon një nëngrup, duke përfshirë përfaqësuesit e punëdhënësve dhe punonjësve, si dhe inspektorët dhe zyrtarët që kryejnë hulumtimin dhe shkruajnë standardet.” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Në shumicën e vendeve evropiane, sikurse mund ta përmendim edhe ndonjë prej tyre, si Austria dhe të tjera, formalisht, miratimi i kurrikulës është proces dhe akt qeveritar. “Ngjashëm, në Austri, zhvillimi i kurrikulumit kontrollohet drejtpërsëdrejti nga ministritë relevante. Megjithatë, në shumë vende, si Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Finlanda, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovenia, Spanja dhe Suedia, procesi i zhvillimit të kurrikulës kontrollohet nga një publik..., megjithëse miratimi formal është dhënë në formë të një dekreti ministror ose qeveritar.... Ka disa vende ku organet sektoriale mbajnë një pjesë të madhe të autoritetit të tyre në procesin e hartimit të kurrikulit. Në Lihtenshtajn, për shembull, zhvillimi i kualifikimit dominohet nga organet sektoriale të njohura si Organizimi i Arbeitsëelt. Këto organizata punësojnë ekspertë që mbajnë shkrimin, hulumtimin dhe konsultimin; ata gjithashtu mund të sjellin ekspertizë të jashtme. Ose qeveria ose një organizatë der Arbeitsëelt mund të shkaktojnë modifikimin ose ndryshimin e kurrikulit.” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

### **5.11 Legjislacioni i Bashkimit Evropian mbi kurrikulën parauniversitare**

Bashkimi Evropian sikur për shumicën e fushave, edhe arsimit i ka kushtuar rëndësi të veçantë. “Është miratuar Rezoluta e Parlamentit Evropian për iniciativat për plotësimin e kurrikulave shkollore, masat e duhura mbështetëse për të përfshirë dimensionin evropian (2006/2041 (INI)); Traktati i Komisionit Evropian, sidomos neni 149; Rezoluta për Rritjen e Dimensionit Evropian në Arsim, të cilin Këshilli dhe Ministrat e Arsimit e kanë miratuar më 24 maj 1988; Dokumentin e Gjelbër mbi Dimensionin Evropian të Arsimit (COM (1993) 0457); Komunikimin e Komisionit me titull: "Një Strategji e re Kuadër për Shumëgjuhësinë "(COM (2005) 0596); Raporti i përbashkët i përkohshëm i Këshillit dhe Komisionit për

zbatimin e programit të detajuar të punës për ndjekjen e objektivave të sistemeve të arsimit dhe trajnimit në Evropë me titull "Edukimi dhe trajnimi 2010"; Strategjia e Lisbonës; Raporti i Komisionit për Kulturë dhe Arsim (A6-0267 / 2006); Parlamenti Evropian ka pasur seancën dëgjimore për "Dimensionin Evropian në Mësimdhënien e Historisë" së 7 prillit 2004; Iniciativat nga autoritetet kombëtare në Shtetet Anëtare si: Austria, Gjermania, Portugalia, Holanda, Britania e Madhe, Sllovenia dhe Spanja për temën e vendit të Evropës në arsim dhe ndërsa shumë iniciativa janë marrë në këtë fushë nga organizata joqeveritare..." (Official Journal of the European Union, 2006)

Legjislacioni i Bashkimit Evropian nuk i ka rrafshuar krejt dallimet në mes të sistemeve të ndryshme arsimore dhe kombëtare të shteteve anëtare. Shtetet anëtare kanë parlamentet e tyre kombëtare dhe rregullimin e veçantë të modelit arsimor në përputhje me rrethanat e tyre lokale, kulturore, ekonomike, kombëtare etj., por në shumë parime të përgjithshme të edukimit, faza të sistemit arsimor etj., janë duke u unifikuar dhe duke u integruar. Sistemi evropian po integrohet jo vetëm në fushën e tregtisë, ekonomisë, kulturës, por në fushën e arsimit, madje duke pasur programe të veçanta integrimi arsimor edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor, që është drejt rrugëve integruese-evropiane. Duke u homogjenizuar në shumë fusha, edhe në arsim, vendet anëtare të BE-së, po ndajnë përvojat dhe modelet e tyre të përbashkëta, duke ndikuar te njëra-tjetra, por edhe duke ruajtur disa nga veçoritë e tyre nacionale.

### **5.12 Qasja Integruese Evropiane e kurrikulës**

Shumicën e ligjeve në Kosovë, gjatë përpilimit, shqyrtimit dhe miratimit, e shikojnë nga qasja integruese evropiane. Po njësoj ndodh edhe me Kurrikulën në Arsimin Parauniversitar, duke u përpjekur të ketë harmonizim sa më të madh të kurrikulës me shtetet e Bashkimit Evropian, qoftë në dokumente kurrikulare, qoftë në ligjet për arsim, qoftë në reformat dhe standardet e kërkuara evropiane për arsimim cilësor etj. Qasja integruese evropiane e kurrikulës, i bie se kurrikula e Kosovës, duhet të jetë sa më e integruar në kurrikulën evropiane, sa më e ngjashme të jetë me të dhe synimet e përcaktuara në kurrikulën evropiane, të jenë të përfshira në kurrikulën kosovare. Kuptohet se shtetet kombëtare brenda BE-së, përpiqen të ruajnë edhe disa nga karakteristikat e tyre lokale, kulturore dhe kombëtare, që të jenë pjesë e kurrikulave të tyre parauniversitare. "Rekomandimet e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi kompetencat kyçe për të Mësuarit gjatë gjithë jetës (2006) dhe

Kuadrin evropian të kualifikimeve (2008) kanë qenë veçanërisht me ndikim në nivel kombëtar. Në vitin 2009, Arsimi dhe Trajnimi 2020 theksoi rëndësinë e reformës dhe rinovimit të kurrikulit në promovimin e qasjeve të orientuara drejt rezultateve dhe kompetencave kyçe, duke vendosur si një objektiv strategjik "për të marrë më shumë vëmendje të kompetencave kryesore transversale në kurrikula, vlerësime dhe kualifikime". European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Në Evropë kurrikula po ndryshonte vazhdimisht, duke ndjekur ritmin e zhvillimeve të gjithëmbarshme shoqërore, politike, ekonomike dhe teknologjike. Sipas Cedefop (2018), këto janë disa nga synimet e Qasjes Integruese Evropiane të Kurrikulës: “Planifikimi i kurrikulës, mësimdhënia, vlerësimi dhe mjediset e të nxëniet duhet të bazohen në mënyrë të vazhdueshme në rezultatet e të nxëniet dhe një theks i veçantë duhet të vendoset në ato kompetenca transversale që kërkojnë metoda ndër-kurrikulare dhe inovative. Më vonë, konkluzionet e Këshillit të 26 nëntorit 2009 për zhvillimin e rolit të arsimit në një trekëndësh të njohurive plotësisht funksionale (arsim, hulumtim dhe inovacion) nxitën reformën e kurrikulës arsimore në Evropë.” (f. 19)

Qasja Integruese Evropiane ka për qëllim që standardet profesionale të përcaktohen me bazë kompetencat. “Një kornizë teorike e zhvilluar për këtë studim mundëson krahasimin midis qasje të kurrikulave të orientuara drejt rezultateve në vende të ndryshme evropiane. Ky model ndan procesin e dizajnit në katër faza: standardi profesional, klasifikimi dhe përkufizimi i detyrave që bëjnë punëtorët dhe përgjegjësitë që ata ushtrojnë në profesione të ndryshme (Cedefop, 2009c). Standardet profesionale zakonisht përcaktohen në kuptim të kompetencave. Në qasjet e bazuara në kompetenca, standardet profesionale përdoren si bazë për zhvillimin e kualifikimeve dhe kurrikulave; ato gjithashtu mund të përdoren për të informuar hulumtimet në zhvillimin e fuqisë punëtore dhe projektimit në vendin e punës...” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

### 5.13 Struktura e sistemit arsimor parauniversitar në BE

Në një nga faqet zyrtare të Bashkimit Evropian mbi kurrikulën parauniversitare, mund të gjeni edhe sistemet arsimore në nivel kombëtar. “Këtu mund të konsultoheni me faqet e 42 njësive kombëtare të bazuara në 38 shtetet pjesëmarrëse në programin Erasmus + (28 shtete anëtare, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Islanda, Lihtenshtajni, Mali i Zi, Norvegjia, Serbia, Zvicra dhe Turqia). Ju mund të shfletoni nga njësia kombëtare ose nga kapitulli. Njësitë kombëtare janë përgjegjëse për hartimin e përshkrimit të sistemit arsimor dhe përmbajtjen e të gjitha 14 kapitujve.” National Education Systems. (24.10.2018). Marrë prej [https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/albania\\_en](https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/albania_en)

Shumica e shteteve të Bashkimit Evropian i kanë të përafërta ose të ngjashme shumë nga fazat e sistemit arsimor, arsimin e detyrueshëm, nivelet e shkollimit, synimet dhe objektivat, të cilat janë në ngjashmëri të madhe edhe me sistemin arsimor dhe kurrikular në Kosovë. Për ilustrim, mund ta marrim ta shikojmë, p. sh., sistemin arsimor në Gjermani:

“Fazat e sistemit arsimor - Edukimi dhe kujdesi i fëmijërisë së hershme

Edukimi i fëmijërisë së hershme sigurohet nga institucionet që ushqejnë fëmijët deri në moshën gjashtë vjeçare në të cilën zakonisht fillojnë shkollën. Fëmijët e moshës shkollore të cilët nuk kanë arritur ende një nivel të mjaftueshëm zhvillimi për të ndjekur një shkollë kanë një mundësi tjetër në disa shtete, dmth. Schulkindergärten dhe Vorklassen. Këto institucione u caktohen në fëmijërinë e hershme ose në sektorin primar sipas shtetit (land-it) të veçantë.

*Arsimi i detyrueshëm* - Si rregull, fillimi i arsimit të detyrueshëm të përgjithshëm fillon për të gjithë fëmijët në Republikën Federale të Gjermanisë në vitin në të cilin arrijnë moshën gjashtë vjeçare dhe përfshin nëntë vjet shkollim me kohë të plotë. Ata të rinj që nuk ndjekin një shkollë të përgjithshme të arsimit të përgjithshëm ose shkollë profesionale në nivelin e mesëm të lartë pasi të kenë përfunduar periudhën e shkollimit të detyrueshëm të përgjithshëm, duhet të vazhdojnë shkollimin me kohë të pjesshme (pjesëmarrja e detyrueshme në Berufsschule - Berufsschulpflicht). Kjo zakonisht zgjat tre vjet. *Shkollë fillore* - Si rregull, në vitin në të cilin fëmijët arrijnë moshën gjashtëvjeçare, ata janë të detyruar të ndjekin shkollën fillore. Të gjithë nxënësit në Gjermani hyjnë në Grundschule e cila në pothuajse të gjitha shtetet mbulon klasat 1 deri në 4 (në Berlin dhe Brandenburg klasat 1-6).



*Arsimi i Mesëm* - Pas fazës së shkollës fillore, arsimi i mesëm në Länder karakterizohet nga ndarja në shtigjet e ndryshme arsimore me certifikatat dhe kualifikimet e tyre përkatëse për të cilat janë përgjegjës lloje të ndryshme të shkollave. Pasi nxënësit të kenë përfunduar shkollimin e detyrueshëm ata hyjnë në arsimin e mesëm të lartë. Gama e kurseve në ofertë përfshin arsimin e përgjithshëm dhe shkollat profesionale, si dhe trajnimin profesional brenda sistemit dual.

Në llojet e shkollave që ofrojnë një kurs të arsimit, të gjitha mësimet drejtohen në një kualifikim specifik. Këto tradicionalisht kanë qenë *Hauptschule*, *Realschule* dhe *Gjymnazi*. Schularten mit mehreren *Bildungsgängen* (shkolla që ofrojnë më shumë se një lloj të kursit të arsimit) sjellin dy ose tre kurse edukimi nën një ombrellë. Në shumicën e Länder ata ndërkohë kanë çuar në heqjen e *Hauptschule* dhe *Realschule*. Për nxënësit me sonderpädagogischer Förderbedarf (nevoja të veçanta arsimore), përveç kësaj, janë ngritur lloje të ndryshme të sonderpädagogische *Bildungseinrichtungen* (shkolla të veçanta), në kuadrin organizativ të arsimit të përgjithshëm dhe profesional. Pasi nxënësit të kenë përfunduar shkollimin e detyruar - përgjithësisht kur arrijnë moshën 15 - vjeçare, ata hyjnë në arsimin e mesëm të lartë. Lloji i shkollës së hyrë varet nga kualifikimet dhe të drejtat e fituara në fund të arsimit të mesëm të ulët.” National Education Systems. (24.10.2018). Marrë prej [https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/albania\\_en](https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/albania_en)

## 5.14 Standardet evropiane mbi kurrikulën parauniversitare

Standardet evropiane mbi kurrikulën parauniversitare i kanë sidomos rrënjët e fuqizuara gjatë vitit 1990, apo edhe më herët.

“Pak më shumë se gjysma e vendeve të shqyrtuara ku futja e orientimit të rezultateve daton në vitet 1990 ose më herët, konsiderohen zhvilluesit e hershëm. Ky grup përfshin Belgjikën (Flanders), Finlandën, Irlandën, Holandën, Norvegjinë, Suedinë dhe Mbretërinë e Bashkuar, së bashku me disa vendet qendrore dhe lindore të Evropës (Hungari, Lituani, Poloni dhe Slloveni) i cili filloi programet e reformës në arsim dhe trajnim në një fazë mjaft të hershme në krahasim me fqinjët e tyre.” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Standardet evropiane mbi kurrikulën ishin nga më të ndryshmet në tri dekadat e fundit. Ato ndryshonin nga vendi në vend dhe shkonin gjithnjë e duke u harmonizuar. Në Suedi, ardhja e rezultateve të mësimi i atribuohet hyrjes së një sistemi të bazuar në kredi në vitin 1999. Në Finlandë, kurrikulat thelbësore kombëtare në profesion, arsim dhe trajnim dhe kërkesa kombëtare në bazë të kompetencave... kanë qenë të bazuara në një qasje të orientuar nga rezultatet që nga vitet 1993-94. Futja e kurrikulave të orientuara drejt rezultateve në Mbretërinë e Bashkuar nëpërmjet NVQ-ve është i njohur mirë... Një shembull tjetër është dhënë nga Holanda, ku baza për qasjen aktuale të bazuar në kompetenca në AFP u përcaktua në diskutime, duke filluar në nivel kombëtar në vitin 1999, pas miratimit të Ligjit e Akti të Përgjithshëm të Arsimit të Rritur dhe Arsimit Profesional (Wet Educatie en Beroepsondewijs, WEB) në vitin 1996. Kualifikimet u kritikuan për mosdhënien e vëmendjes së mjaftueshme për kompetencat kyçe. Si rrjedhojë, akterët kombëtarë filluan një proces të shqyrtimit, i cili çoi në një kornizë të re të cilësisë në vitin 2006. I par inga eksperimentet me strukturat aktuale të kualifikimit të bazuar në kompetenca ishin nga 2005-09. Ato duhej të zbatoheshin me ligj në vitin 2009, por kjo u shty për vitin 2012. Në fund të vitit 2011, u njoftua se bazohet në strukturat e kualifikimit të bazuar në kompetenca duhet të rrimërohej, duke reflektuar një zhvendosje në theks drejt njohurive dhe aftësive specifike profesionale.” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Bashkimi Evropian dhe vendet evropiane në përgjithësi, gjithnjë e më shumë kanë standardizuar dhe harmonizuar kurrikulat. “Në mbi gjysmën e vendeve të analizuara (Austria, Belgjika (Valloni), Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Gjermania, Greqia, Islanda, Letonia, Malta dhe Sllovakia) ku futja e rezultateve të të nxënit daton që nga viti 2005 (vini re se kjo nënkupton futjen e legjislacionit, pra faza fillestare e procesit të zhvillimit në vend të asaj zbatimit aktual të kurrikulave të orientuara kah rezultatet) janë konsideruar zhvilluesit e fundit. Spanja dhe Portugalia janë gjithashtu të përfshira në këtë grup, ku orientohen rezultatet filloi herët në një fushë të AFP-së dhe ka ofruar bazën për më shumë përhapje aplikimit më së fundi. Shumica e këtyre vendeve janë në qendër dhe lindje të Evropës dhe Mesdheut. Këto vende kanë qenë ato që kanë nevojë më shumë reforma me shumicë, modernizimi dhe përditësimi i kurrikulës... Qasjet e orientuara drejt rezultateve kanë qenë kyçe për këtë proces...” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

## 5.15 Ndikimi i modeleve evropiane në kurrikulën kosovare

Vendet evropiane dhe kryesisht modeli kurrikular që është vënë në zbatim në Republikën e Shqipërisë, dhe kjo e fundit po ashtu e ndikuar nga vetë vendet e Bashkimit Evropian, kanë pasur ndikim determinues në modelin kurrikular të Kosovës. “Ndonëse Gjermania ka koncepte të kompetencave të qëndrueshme dhe të zhvilluara mirë, të cilat mbështesin theksin e saj unik në identitetin e profesionit (Beruf), mund të thuhet se ky koncept unik ka pasur ndikim relativisht të vogël jashtë kombeve gjermanofolëse (siç e përmend Gehmlich, 2009; Çikrik, 2011). Zhvillimi në vitet 1980 të një sistemi ekskluzivisht të orientuar drejt rezultateve të kualifikimeve fillestare profesionale (NVQ) në Mbretërinë e Bashkuar ka qenë ndoshta më me ndikim (siç e përmend Burke, 1995). Megjithëse është kritikuar shumë, qasja e Mbretërisë së Bashkuar ka ofruar një model për vendet e tjera, si në Evropë dhe më gjerë, por jo gjithmonë me sukses të madh (siç e përmend Allais, 2012). Puna konceptuale ka qenë gjithashtu një tipar i zhvillimeve në Francë gjatë viteve 1990, të cilat kanë mbështetur progresin brenda sistemeve të saj të arsimit dhe trajnimit dhe tani po ndihmojnë në kombinimin e koncepteve të kompetencës dhe rezultateve të të nxënës (siç e përmend Le Deist, 2009).” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

Në Kurrikulën e Re të Kosovës, ndër nocionet më të përdorura janë “kompetencat” dhe “rezultatet”, të cilat janë pjesë e vetë Qasjes Integruese Evropiane dhe Bashkimit Evropian. “Markowitsch dhe Paimauer (2009) kanë eksploruar klasifikimin ndërkombëtar të 'kompetencës' dhe 'rezultateve të të nxënës'... 'rezultatet e të nxënës' janë të definuara si deklaratatë të asaj që një nxënës i di, kupton dhe është në gjendje të bëjë përfundimin e një procesi mësimor, të cilat janë përcaktuar si njohuri, shkathtësi dhe kompetencat (siç e përmend Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së, 2008, Shtojca 2). Në këtë përkufizim, 'kompetencë' kuptohet si një aftësi e veçantë që nuk është kapur plotësisht si njohuri ose aftësi. 'Kompetencat', në këtë kuptim, kuptohet i referohen autonomisë dhe përgjegjësisë, vlerave dhe qëndrimeve.” European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)

## KAPITULLI IV - REZULTATET E HULUMTIMIT

Në do të prezantojmë të dhënat e mbledhura në terren, përmes metodës sasiore apo kuantitative, gjatë zbatimit të pyetësorit, me mostër jo të rastit, prej 270 respondentësh, mësues/e dhe mësime/mësues/e. Ne kemi zbatuar pyetësorin në 9 shkolla të komunës së Prishtinës, përkatësisht, në 3 shkolla fillore, në 3 shkolla të mesme të ulëta dhe dhe në 3 shkolla të mesme të larta, prej klasës I-XII.

Pyetësorin e kemi ndarë në disa nëntema: qëndrimet e mësime/mësuesve ndaj ndryshimit të kurrikulave parauniversitare, ndikimin e numrit të nxënësve dhe kohëzgjatjes së orës mësimore në qëndrimet ndaj kurrikulës, krahasimin e qëndrimeve ndaj kurrikulës së re dhe të vjetër, ndikimin e trajnimit të mësime/mësuesve për kurrikulë në qëndrimet e mësime/mësuesve, si dhe një sërë pyetje të hapura e të mbyllura, për të numëruar sfidat e zbatimit të kurrikulës nga vetë mësime/mësuesit.

Më poshtë (*Tabela 4*), kemi paraqitur të dhënat e përgjithshme të respondentëve dhe zonës se ku janë zbatuar pyetësorët, duke specifikuar numrin e përgjithshëm të respondentëve, proporcionin gjinor në pjesëmarrje, emrat e shkollave ku është kryer hulumtimi.

Ne kemi marrë paraprakisht edhe leje me shkrim në Drejtorinë e Arsimit – komuna e Prishtinës, pas kërkesës sonë për të bërë hulumtimin me mësues e mësime/mësues.

<b>SHKOLLA KU ËSHTË ZBATUAR PYETËSORI</b>	<b>EMRI I SHKOLLËS</b>	<b>VENDBANIMI I SHKOLLËS</b>	<b>PROPORCION I GJINOR</b>	<b>NUMRI TOTAL I RESPONDENTËVE</b>
Filllore (klasa I-V)	“Xhemal Mustafa” “Naim Frashëri” “Hasan Prishtina”	Qendër e qytetit Qendër e qytetit Qendër e qytetit	45 meshkuj dhe 45 femra	90
E Mesme e Ulët (klasa VI-IX)	“Naim Frashëri” “Elena Gjika” “Dardania”	Qendër e qytetit Qendër e qytetit Qendër e qytetit	45 meshkuj dhe 45 femra	90

E Mesme e Lartë (X-XII)	“Sami Frashëri”	Qendër e qytetit	45 meshkuj dhe 45 femra	90
	“Abdyl Frashëri” “28 Nëntori”	Periferi urbane Periferi urbane		270 responentë

*Tabela 4.* Të dhënat e përgjithshme të responentëve dhe zonës ku është zbatuar pyetësori gjatë hulumtimit

Në vijim, ne do të prezantojmë qëndrimet e mësimeve të shkollave fillore, shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta, rreth ndryshimit të kurrikulave parauniversitare, gatishmërinë për të pranuar apo rezistuar ndryshimet e shpeshta në kurrikulë, vlerësimin e përputhjes së kurrikulave me rrethanat kosovare, raportin me modelin kurrikular në Shqipëri dhe vendet evropiane e skandinave, kurrikulën mbarëkombëtare, kurrikulat e vjetra dhe të reja, numrin e nxënësve dhe orës mësimore, shkallën e kënaqësisë dhe pakënaqësisë ndaj kurrikulës së vjetër e të re, nevojën e ndryshimit paraprak të teksteve shkollore-mësimore para ndryshimit kurrikular, zbatimin e kurrikulës prej cilësisë së trajnimit të mësimeve, kohëzgjatjen e trajnimeve etj.


Ne kemi ndarë në tri grupe prezantimin e rezultateve:

- 1) rezultatet nga përgjigjet e mësuesve dhe mësueseve në nivelin fillor;
- 2) rezultatet nga përgjigjet e mësimeve të nivelit të mesëm të ulët dhe;
- 3) shqyrtimin e hipotezave duke krahasuar përgjigjet e mësimeve të tri niveleve shkollore dhe me përvoja të ndryshme në arsim.

### 3.1. Qëndrimet e mësimeve në shkollat e nivelit klasor I-V ndaj ndryshimit të kurrikulave

#### 3.1.1. Ndryshimet e kurrikulave


Në pyetjen tonë rreth shkallës së pajtimit për të ndryshuar shpesh kurrikula, kemi shprehur një konstatim dhe më pas janë pyetur mësuesit e nivelit fillor, prej shkallës maksimale të pajtimit “Pajtohem shumë” e gjer në shkallën e mospajtimit total “Nuk pajtohem aspak”.



**Grafikoni 1.** Pasqyrë e përgjithshme e qëndrimeve të mësimeve ndaj ndryshimeve të shpeshta të kurrikulave

Sipas të dhënave të marra nga terreni dhe sikur e shohim në *Grafikonin 1*, rezulton se 46 përqind e mësuesve dhe mësueseve të nivelit fillor, nuk janë pajtuar relativisht me konstatimin se, “nuk duan të ndryshojnë aq shpesh kurrikula”; 27 përqind e tyre nuk janë pajtuar aspak, 10 përqind janë pajtuar relativisht, 10 përqind kanë qenë asnjëherë (neutral), dhe vetëm 7 përqind e tyre janë pajtuar shumë. Nëse mbledhim të gjithë ata dhe ato që nuk janë pajtuar, del se shumica dërmuese e tyre, gjegjësisht 73 përqind e tyre nuk refuzojnë që kurrikula të ndryshojnë shpesh. Vetëm 7 përqind e tyre, më së paku, janë paraqitur me konservatorë, duke mos pranuar shpesh ndryshimin e kurrikulave.

Por në *Grafikonin 2*, kur u kërkohet mësuesve e mësueseve që të deklarojnë se a do të donin të ndryshonte vazhdimisht kurrikula, nuk janë pajtuar shumica prej tyre me ndryshime të vazhdueshme të kurrikulës. 48 përqind e respondentëve në konstatimin “Unë dua të ndryshon vazhdimisht kurrikula”, nuk janë pajtuar relativisht me ndryshimin e vazhdueshëm të kurrikulës; 19 përqind nuk janë pajtuar aspak; 19 përqind me qëndrim neutral; 7 përqind janë pajtuar shumë, si dhe 7 përqind të tjerë janë pajtuar relativisht. Gjersa në *Grafikonin 1*, shohim se kur i kemi pyetur se sa refuzojnë që kurrikula të ndryshon aq shpesh, vetëm 7 përqind janë pajtuar shumë që nuk duan të ndryshon aq shpesh, ndërsa në *Grafikonin 2*, 48 përqind e respondentëve nuk duan po ashtu të ndryshon vazhdimisht kurrikula.



**Grafikoni 2.** Qëndrimet e mësimeve për ndryshimin e vazhdueshëm të kurrikulave.

Në konstatimin tjetër “Unë dua të ndryshon kurrikula në përputhje me rrethanat dhe mundësitë në Kosovë” (shih *Grafikonin 3*), mbi gjysma e respondentëve, 60 përqind e tyre, kanë deklaruar se “Pajtohen” relativisht që ndryshimi i kurrikulës të jetë në përputhje me rrethanat dhe mundësitë në Kosovë, kurse 30 përqind prej tyre janë “Pajtuar shumë” për këtë, dhe vetëm 10 përqind prej tyre nuk janë pajtuar. Nga ky hulumtim kuptojmë se, shumica e respondentëve e ndërlidhin kurrikulën me rrethanat lokale, e jo një model të vendeve aq të zhvilluara, që nuk përkon me kushtet e Kosovës.




**Grafikoni 3.** *Ndryshimi i kurrikulave në përputhje me rrethanat dhe mundësitë në Kosovë*

Në pyetësor kemi bërë disa nënpyetje në pyetjen e parë, mbi ndryshimet kurrikulare dhe modelet lokale, kombëtare e evropiane, për të matur qëndrimet e mësimit ndërkohë parauniversitarë. Një nga to ka qenë edhe rreth modelit të kurrikulës nga Republika e Shqipërisë, vendet evropiane, shtetet e Skandinavisë si: Suedia, Norvegjia etj. Duke qenë se modelet evropiane dhe skandinave, shihen si modelet më të mira, kemi matur qëndrimin e mësimit ndërkohë ndaj këtyre modeleve dhe cilat besojnë ata dhe ato se do të ishin më të përshtatshme për ta.



### 3.1.2. Modeli i kurrikulës së huaj si model kurrikular në Kosovë




**Grafikoni 4.** Qëndrimet ndaj modelit kurrikular të Shqipërisë si model për kurrikulën në Kosovë

Në konstatimin se “Unë dua të ndryshon kurrikula në përputhje me kurrikulën e Shqipërisë”, shumica e respondentëve janë pajtuar relativisht më këtë. 50 përqind e respondentëve kanë thënë se duan të ndryshon kurrikula në përputhje me kurrikulën e Shqipërisë; 17 përqind kanë shprehur pajtim maksimal; 17 përqind të tjerë nuk janë pajtuar; 10 përqind nuk janë pajtuar aspak dhe vetëm 6 përqind kanë mbajtur qëndrim neutral. Pra, në mesin e mësimdhënësve ka pasur diversitetet përgjigjesh rreth modelit kurrikular të Shqipërisë për shkollat e Kosovës, ndonëse shumica prej tyre, kanë shprehur pajtim (shih *Grafikonin 4*).

Kur kemi pyetur edhe për nevojën e një kurrikule mbarëkombëtare, me supozimin “Unë jam për një kurrikulë mbarëkombëtare, ku do të ishte e njëjtë për gjitha shkollat shqipe kudo që janë”, 47 përqind janë pajtuar relativisht, 40 përqind janë “Pajtuar shumë”, 13 përqind me deklaram neutral, por asnjëri nuk ka vendosur për opcionet: “Nuk pajtohem” dhe “Nuk pajtohem aspak” (shih *Grafikonin 5*).


Asnjë nga respondentët nuk ka refuzuar një kurrikulë mbarëkombëtare. Ndërsa ne kemi pyetur mësuesit dhe mësueset e nivelit fillor, se sa duan të ndryshon kurrikula në përputhje me shtetet skandinave.

Në supozimin tjetër “Unë dua të ndryshon kurrikula në përputhje me shtetet skandinave si: Suedia, Danimarka, Norvegjia etj.”, 43 përqind prej tyre janë “Pajtuar shumë”, pajtim të lehtë kanë shprehur 40 përqind e respondentëve, ndërsa 17 përqind kanë mbajtur qëndrim neutral (shih *Grafikonin 6*).




**Grafikoni 5.** Qëndrimet e mësimeve ndaj një kurrikule mbarëkombëtare shqiptare

Nëse krahasojmë shkallën e pajtimit për modelin e Shqipërisë dhe të Skandinavisë, rezulton se më shumë kanë shprehur pajtim për kurrikulën e Skandinavisë, sesa atë të Shqipërisë. 67 përqind janë pajtuar për kurrikulën e Shqipërisë si model për shkollat e Kosovës, ndërsa për Skandinavinë, 87 përqind.




**Grafikoni 6.** Qëndrimet e mësimeve ndaj kurrikulës së shteteve skandinave

Në supozimin se “Duhet të ndryshohen paraprakisht të gjitha tekstet mësimore-shkollore, para se të ndryshohet kurrikula e arsimit parauniversitar”, qëndrimet absolute të respondentëve ishin pajtuese. 50 përqind janë pajtuar maksimalisht, ndërsa 50 përqind të tjerë po ashtu janë pajtuar, por pa e theksuar “shumë” (Grafikoni 7).



**Grafikoni 7.** *Ndryshimi paraprak i teksteve mësimore-shkollore dhe ndryshimi i kurrikulës*


### 3.1.3. Qëndrimet ndaj kurrikulës së vjetër dhe të re parauniversitare



**Grafikoni 7.** *Qëndrimet ndaj kurrikulës së vjetër dhe të re*


Duke matur qëndrimet ndaj kurrikulës së vjetër dhe të re, në konstatimin “Kurrikulat e vjetra janë më të përshtatshme sesa kurrikulat e reja”, 37 përqind e respondentëve janë pajtuar relativisht se, kurrikulat e vjetra janë më të përshtatshme se kurrikulat e reja; 23 përqind kanë mbajtur qëndrim neutral; 20 përqind nuk janë pajtuar relativisht, 17 përqind janë “Pajtuar shumë”, dhe vetëm 3 përqind nuk janë pajtuar aspak. Edhe për kurrikulat e vjetra apo të reja, qëndrimet e respondentëve janë të ndara, por shumica prej tyre i kanë favorizuar kurrikulat e vjetra si më të përshtatshme.

Gjatë zbatimit të pyetësorit në hulumtimin tonë, kemi bërë disa nënpyetje rreth shkallës së kënaqësisë dhe pakënaqësisë me kurrikulën e re. Në pohimin “Unë jam shumë i-e kënaqur me kurrikulën e re”, 47 përqind nuk janë pajtuar relativisht; 30 përqind nuk janë pajtuar aspak; 13 përqind janë pajtuar relativisht; 7 përqind janë pajtuar shumë, dhe 3 përqind kanë pasur qëndrim neutral (shih *Grafikonin 8*).



**Grafikoni 8.** Shkalla e kënaqëshmërisë së mësuesve-eve të klasës I-V me kurrikulën e re

Ndërsa me shkallën e kënaqshmërisë me kurrikulën e vjetër, po ashtu, respondentët janë të ndarë në disa qëndrime. 30 përqind e tyre janë pajtuar shumë; 27 përqind nuk janë pajtuar, 23 përqind janë pajtuar relativisht; 13 përqind nuk pajtohen aspak dhe 7 përqind neutralë (Grafikoni 9).




**Grafikoni 9.** Shkalla e kënaqshmërisë së mësuesve-eve të klasës I-V me kurrikulën e vjetër

Për të kuptuar më shumë arsyet e sfidave në zbatimin e kurrikulës së re, ne kemi bërë disa nënpyetje të tjera, të cilat ndërlidhen me shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në zbatimin e kurrikulës. Një nga to është edhe numri i madh i nxënësve në çdo klasë, kohëzgjatja e orës mësimore etj.

### 3.1.4. Efekti i numrit të nxënësve dhe kohëzgjatjes së orës mësimore në zbatimin e kurrikulës së re


#### 3.1.4.1. Numri i nxënësve në klasë dhe sfidat e zbatimit të kurrikulës



**Grafikoni 10.** Efektet e numrit të nxënësve në zbatimin e kurrikulës


Në pohimin se “Kurrikula nuk mund të zbatohet me numër të nxënësve më shumë se 15 nxënës në klasë”, 40 përqind e respondentëve janë pajtuar relativisht, 23 përqind janë “Pajtuar shumë”, 14 përqind me qëndrim neutral, 13 përqind nuk janë pajtuar relativisht dhe 10 përqind nuk janë pajtuar aspak (Grafikoni 10). Me Udhëzimin Administrativ: Nr.22/2013 Numri Maksimal i Nxënësve për Klasë dhe Raporti Mësimdhënës-Nxënës, nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Neni 3, tek nëntema “Arsimi i Obliguar (1-9) dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (10-12)”, përcakton edhe numrin minimal dhe maksimal të nxënësve për çdo klasë. “Numri i nxënësve në një klasë/paralele normalisht duhet të jetë 30 nxënës për nivelin e parë (1-5), ndërsa maksimumi i lejuar është 35; 2. Për nivelin e dytë (6-9) dhe të tretë (10-12), për gjimnazet, numri i nxënësve për klasë/paralele normalisht duhet të jetë 32, ndërsa maksimumi i lejuar 35 nxënës.”(MASHT, 2013. Marrë prej <http://masht.rks.gov.net/uploads/2015/05/22-2013-ua.pdf>)

### 3.1.4.2. Ora e shkurtër mësimore dhe sfidat e zbatimit të kurrikulës



**Grafikoni 11.** *Ndikimi i orës së shkurtër mësimore në zbatimin e kurrikulës*

Në parim, ora mësimore në shkollat e Kosovës zgjat 45 minuta. Në pohimin se “Kurrikula nuk mund të zbatohet me orën aktuale e të shkurtër mësimore”, 35 përqind e respondentëve janë pajtuar maksimalisht; 34 përqind janë pajtuar relativisht; 17 përqind nuk janë pajtuar; 7 përqind nuk janë pajtuar aspak dhe, 7 përqind kanë mbajtur qëndrim neutral (*Grafikoni 11*).




**Grafikoni 12.** Zgjatja e orës mësimore prej 45 minutash në 60 minuta

Në supozimin se “Kurrikula nuk mund të zbatohet pa zgjatur orës mësimore deri në 60 minuta”, 43 përqind e respondentëve nuk janë pajtuar relativisht; 23 përqind nuk janë pajtuar aspak; 17 përqind janë pajtuar relativisht; 10 përqind janë pajtuar shumë, si dhe, 7 përqind kanë mbajtur qëndrim neutral (*Grafikoni 12*).


Në konstatimin se “Numri aktual i nxënësve dhe ora aktuale mësimore nuk janë fare pengesa në zbatimin e kurrikulës së re”, qëndrimet janë po ashtu të ndryshme. 40 përqind e respondentëve kanë deklaruar se pajtohen shumë me këtë pohim; 40 përqind pajtohen relativisht; 17 përqind me qëndrim neutral dhe 3 përqind nuk janë pajtuar (*Grafikoni 13*).

Ndërsa lidhur me rritjen e numrit të mësimdhënësve në zbatimin të kurrikulës, respondentët janë përgjigjur si në vijim: 37 përqind e tyre janë pajtuar relativisht; 30 përqind janë pajtuar shumë, 13 përqind nuk janë pajtuar, 10 përqind nuk janë pajtuar aspak dhe, 10 përqind kanë shprehur qëndrim neutral (*Grafikoni 14*).






**Grafikoni 13.** Matja e efektit të numrit aktual të nxënësve dhe orës aktuale mësimore në zbatimin e kurrikulës




**Grafikoni 14.**Rritja e numrit të mësimdhënësve

### 3.1.5. Trajnimi i mësimdhënësve dhe zbatimi i kurrikulës




**Grafikoni 15.** Zbatimi i kurrikulës dhe shkalla e cilësisë e trajnimit të mësimdhënësve

Qëndrimet e mësimdhënësve të nivelit klasor I-V janë të ndara rreth ndikimit të shkallës dhe cilësisë së trajnimit të mësimdhënësve për kurrikulë. 43 përqind e tyre janë pajtuar se zbatimi i kurrikulës varet kryesisht prej shkallës dhe cilësisë së trajnimit të mësimdhënësve për këtë kurrikulë; 20 përqind e tyre janë “pajtuar shumë”; 17 përqind nuk janë pajtuar fare; 10 përqind nuk janë pajtuar relativisht dhe 10 përqind me qëndrim neutral (Grafikoni 15).



**Grafikoni 16.** Shkalla e profesionalizmit të trajnuesve për kurrikulë të re

Ndërsa në pyetjen rreth trajnimit nga trajnerët profesionistë, 40 përqind janë pajtuar se trajnimi për kurrikulë bëhet nga trajnerë profesionistë; 33 përqind janë pajtuar shumë; 10 përqind nuk janë pajtuar; 10 përqind të tjerë me qëndrim neutral dhe 7 përqind e tyre nuk janë pajtuar aspak (Grafikoni 16).



**Grafikoni 17.** Efikasiteti i kohëzgjatjes së shkurtër të trajnimeve për kurrikulë

Rreth kohëzgjatjes së trajnimeve dhe ndikimin e kohëzgjatjes së trajnimeve në efikasitetin e dobët të tyre, po ashtu qëndrimet e respondentëve janë të larmishme. Shumica e tyre, 47 përqind, pajtohen relativisht se trajnimet janë të shkurtra, prandaj janë joefikase; 23 përqind se “pajtohen shumë”; 13 përqind nuk pajtohen; 10 përqind nuk pajtohen aspak, dhe 7 përqind me qëndrim neutral (Grafikoni 17).

### 3.2. Sfidat e zbatimit të kurrikulës

#### 3.2.1. Sfidat më të mëdha në zbatimin e kurrikulës parauniversitare


Në pyetjen drejtuar respondentëve, përkatësisht arsimtarëve dhe arsimtareve të nivelit klasor prej I-V, se cilat janë tri sfidat më të mëdha në zbatimin e kurrikulës, shumica prej tyre, i janë shmangur përgjigjeve të pyetjes së tipit të hapur. Mirëpo, edhe ato përgjigje të pak mësimdhënësve, kanë qenë kryesisht si në *Tabelën 2*.

<b>SFIDAT MË TË MËDHA NË ZBATIMIN E KURRIKULËS</b>
1. Mungesa e mjeteve të konkretizimit
2. Tekstet e vjetra
3. Orari i shkurtër mësimor
4. Hapësira e objektit
5. Numri i madh i nxënësve
6. Vlerësimi i nxënësve
7. Mjetet e punës
8. Mungesa e hulumtimeve
9. Kabinetet

*Tabela 5. Sfidat e zbatimit të kurrikulës*

### 3.2.2. Shpenzimi i kohës paraprake para zhvillimit të orës mësimore dhe kurrikula


Në pyetjen e tretë, “Ju konsideroni se shpenzoni kohë për zbatimin e kurrikulës para mbajtjes së një ore mësimore”, me alternativat a) 1-2 orë në ditë, b) 2-4 orë në ditë, c) Mbi 4 orë, dhe opcionin e fundit, d) Tjetër, 7 përqind e respondentëve janë përgjigjur se, shpenzojnë 2-4 orë në ditë në shpenzimin e kohës para mbajtjes së një ore mësimore për të zbatuar kurrikulën; 20 përqind 1-2 orë në ditë; 7 përqind mbi 4 orë (Grafikoni 18).



**Grafikoni 18.** Koha e shpenzuar para zhvillimit të orës mësimore dhe zbatimi i kurrikulës

### 3.2.3. Ndikimi i llojit të kurrikulës në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Në pyetjen e parashtruar hulumtuese “Sa mendoni se ndikon vetë lloji i kurrikulës në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në përgjithësi”, shumica e konsiderueshme, përkatësisht 93 përqind e respondentëve, kanë deklaruar se ndikon mesatarisht dhe vetëm 7 përqind kanë thënë se nuk ndikon aspak. Asnjë respondent nuk ka deklaruar se vetë lloji i kurrikulës ndikon shumë në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në përgjithësi (Grafikoni 19).



**Grafikoni 19.** Ndikimi i kurrikulës në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies

### 3.2.4. Efekti i përvojës në mësimdhënie dhe rezistenca ndaj kurrikulave të reja


Se a ka dallime në mes të mësimdhënësve me përvojë të re në arsimin parauniversitar 1-5 vjet, atyre nga 5-10 vjet dhe me përvojë mbi 10 vjet, ka qenë edhe objektivi i këtij hulumtimi, për ta konfirmuar apo jo hipotezën tonë se, “mësimdhënësit me përvojë të gjatë në arsim janë më konservatorë në pranimin e kurrikulave të reja, sesa mësimdhënësit me përvojë të re”. Shumica e respondentëve, 77 përqind e tyre janë pajtuar mesatarisht me këtë; 10 përqind nuk janë pajtuar aspak, 7 përqind janë pajtuar shumë, dhe vetëm 6 përqind janë pajtuar pak (Grafikoni 20).



**Grafikoni 20.** Vlerësimi i efektit të përvojës në mësimdhënie në pranimin apo refuzimin e kurrikulave të reja

### 3.2.5. Faktorët e tjerë në zbatimin efikas të kurrikulës

Në pyetjen e 6 të pyetësorit, në pohimin “Zbatimi i kurrikulës, varet më së shumti nga:”, kemi renditur këto alternativa: a) Cilësia e mësimdhënësve; b) Mjetet e konkretizimit në dispozicion; c) Numri i nxënësve; d) Mënyra e menaxhimit të përgjithshëm të shkollës; e) Shkalla më e madhe e monitorimit nga inspektorët e arsimit; f) Ndryshimi i teksteve mësimore-shkollore. Shumica e respondentëve kanë përmendur numrin e nxënësve si faktor në zbatimin e kurrikulës; 23 përqind mjetet e konkretizimit në dispozicion; 23 përqind të tjerë mënyrën e menaxhimit të përgjithshëm të shkollës; 14 përqind cilësinë e mësimdhënësve; 3 përqind shkallën më të madhe të monitorimit nga inspektorët e arsimit, dhe 3 përqind të tjerë ndryshimin e teksteve mësimore-shkollore (Grafikoni 21).



**Grafikoni 21.** Qëndrimet e respondentëve rreth faktorëve që ndikojnë në zbatimin e kurrikulës



### 3.2.6. Efikasiteti i kurrikulës dhe lloji i lëndës mësimore

Ka disa mësimdhënës që nuk janë të kënaqur me kurrikulën dhe disa janë më të kënaqur. Kemi synuar që të gjejmë se çfarë qëndrime kanë mësimdhënësit rreth llojit të lëndës dhe efikasitetit të kurrikulës. Në pyetjen “Kurrikula aktuale me të cilën punoni ju, është më e përshtatshme: a) vetëm për ndonjë lëndë, b) për të gjitha lëndët, dhe c) për asnjë lëndë”, 67 përqind e respondentëve kanë deklaruar se kurrikula është e përshtatshme për të gjitha lëndët; 30 përqind vetëm për ndonjë lëndë dhe vetëm 3 përqind kanë deklaruar se kurrikula nuk është e përshtatshme për asnjë lëndë (*Grafikoni 22*).



**Grafikoni 22.** Lloji i lëndës dhe përshtatshmëria e kurrikulës

Ka edhe respondentë të cilët besojnë se kurrikula më shumë i humb kohë teknikisht mësimdhënësve, sesa i shton cilësinë e performancës së tyre në klasë. Lidhur me këtë, kemi bërë edhe një pyetje: “Kurrikula më shumë i humb kohë teknikisht mësimdhënësve, sesa shton cilësinë e performancës së tyre në klasë. Sa pajtoheni me këtë?”

Shumica dërmuese e respondentëve, 47 përqind prej tyre, kanë pohuar se mesatarisht pajtohen me këtë; 27 përqind prej tyre janë pajtuar pak, 23 përqind nuk janë pajtuar aspak, dhe vetëm 3 përqind e tyre janë pajtuar shumë (*Grafikoni 23*).




**Grafikoni 23.** *Qëndrimet e mësimdhënësve rreth shpenzimit të kohës në përgatitjen teknike për kurrikulë*

### 3.2.7. Efekti i përvojës në arsim si sfidë për pranimin e kurrikulës së re

Sipas hipotezës sonë, ka gjasa që mësimitdhënësit me përvojë më të gjatë në arsim, të jenë më konservatorë në pranimin e kurrikulës së re parauniversitare dhe më pak të tillë mund të jenë mësimitdhënësit me përvojë të re në arsim. Të dhënat rreth efektit të përvojës në arsim dhe shkallës së pranimin të kurrikulës së re, i kemi ndarë në tri grupe: 1) përvojë në arsim prej 1-5 vjet; 2) përvojë 5-10 vjet, dhe 3) përvojë mbi 10 vjet. Ndërsa në pyetjen e mëposhtme, kemi bërë këtë formulim: “Kurrikula e re është sfidë vetëm për:”, duke radhitur këto alternativa: a) Mësimitdhënësit me përvojë të re në arsim; b) Mësimitdhënësit me përvojë as të shkurtër dhe as të gjatë; c) Mësimitdhënësit me përvojë të gjatë në arsim; d) Për të gjithë mësimitdhënësit, pavarësisht shkallës së përvojës në arsim; dhe e) Për asnjë mësimitdhënës, pavarësisht shkallës së përvojës në arsim.

Shumica dërmuese, 30 përqind e tyre, kanë përzgjedhur opcionin c), 27 përqind mësimitdhënësit me përvojë të re në arsim; 23 përqind opcionin d), 17 përqind opcionin b), dhe vetëm 3 përqind kanë pohuar “për asnjë mësimitdhënës, pavarësisht shkallës së përvojës në arsim” (Grafikoni 24).



**Grafikoni 24.** Efektet e përvojës në arsim si sfidë në pranimin e kurrikulës së re


### 3.2.8. Përshtatshmëria e kurrikulës dhe metoda e punës në grupe

Në pyetjen e 11-të, kemi kërkuar nga respondentët të pohojnë se sa është më praktike kurrikula aktuale, me punën individuale, punën në çifte dhe punën në grupe të nxënësve. Shumica janë deklaruar se është më praktike për punën grupore të nxënësve në klasë. 40 përqind e respondentëve kanë deklaruar se kurrikula aktuale është më praktike me punën grupore të nxënësve në klasë; 27 përqind e tyre kanë thënë se kurrikula aktuale është më praktike për punën në çifte të nxënësve në klasë; 23 përqind e tyre për punën individuale të nxënësve në klasë, dhe vetëm 10 përqind e tyre, kanë deklaruar se, nuk varet fare kurrikula për metodat e punës me nxënësit (*Grafikoni 25*).



**Grafikoni 25.** Përshtatshmëria e kurrikulës dhe puna me nxënësit

### 3.2.9. Vlerësimi i nxënësve sipas kurrikulës




**Grafikoni 26. Kurrikula dhe kriteret për vlerësimin e nxënësve**

Kurrikula e re ka ndryshuar edhe sistemin e vlerësimit të nxënësve. Me kurrikulën e re, vlerësimi dhe nota e parë në periodën e parë, ka rëndësi 60 përqind, ndërsa në periodën e dytë, 40 përqind. Esenca e kurrikulës së re është të ketë edhe vlerësim sistematik të nxënësve me shumë instrumente të vlerësimit. Ne kemi parashtruar një pyetje gjatë hulumtimit në shkollat e komunës së Prishtinës: “Sa jeni të kënaqur me përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e nxënësve me kurrikulën që punoni?” Shumica dërmuese e respondentëve, 67 përqind prej tyre, kanë qenë të kënaqur mesatarisht; 20 përqind pak, 10 përqind aspak, dhe vetëm 3 përqind shumë (*Grafikoni 26*).

Duke dashur të krahasojmë vlerësimin sipas kurrikulës së re dhe të vjetër, ne kemi parashtruar edhe një pyetje tjetër në pyetësorin hulumtues: “Cili vlerësim ka qenë më i drejtë sipas jush?” Ne kemi dhënë këto opsione: a) Vlerësimi i nxënësve me kurrikulën e mëhershme; b) Vlerësimi i nxënësve me kurrikulën e re; dhe c) Me asnjë kurrikulë, vlerësimi nuk është i drejtë, por varet prej mësimdhënësve. 63 përqind e respondentëve kanë thënë se vlerësimi me kurrikulën e re është më i drejtë; 30 përqind me kurrikulën e vjetër, dhe 7


përqind kanë deklaruar se, “me asnjërën kurrikulë, vlerësimi nuk është i drejtë, por varet prej mësimdhënësve” (Grafikoni 27).



**Grafikoni 27.** Vlerësimi me kurrikulën e vjetër dhe të re

### 3.2.10. Tekstet shkollore-mësimore në zbatimin efikas të kurrikulës së re

Në pyetjen “Si i vlerësoni tekstet shkollore-mësimore për zbatimin efikas të kurrikulës së re?”, respondentët po ashtu janë të ndarë në qëndrime të ndryshme. Shumica prej tyre, 63 përqind kanë deklaruar se tekstet shkollore-mësimore janë mesatarisht të përshtatshme në zbatimin efikas të kurrikulës së re; 17 përqind pak të përshtatshme, 13 përqind aspak të përshtatshme dhe vetëm 7 përqind shumë të përshtatshme (*Grafikoni 28*).




**Grafikoni 28.** *Tekstet shkollore-mësimore dhe zbatimi efikas i kurrikulës së re*

### 3.2.11. Mjedisi kosovar dhe modelet kurrikulare evropiane

“Sa mendoni se i kemi kushtet e volitshme në shkollat tona, për të zbatuar modele kurrikulare evropiane?” - ka qenë pyetja e fundit në pyetësor.

Shumica, përkatësisht, 90 përqind e respondentëve kanë deklaruar se në Kosovë janë kushtet mesatarisht për të zbatuar modele kurrikulare evropiane; 4 përqind kanë pohuar se nuk janë aspak kushtet në shkollat tona për të zbatuar modele evropiane; 3 përqind shumë dhe 3 përqind pak.




**Shtylla grafike 1.** Qëndrimet rreth kushteve kosovare për zbatim të kurrikulave evropiane



### 3.2. Qëndrimet e mësimdhënësve në shkollat e nivelit klasor VI-IX ndaj ndryshimit të kurrikulave

#### 3.3.8. Ndryshimi i kurrikulave


##### 3.3.8.1. Ndryshimi i shpeshtë i kurrikulës



**Grafikoni 29.** Pasqyrë e përgjithshme e qëndrimeve të mësimdhënësve ndaj ndryshimeve të shpeshta të kurrikulave


Sikurse tregon *Grafikonime numër rendor 29*, 43 përqind e respondentëve kanë deklaruar se pajtohen shumë se nuk duan të ndryshon aq shpesh kurrikula, 20 përqind nuk janë pajtuar me këtë konstatim konservator ndaj ndryshimeve kurrikulare; 17 përqind janë pajtuar relativisht, 13 përqind nuk janë pajtuar aspak dhe vetëm 7 përqind kanë pasur qëndrime neutrale ndaj ndryshimeve të shpeshta të kurrikulave. Nga të dhënat e respondentëve tanë tregohet se, ka laramani në qëndrimet e mësimdhënësve ndaj ndryshimeve të shpeshta të kurrikulës parauniversitare, por shumica dërmuese e tyre, kanë pasur një qëndrim më konservator dhe më rezistent ndaj ndryshimeve kurrikulare (43 përqind kanë zgjedhur opcionin “Pajtohen shumë”, ndërsa vetëm 13 përqind kanë shprehur mospajtim ekstrem me opcionin “Nuk pajtohem aspak”). Analiza krahasuese e të dhënave gjatë prezantimit të të gjitha rezultateve, do të na tregon se kush janë më konservatorë ndaj ndryshimeve

kurrikulare, cilat kategori dhe profile të mësimdhënësve; sa varet rezistenca ndaj kurrikulave të reja edhe nga përvoja në arsimin parauniversitar, e tjerë e tjerë.




**Grafikoni 30.** Qëndrimet e mësimdhënësve për ndryshimin e vazhdueshëm të kurrikulave

Në konstatimin se “Unë dua të ndryshon vazhdimisht kurrikula”, kemi pasur qëllim të kuptonim shkallën e përputhjes për çështjen e njëjtë. Përgjigjet e respondentëve sikur tregojnë *Grafikoni 30*, dëshmojnë për një qëndrueshmëri të qëndrimeve të respondentëve në këtë hulumtim dhe mungesë të disonancës. Në konstatimin e parë, shkalla e mospajtimit ekstrem për ndryshimet e kurrikulave, pamë se ishte shumicë dërmuese, 43 përqind e tyre, ishin deklaruar se “pajtohen shumë”, se nuk duan që kurrikula të ndryshon aq shpesh. Ndërsa në *Grafikonin 30*, shohim se respondentët shumicë, 47 përqind e tyre, nuk pajtohen se kurrikula të ndryshon vazhdimisht, 37 përqind nuk pajtohen aspak, 10 përqind neutralë, dhe vetëm nga 3 përqind e respondentëve, kanë përzgjedhur alternativën “Pajtohem shumë” (shkalla absolute) dhe “Pajtohem” (shkalla relative). Kjo tregon se qëndrimet e mësimdhënësve ndaj ndryshimit të kurrikulave janë më konservatore dhe nuk duan të ndryshojnë aq shpesh kurrikulat. Prandaj, për të pasur një qëndrim më pozitiv ndaj vetë kurrikulave, duhet të ketë më shumë debat me mësimdhënësit, pse nuk duan të ndryshojnë aq shpesh kurrikulat dhe në bazë të përgjigjeve të tyre, të ketë qasje tjetër ndaj kurrikulave dhe zbatimit të tyre.



**Grafikoni 31.** *Ndryshimi i kurrikulave në përputhje me rrethanat dhe mundësitë në Kosovë*


Përgjigjet e respondentëve (*Grafikoni 31*) rreth shkallës së pajtimit apo mospajtimit të ndryshimit të kurrikulave në përputhje me rrethanat dhe mundësitë në Kosovë, tregojnë se, shumica dërmuese e mësimitdhënësve, kanë bindjen se kurrikulat në Kosovë, nuk përputhen me rrethanat dhe mundësitë në vend. 50 përqind e respondentëve kanë deklaruar se pajtohen shumë, se duan të ndryshon kurrikula në përputhje me rrethanat dhe mundësitë në Kosovë, 47 përqind po ashtu janë pajtuar relativisht për këtë konstatim dhe vetëm 3 përqind e respondentëve nuk janë pajtuar aspak, duke lënë të kuptojmë se, ndryshimi i kurrikulave duhet të bëhet, pavarësisht rrethanave dhe mundësive në Kosovë.



**Grafikoni 32.** Qëndrimet ndaj modelit kurrikular të Shqipërisë si model për kurrikulën në Kosovë

Ne kemi hulumtuar qëndrimet e mësimitdhënësve rreth modeleve të huaja apo jashtë Kosovës, që duan të marrin për kurrikulat brenda vendit tonë. Një nga to, ka qenë edhe modeli i kurrikulës parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. Se a pajtohen mësimitdhënësit kosovarë prej klasës VI-IX rreth marrjes së modelit të kurrikulës së Shqipërisë si model kurrikular për Kosovën, kemi gjetur këto rezultate: 33 përqind e respondentëve janë pajtuar që modeli i kurrikulës kosovare të jetë kurrikula e Shqipërisë; 23 përqind nuk janë pajtuar aspak; 20 përqind e tyre nuk janë pajtuar; 17 përqind e tyre janë pajtuar shumë, dhe vetëm 7 përqind e tyre kanë pasur qëndrim neutral apo asnjës. Pra, mësimitdhënësit nuk kanë një qëndrim homogjen dhe uniform edhe këtu, pasi që opinionet dhe qëndrimet e tyre janë mjaft të ndara rreth kësaj çështjeje. Madje, nëse mbledhim 23 përqind që nuk janë pajtuar aspak (maksimalisht) dhe 20 përqind po ashtu nuk janë pajtuar relativisht, i bie se gjithsej, 43 përqind e tyre nuk janë pajtuar. Ndërsa, nëse i mbledhim përqindjet e respondentëve, të cilët nuk janë pajtuar që modeli i kurrikulës së Shqipërisë të jetë model për kurrikulën në Kosovë, 33 përqind janë pajtuar relativisht, ndërsa 17 përqind e tyre janë pajtuar shumë, gjithsej, 50 përqind e tyre (*Grafikoni 32*). Pra, nuk ka dallim të rëndësishëm në përqindje, të atyre që nuk janë pajtuar dhe atyre që janë pajtuar që modeli i kurrikulës kosovare të jetë kurrikula e Shqipërisë, ndonëse mbizotëron lehtësisht, qëndrimi më pajtues. Qëndrimet e mësimitdhënësve ndaj kurrikulës së Shqipërisë, sikurse shihet në *Grafikonin 32*,


është edhe pajtues, edhe mospajtues, duke mos qenë qëndrim unik, por i ndarë në dy gjysma gati se të barabarta, me mbizotërim për 7 përqind, të atyre që pajtohen.



**Grafikoni 33.** *Qëndrimet e mësimit ndaj kurrikulës së shteteve skandinave*

Duke parë se shpesh zyrtarët e arsimit e të politikës në Kosovë e përmendin modelin skandinav për kurrikulë dhe duke pasur qëllim që të hedhim një model evropian e skandinav, në vendet ku ka lajme të vazhdueshme për jetë cilësore, standard të lartë të jetesës, shkolla cilësore, ne kemi vënë përballë mësimit ndaj kurrikulës së shteteve skandinave, duke cituar edhe disa vende si: Suedia, Danimarka, Norvegjia. Sikurse tregon *Grafikoni 33*, shumica dërmuese e respondentëve, përkatësisht, 34 përqind e tyre, nuk janë pajtuar që kurrikula kosovare të ndryshon në përputhje me shtetet skandinave; 23 përqind nuk janë pajtuar aspak; 23 përqind janë pajtuar shumë; 13 përqind janë pajtuar dhe vetëm 7 përqind kanë qëndruar neutralë. Gjatë zbatimit të pyetësorëve, në diskutim me mësimit ndaj kurrikulës, na ka rënë të kuptojmë arsyet pse kanë këtë qëndrim. Një arsye kryesore është ajo që përputhet edhe me qëndrimet e mësimit ndaj kurrikulës rreth përputhjes së kurrikulës me rrethanat dhe mundësitë në Kosovë. Shumica prej 34 përqindësh të respondentëve, deklarojnë se nuk duan të ndryshon kurrikula kosovare në përputhje me shtetet si Suedia, Norvegjia e Danimarka, për shkak se konsideruakan që, këto shtete, janë pakrahasueshëm më mirë në ekonomi, arsim, politikë, e tjerë e tjerë, prandaj nuk duan që të marrim modelin kurrikular evropian e skandinav, por të jetë më afër me vendet e rajonit apo rrethanat dhe mundësitë në Kosovë. Arsyetja e dytë e këtij qëndrimi të mësimit ndaj kurrikulës, varet edhe nga qëndrimet ndaj mentalitetit


kosovar dhe skandinav. Sipas shumicës së mësimitdhënësve, me të cilët kemi zbatuar pyetësorin, kemi kuptuar se, besuakan se mentaliteti kulturor dhe arsimor kosovar, dallon prej atij skandinav. Prandaj, shumica syresh menduan se modeli kurrikular të mos jetë ‘evropian’ e ‘skandinav’, ndërsa kushtet të jenë të nivelit kosovar. Duke besuar se infrastruktura teknike dhe profesionale në Kosovë, rrethanat ekonomike, politike dhe kulturore në vendin tonë, nuk janë në përputhje të afërt me vendet skandinave, kjo ka ndikuar që mësimitdhënësit të kenë dyshime dhe qëndrime të ndara rreth modelit të përshtatshëm evropian e kurrikular, për modelin e kurrikulës në shkollat parauniversitare në Kosovë. Mësimitdhënësit kanë qëndrim të ndarë rreth asaj se a duhet të jetë modeli i kurrikulës nga vendet shumë të zhvilluara evropiane, nga Shqipëria e rajoni, apo të jetë një kurrikulë mbarëkombëtare, për të gjitha shkollat shqipe, kudo që jetojnë dhe veprojnë nxënësit e mësimitdhënësit shqiptarë. Për këtë arsye, ne kemi parashtruar edhe një pyetje, e cila mund të na jep të dhëna rreth shkallës së qëndrimit nacionalist me modelin evropian apo nacional të kurrikulës në Kosovë. Ne kemi parashtruar dilemën e shkallës së pajtimit dhe mospajtimit për një kurrikulë mbarëkombëtare e shqiptare, për të gjitha shkollat ku mësojnë shqiptarët.



**Grafikoni 34.** *Qëndrimet e mësimitdhënësve ndaj një kurrikule mbarëkombëtare shqiptare*

Në *Grafikonin 34*, 47 përqind janë pajtuar për një kurrikulë mbarëkombëtare, ku do të ishte e njëjtë për të gjitha shkollat shqipe kudo që janë; 17 përqind janë pajtuar shumë; 13 përqind nuk janë pajtuar aspak; 13 përqind nuk janë pajtuar, dhe vetëm 10 përqind kanë mbajtur qëndrim neutral. Vlerësuar në tërësi, shumica dërmuese e atyre që janë pajtuar maksimalisht dhe atyre që janë pajtuar relativisht, gjithsej 64 përqind janë pajtuar për një

kurrikulë mbarëkombëtare shqiptare, ndërsa ka pasur edhe me qëndrime mospajtuese maksimale, 13 përqind prej respondentëve, dhe 13 përqind të tjerë me mospajtim relativ, duke bërë gjithsej, 26 përqind me opinion pajtues në përgjithësi. Pra, edhe një pjesë e konsiderueshme e mësimitdhënësve kosovarë në komunën e Prishtinës, janë të mendimit se, nuk duhet të ketë një kurrikulë mbarëkombëtare shqiptare për të gjitha shkollat shqipe, pavarësisht territorit ku janë ato. Në këtë qëndrim ndaj kurrikulës mbarëkombëtare, ndikim të madh ka edhe qëndrimi politik mbi politikën, identitetin dhe nacionalizmin shqiptar. Por kjo do të zgjerohej si hipotezë, prandaj, nuk do të zgjerohemi më tej në këtë çështje.



**Grafikoni 35.** Qëndrimet ndaj kurrikulës së vjetër dhe të re


Për shkak të ndryshimit të kurrikulës parauniversitare në Republikën e Kosovës para pak kohësh, ne kemi parashtruar një pyetje në pyetësor, rreth qëndrimeve të mësimitdhënësve ndaj kurrikulës së vjetër dhe të re, për të kuptuar se sa mendojnë që kurrikulat e vjetra janë më të përshtatshme se kurrikulat e reja, apo anasjelltas.

46 përqind e respondentëve kanë deklaruar se pajtohen që kurrikulat e vjetra janë më të përshtatshme sesa kurrikulat e reja; 27 përqind e tyre, madje pajtohen shumë, se kurrikulat e vjetra janë më të përshtatshme se kurrikulat e reja; 17 përqind e tyre nuk pajtohen se kurrikulat e vjetra janë më të përshtatshme se kurrikulat e reja; 7 përqind e tyre kanë qëndrim neutral, ndërsa vetëm 3 përqind e tyre nuk pajtohen aspak (shih *Grafikonin 35*).

*Grafikoni 35* tregon se shumica dërmuese e mësimitdhënësve prej klasës VI-IX, kanë qëndrim më pozitiv ndaj kurrikulave të vjetra, pasi i konsiderojnë ato më të përshtatshme se kurrikulat e reja. Nëse i bëjmë bashkë, respondentët që janë pajtuar maksimalisht dhe respondentët që janë pajtuar relativisht, i bie se 73 përqind e tyre, kanë këtë qëndrim më përkrahës për kurrikulat e vjetra, pasi i konsiderojnë ato më të përshtatshme se kurrikulat e reja.

Kjo varet nga shumë faktorë: akoma nuk ka filluar zbatimi i kurrikulës së re në të gjitha nivelet klasore; akoma nuk janë kryer të gjitha trajnimet për mësimitdhënësit e të gjitha niveleve klasore, me trajnimet për kurrikulën e re; akoma është periudhë më e shkurtër e zbatimit të kurrikulës së re krahasuar me përvojën më të madhe të mësimitdhënësve me kurrikulën e vjetër etj. Por ka edhe arsye të vetë natyrës së kurrikulës së re, e cila siç do të mësojmë nga përgjigjet në pyetjet e tjera të respondentëve, kërkon më shumë kohë dhe përkushtim teknik-profesional, për ta zbatuar atë, krahasuar me kohën më të shkurtër të investimit, për zbatimin e kurrikulës së vjetër, për shkak të rritjes së instrumenteve të vlerësimit sistematik të nxënësve, me kurrikulën e re parauniversitare.

### 3.3.9. Efekti i numrit të nxënësve dhe kohëzgjatjes së orës mësimore në zbatimin e kurrikulës së re






### **Grafikoni 36.***Efektet e numrit të nxënësve në zbatimin e kurrikulës*

Se numri i nxënësve për çdo klasë ndikon në zbatimin e kurrikulës, e theksojnë edhe një numër i konsiderueshëm i respondentëve. Në *Grafikonin 36*, vërejmë se, 46 përqind e respondentëve janë pajtuar se kurrikula nuk mund të zbatohet nëse në klasë ka mbi 15 nxënës; 27 përqind e tyre janë pajtuar shumë; 10 përqind nuk janë pajtuar aspak; 10 përqind me qëndrim neutral, dhe 7 nuk janë pajtuar (*Grafikoni 36*).


Këto të dhëna tregojnë se, shumica e respondentëve, duke mbledhur respondentët me qëndrim mospajtuës maksimal dhe minimal, 73 përqind e respondentëve besojnë se kurrikula nuk mund të zbatohet në rast se ka në klasë më shumë se 15 nxënës. Shumica dërmuese pajtohen me efektin e nxënësve në zbatimin e kurrikulës, por ka edhe nga respondentët, të cilët nuk e shohin efektin e nxënësve në zbatimin e kurrikulës, pavarësisht se numri i këtyre të fundit, është pakrahasueshëm më i vogël, me numrin mbizotërues të atyre që pajtohen.




### **Grafikoni 37:***Qëndrimet e mësimitdhënësve të klasës VI-IX për efektet e orës së shkurtër mësimore në zbatimin e kurrikulës*

Në pyetjen se “Kurrikula nuk mund të zbatohet me orën aktuale e të shkurtër mësimore”, qëndrimet e mësimitdhënësve të klasës prej VI-IX, janë si në vijim: 40 përqind e tyre janë pajtuar relativisht, 30 përqind janë pajtuar shumë, 17 përqind nuk janë pajtuar aspak, 10 përqind nuk janë pajtuar relativisht, dhe vetëm 3 përqind kanë mbajtur qëndrimin neutral (*Grafikoni 37*). Kurse sa i përket vazhdimin të orës mësimore prej 45 minutash në 60

minuta, edhe qëndrimet e mësimeve të klasës VI-IX, janë të shumëllojshme. Në grafikun e mëposhtëm 38, gjejmë se 33 përqind e respondentëve, nuk janë pajtuar relativisht për zgjatjen e orës mësimore deri në 60 minuta, për ta zbatuar me efikasitet kurrikulën; 20 përqind janë pajtuar relativisht, 20 përqind janë pajtuar shumë, 20 përqind nuk janë pajtuar aspak dhe 7 përqind me qëndrim neutral. Ndërsa rreth pengesave që mund të vijnë nga numri aktual i nxënësve dhe ora e shkurtër mësimore për zbatimin e kurrikulave, edhe këtu ka qëndrime të ndryshme. 43 përqind e respondentëve janë pajtuar shumë, se këto janë pengesa për zbatimin kurrikular; 40 përqind janë pajtuar lehtësisht; 10 përqind nuk janë pajtuar relativisht dhe 7 përqind nuk janë pajtuar aspak se numri i nxënësve dhe ora aktuale mësimore është pengesë në zbatimin e kurrikulës (Grafikoni 39).



**Grafikoni 38.** Qëndrimet e mësimeve të klasës VI-IX rreth zgjatjes së orës mësimore në 60 minuta




**Grafikoni 39.** Qëndrimet e mësimitdhënësve rreth efektit të numrit të nxënësve dhe orës mësimore për pengesa në zbatimin e kurrikulës

### 3.3.10. Numri i mësimitdhënësve dhe zbatimi i kurrikulës

Sa i përket numrit të mësimitdhënësve dhe zbatimit të kurrikulës, qëndrimet e mësimitdhënësve të klasës prej VI-IX janë të ndryshme. 34 përqind e respondentëve kanë deklaruar se pajtohen shumë se, “kurrikula nuk mund të zbatohet pa rritur numrin e mësimitdhënësve”, 30 përqind e tyre nuk pajtohen relativisht me këtë; 20 përqind pajtohen relativisht, 13 përqind nuk pajtohen shumë, dhe 3 përqind kanë mbajtur qëndrimin e tyre neutral (*Grafikoni 40*).


Rritja e numrit të mësimitdhënësve në zbatimin e kurrikulës, shihet në qëndrimet e mësimitdhënësve se ka efekt, por jo të gjithë mendojnë njësoj. 54 përqind e tyre pajtohen me këtë efekt, por edhe 43 përqind të tjerë nuk pajtohen, kurse 3 përqind nuk janë deklaruar për njërin apo për tjetrën.



**Grafikoni 40.** Rritja e numrit të mësimeve dhe zbatimi i kurrikulës

### 3.3.11. Qëndrimet ndaj kurrikulës së re dhe të vjetër


Qëndrimet e mësimeve të klasës prej VI-IX ndaj kurrikulës së re janë të ndryshme. 40 përqind e tyre në konstatimin “Unë jam shumë i-e kënaqur me kurrikulën e re”, nuk janë pajtuar relativisht; 27 përqind e tyre nuk janë pajtuar aspak; 17 përqind e tyre janë pajtuar relativisht, 16 përqind e tyre janë pajtuar shumë dhe askush nuk ka mbajtur qëndrim neutral (*Grafikoni 41*).



**Grafikoni 41.** Qëndrimet e mësimitdhënësve të klasës VI-IX ndaj kurrikulës së re

Ndërsa sa i përket qëndrimeve ndaj kurrikulës së vjetër, edhe ato janë të shumëllojshme. 30 përqind e respondentëve janë pajtuar shumë se, “Unë jam shumë i-e kënaqur me kurrikulën e vjetër”; 30 përqind e tyre nuk janë pajtuar relativisht; 20 përqind e tyre janë pajtuar relativisht, 10 përqind nuk janë pajtuar aspak dhe 10 përqind e tyre kanë mbajtur qëndrim neutral (*Grafikoni 42*).

Unë jam shumë i-e kënaqur me kurrikulën e vjetër.



**Grafikoni 42.** Qëndrimet e mësimeve të klasës VI-IX ndaj kurrikulës së vjetër

### 3.3.12. Efekti i ndryshimit paraprak të teksteve mësimore para ndryshimit të kurrikulës




**Grafikoni 43.** Qëndrimet ndaj ndryshimit paraprak të teksteve mësimore dhe ndryshimit të mëvonshëm të kurrikulës

Grafikoni 43 tregon se, respondentët janë të ndarë në dy qëndrime rreth domosdoshmërisë së ndryshimit paraprak të teksteve shkollore-mësimore, para se të ndryshohet kurrikula e arsimit parauniversitar. 54 përqind janë pajtuar shumë me këtë deklaram, ndërsa 47 përqind janë pajtuar minimalisht.

### 3.3.13. Trajnimi i mësimdhënësve për kurrikulën e re

Ndikimi i trajnimit për kurrikulë ka ndikim në zbatimin e kurrikulës. Mësimdhënësit e klasës VI-IX kanë qëndrime të ndara rreth këtij ndikimi. Në konstatimin se “Zbatimi i kurrikulës varet kryesisht prej shkallës dhe cilësisë së trajnimit të mësimdhënësve për këtë kurrikulë”, 34 përqind e respondentëve janë pajtuar shumë, 33 përqind janë pajtuar relativisht, 13 përqind e tyre nuk janë pajtuar aspak, 13 përqind kanë përzgjedhur qëndrim neutral, dhe vetëm 7 përqind nuk janë pajtuar relativisht (*Grafikoni 44*).




**Grafikoni 44.** *Qëndrimet ndaj trajnimit të mësimdhënësve për kurrikulë dhe zbatimin të kurrikulës*

Sa i përket qëndrimit ndaj trajnerëve për kurrikulë të re, qëndrimet po ashtu janë të larmishme. 36 përqind e respondentëve janë pajtuar relativisht se, “Trajnimi i mësimdhënësve për kurrikulë të re, bëhet nga trajnerë profesionistë”; 27 përqind janë pajtuar shumë; 17 përqind kanë pasur qëndrim neutral, 13 përqind nuk janë pajtuar relativisht dhe vetëm 7 përqind nuk janë pajtuar aspak (*Grafikoni 45*).




Trajnimi i mësimdhënësve për kurrikulë të re bëhet nga trajnerë profesionistë.



**Grafikoni 45.** Qëndrimet ndaj trajnerëve për kurrikula

Trajnimet janë të shkurtëra, prandaj janë joefikase.



**Grafikoni 46.** Qëndrimet ndaj kohëzgjatjes së trajnimeve për kurrikulë

Me qëndrimin “Se trajnimet janë të shkurtëra, prandaj janë joefikase”, 40 përqind e respondentëve janë pajtuar relativisht, 30 përqind janë pajtuar shumë, 13 përqind nuk janë pajtuar relativisht, 10 përqind me qëndrim neutral, dhe 7 përqind nuk janë pajtuar aspak (Grafikoni 46).

### 3.3.14. Sfidat e zbatimit të kurrikulës

Shumica e mësimeve të klasës prej VI-IX nuk janë përgjigjur në pyetjen e hapur rreth numërimit të sfidave për zbatimin e kurrikulës, por ato që janë përmendur nga disa mësime, janë gati se të ngjashme edhe me sfidat e numëruara nga mësime të klasës I-V (Tabela 6).

<b>SFIDAT MË TË MËDHA NË ZBATIMIN E KURRIKULËS</b>
Mungesa e mjeteve të konkretizimit
Mungesa e teknologjisë
Mospërputhja e teksteve me kurrikulën e re
Tekstet joadekuate mësimore-shkollore në përgjithësi
Ora e shkurtër mësimore
Mungesa e trajnimeve nga trajnerë profesionistë
Motivimi i ulët kur ndryshon kurrikula
Rezistenca ndaj kurrikulës së re
Mospërshtatja e kurrikulës nga modelet evropiane me kushtet dhe rrethanat kosovare
Cilësia e dobët e mësimeve

Tabela 6. Sfidat më të mëdha në zbatimin e kurrikulës sipas mësimeve të klasës VI-IX

3.3.15. Shpenzimet në kohë për zbatimin e kurrikulës para mbajtjes së orës mësimore




**Grafikoni 47.** Koha e shpenzuar para mbajtjes së orës mësimore dhe zbatimi i kurrikulës

Në pyetjen “Ju konsideroni se shpenzoni kohë për zbatimin e kurrikulës para mbajtjes së një ore mësimore”, shumica e respondentëve, 47 përqind e tyre, kanë deklaruar se shpenzojnë mbi 4 orë në ditë; 36 përqind e tyre 2-4 orë në ditë; 17 përqind e tyre 1-2 orë në ditë (Grafikoni 47).

### 3.3.16. Ndikimi i kurrikulës në cilësinë e mësimdhënies

Në pyetjen “Sa mendoni se ndikon vetë lloji i kurrikulës në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në përgjithësi?”, shumica e respondentëve, 34 përqind e tyre, kanë deklaruar se nuk ndikon aspak; 33 përqind se ndikon mesatarisht; 23 përqind se ndikon pak dhe 10 përqind se ndikon shumë (*Grafikoni 48*).



**Grafikoni 48.** Qëndrimet mbi ndikimin e vetë kurrikulës në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies

### 3.3.17. Ndikimi i përvojës në arsim në pranimin e kurrikulave të reja

Përvoja në arsim është pranuar nga të gjithë mësuesit e nivelit parauniversitar, se ndikon në pranimin apo refuzimin e kurrikulave të reja, qofshin të nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Por qëndrimet e mësuesve të klasës I-V dhe prej VI-IX, po ashtu janë të ndara rreth ndikimit të përvojës së gjatë në arsim në pranimin e kurrikulave të reja.




**Grafikoni 49.** Ndikimi i përvojës në arsim në pranimin e kurrikulave të reja

Në pyetjen “Mësuesit me përvojë të gjatë në arsim janë më konservatorë në pranimin e kurrikulave të reja, sesa mësuesit me përvojë të re.” Sa pajtoheni me këtë opinion?”, shumica e respondentëve, 45 përqind e tyre kanë thënë pak, 45 përqind kanë thënë aspak, 6 përqind mesatarisht dhe vetëm 4 përqind kanë thënë shumë (Grafikoni 49).

Lidhur me kurrikulën e re se a është sfidë më e madhe për mësuesit me përvojë të re, të mesme dhe të gjatë, kemi parashtruar edhe një pyetje tjetër. “Kurríkula e re është sfidë vetëm për”, duke i radhitur opsionet: a) Mësuesit me përvojë të re në arsim; b) Mësuesit me përvojë as të shkurtër dhe as të gjatë; c) Mësuesit me përvojë të gjatë në arsim; d) Për të gjithë mësuesit, pavarësisht shkallës së përvojës në arsim; e) Për asnjë mësues, pavarësisht shkallës së përvojës në arsim.


Shumica e respondentëve, 77 përqind e tyre, kanë deklaruar se kurrikula e re është sfidë për të gjithë mësimdhënësit, pavarësisht shkallës së përvojës në arsim; 13 përqind e tyre për mësimdhënësit me përvojë as të shkurtër dhe as të gjatë; 10 përqind për mësimdhënësit me përvojë të re në arsim dhe askush nuk ka deklaruar se kurrikula e re është sfidë për mësimdhënësit me përvojë të gjatë në arsim dhe askush nuk ka pohuar “për asnjë mësimdhënë, pavarësisht shkallës së përvojës në arsim” (Grafikoni 50).



**Grafikoni 50.** Qëndrimet rreth sfidave për kurrikulën e re dhe lidhjes me përvojën në arsim

### 3.3.18. Faktorët e tjerë në zbatimin e kurrikulës


Kemi pyetur edhe mësime dhënësit e nivelit të mesëm të ulët (klasa VI-IX) se, cilët janë disa faktorë të tjerë në zbatimin e kurrikulës dhe respondentët me përgjigjet e tyre, janë ndarë kryesisht në dy faktorë. Gjersa shumica dërmuese e tyre kanë thënë se zbatimi i kurrikulës varet më së shumti nga mjetet e konkretizimit në dispozicion, 36 përqind e tyre kanë deklaruar se cilësia e mësime dhënëse është faktori më i rëndësishëm që ndikon në zbatimin e kurrikulës. Në opcionet e dhëna për respondentët, kanë qenë këta faktorë: a) Cilësia e mësime dhënëse; b) Mjetet e konkretizimit në dispozicion; c) Numri i nxënësve; d) Mënyra e menaxhimit të përgjithshëm të shkollës; e) Shkalla më e madhe e monitorimit nga inspektorët e arsimit; f) Ndryshimi i teksteve mësimore-shkollore (*Grafikoni 51*).



**Grafikoni 51.** Ndikimi i faktorëve të tjerë në zbatimin e kurrikulës

### 3.3.19. Lloji i lëndës dhe përshtatshmëria e kurrikulës

Se për cilat lëndë apo për të gjitha lëndët, është më e përshtatshme kurrikula aktuale, përgjigjet kanë qenë të ndryshme. Shumica e respondentëve, 70 përqind e tyre, kanë thënë se kurrikula është më e përshtatshme për të gjitha lëndët, 30 përqind e tyre kanë pohuar se është më e përshtatshme vetëm për ndonjë lëndë dhe asnjëri nuk ka deklaruar se nuk është e përshtatshme për asnjë lëndë (*Grafikoni 52*).



**Grafikoni 52.** Lloji i lëndës dhe përshtatshmëria e kurrikulës



### 3.3.20. Koha e shpenzuar për përgaditjen e mësimeve në zbatimin e kurrikulës

Në pyetjen “Kurrikula më shumë i humb kohë teknikisht mësimeve, sesa shton cilësinë e performancës së tyre në klasë. Sa pajtoheni me këtë?”, shumica e respondentëve kanë qëndrime të ndryshme. 33 përqind kanë thënë se pajtohen pak, 30 përqind pajtohen shumë, 30 përqind pajtohen mesatarisht dhe vetëm 7 përqind nuk pajtohen aspak (Grafikoni 53).



**Grafikoni 53.** Koha e shpenzuar në kurrikulën e re

### 3.3.21. Përshatshmëria e kurrikulës dhe puna me nxënësit

Se a është kurrikula aktuale më praktike për punën individuale, në çifte, punën grupore, kemi parashtruar këtë deklaram për respondentët: “Kurrikula aktuale është më praktike për”, duke i dhënë këto alternativa: a) Punën individuale të nxënësve në klasë; b) Punën në çifte të nxënësve në klasë; c) Punën grupore të nxënësve në klasë dhe; d) Nuk varet fare kurrikula për metodat e punës me nxënësit (*Grafikoni 54*).

66 përqind e respondentëve kanë përmendur se, kurrikula aktuale është më praktike për punën grupore të nxënësve në klasë; 26 përqind punën në çifte; 8 përqind e respondentëve kanë theksuar se, nuk varet kurrikula për metodat e punës me nxënësit.



**Grafikoni 54.** Kurrikula dhe metodat e punës me nxënësit

### 3.3.22. Vlerësimi i nxënësve dhe kurrikula


Në pyetjen “Sa jeni të kënaqur me përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e nxënësve me kurrikulën që punoni?”, respondentët kanë dhënë përgjigje jo të njëjta. 53 përqind e respondentëve kanë thënë se janë të kënaqur pak, 20 përqind se janë të kënaqur mesatarisht, 17 përqind se nuk janë të kënaqur aspak dhe vetëm 10 përqind janë deklaruar se janë të kënaqur shumë (Grafikoni 55).



**Grafikoni 55.** Shkalla e kënaqshmërisë me kurrikulën për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e nxënësve

Ndërsa në pyetjen se cili vlerësim ka qenë më i drejtë për nxënësit, bazuar në kurrikulën e vjetër apo kurrikulën e re, edhe në këtë çështje, përgjigjet e respondentëve kanë qenë të dallueshme prej njëri-tjetrit. 43 përqind e respondentëve kanë thënë se, vlerësimi ka qenë më i drejtë sipas kurrikulës së vjetër; 37 përqind me kurrikulën e re; 20 përqind me asnjërën kurrikulë, sepse vlerësimi sipas tyre, varet më së shumti nga vetë mësimmësuesit (Grafikoni 56).

### 13. Cili vlerësim ka qenë më i drejtë sipas jush?




**Grafikoni 56.** *Vlerësimi me kurrikulë të vjetër dhe të re*

#### 3.3.23. Efektet e teksteve shkollorë-mësimore për zbatimin efikas të kurrikulës së re

Mësimdhënësit kanë dhënë përgjigje jo të ngjashme rreth efekteve të teksteve shkollorë-mësimore për zbatimin efikas të kurrikulës së re. Në pyetjen “Si i vlerësoni tekstet shkollorë-mësimore për zbatimin efikas të kurrikulës së re?”, shumica e respondentëve, 61 përqind e tyre, kanë thënë aspak të përshtatshme, 32 përqind e tyre, pak të përshtatshme; 4

përqind e tyre, shumë të përshtatshme, dhe vetëm 3 përqind e tyre kanë thënë mesatarisht të përshtatshme (Grafikoni 57).




**Grafikoni 57.** *Tekstet shkollë dhe efekti i tyre në zbatimin efikas të kurrikulës së re*

### 3.3.24. Infrastruktura shkollë dhe zbatimi i modeleve kurrikulare evropiane

Edhe rreth përputhjes apo mospërputhjes së kushteve në shkollat kosovare me zbatimin e modeleve kurrikulare evropiane, ka mendime të ndryshme nga respondentët-mësimdhënës. Shumica e respondentëve, në pyetjen “Sa mendoni se i kemi kushtet në shkollat tona, për zbatuar modele kurrikulare evropiane?”, përkatësisht 60 përqind prej tyre, kanë deklaruar “pak”, 30 përqind “aspak”, 10 përqind “mesatarisht” dhe askush nuk ka deklaruar “shumë” (Grafikoni 58).

15. Sa mendoni se i kemi kushtet në shkollat tona, për të zbatuar modele kurrikulare evropiane?




**Grafikoni 58.** Përputhja dhe mospërputhja e mjedisit kosovar me modelet kurrikulare evropiane

### 3.4. SHQYRTIMI I HIPOTEZAVE DHE REZULTATET E HULUMTIMIT

#### 3.4.1. Sa ka dallime në qëndrimet ndaj kurrikulës parauniversitare, varësisht nga përvoja e mësimeve në arsim?

Një nga pyetjet kryesore të hulumtimit ka qenë të kuptuarit e dallimeve në qëndrimet ndaj kurrikulës parauniversitare, varësisht nga përvoja e mësimeve në arsim. Nga *Grafikoni 59*, e vërejmë se shumica dërmuese e mësimeve me përvojë mbi 10 vjet në arsim, përkatësisht, 59 përqind e tyre, kanë deklaruar se “pajtohen shumë se kurrikula nuk duhet të ndryshon aq shpesh”, 30 përqind e atyre me përvojë prej 5-10 vjet në arsim, si dhe më së paku janë pajtuar me këtë pohim, mësimeve me përvojë të re, gjegjësisht nën 5 vjet përvojë në arsimin parauniversitar.


Nga *Grafikoni 59*, shihen dallime në qëndrime, varësisht prej përvojës së mësimeve në arsim. Ata dhe ato që kanë përvojë mbi 10 vjet në arsim, nuk duan të ndryshon aq shpesh kurrikula universitare, janë më konservatorë dhe më rezistencë ndaj kurrikulave të reja, ndërsa më së shumti që duan kurrikula të ndryshon shpesh, janë mësimeve me përvojë të re, nën 5 vjet përvojë në arsim.



**Grafikoni 59.** Dallimet në qëndrimet rreth ndryshimit të kurrikulës, varësisht nga përvojat e mësimeve në arsim

### 3.4.2. A janë mësime të mësuara me përvojë më të gjatë se 10 vjet në arsim, më konservatorë në raport me reformat në kurrikulën parauniversitare?

Në pyetjen tjetër ndihmëse se a janë mësime të mësuara me përvojë më të gjatë se 10 vjet në arsim, më konservatorë në raport me reformat në kurrikulën parauniversitare, po ashtu përgjigjet janë pohuese. 10 përqind e mësime të mësuara me përvojë mbi 10 vjet në arsim, kanë deklaruar se nuk pajtohen aspak se kurrikula nuk duhet të ndryshon aq shpesh; 20 përqind e mësime të mësuara me përvojë 5-10 vjet në arsim, kanë deklaruar të njëjtën gjë, ndërsa më së shumti me përgjigje të tillë, 70 përqind e respondentëve, përkatësisht 70 përqind e mësime të mësuara me përvojë të re nën 5 vjet në arsim. Edhe *Grafikoni 60* e konfirmon pranimin e pjesërishtë të hipotezës se, ka dallime në raport me reformën kurrikulare parauniversitare, varësisht nga përvoja në arsim. Mësime të mësuara me përvojë nën 5 vjet në arsim, nuk janë pajtuar aspak, duke shprehur qëndrim kategorik refuzues, nëse thuhet se kurrikula duhet të ndryshon aq shpesh. Pra, mësime të mësuara me përvojë të re, duan ndryshime kurrikulare shpesh, për dallim nga mësime të mësuara me përvojë mbi 10 vjet, që nuk duan ndryshime aq të shpeshta të kurrikulave parauniversitare.



**Grafikoni 60.** Shkalla e refuzimit dhe pranimit të kurrikulës së re varësisht nga përvoja në arsim



### 3.4.3. Sa ndikon negativisht numri i madh i nxënësve për klasë në qëndrimet negative të mësimit në Kosovë ndaj kurrikulës së re parauniversitare?


Hipotezë tjetër ka qenë se, ka gjasa që numri i nxënësve në klasë të ndikon në qëndrimet negative të mësimit në Kosovë ndaj kurrikulës së re parauniversitare. Shumica dërmuese e respondentëve, përkatësisht, 70 përqind e tyre, kanë thënë se ndikon shumë numri i madh i nxënësve në klasë në qëndrimet negative ndaj kurrikulës së re; 16 përqind se ndikon mesatarisht, 4 përqind se ndikon pak dhe vetëm 2 përqind nuk ndikon aspak. *Grafikoni 61* e konfirmon në masë të madhe hipotezën se, qëndrimet negative ndaj kurrikulës janë të varura edhe nga numri i madh i nxënësve në klasë.



**Grafikoni 61.** *Ndikimi i numrit të madh të nxënësve në klasë në qëndrimet negative ndaj kurrikulës së re*

#### 3.4.4. A kanë qëndrime më pozitive ndaj kurrikulës së re, mësimeve të shkollave fillore, apo mësimeve të shkollave të mesme?

Një tjetër objektivi hulumtues ka qenë matja e dallimeve në qëndrimet e mësimeve të shkollave fillore dhe atyre të mesme, ndaj kurrikulës së re. Qëndrime më pozitive ndaj kurrikulës së re, kanë shprehur mësimeve të klasës VI-IX – nga Niveli i mesëm i ulët. 64 përqind e mësimeve të klasës VI-IX kanë shprehur qëndrime më pozitive ndaj kurrikulës së re; pastaj 22 përqind e mësimeve të klasës X-XII (I mesëm i lartë) dhe krejt në fund, me qëndrime pozitive ndaj kurrikulës së re, ishin mësimeve të klasës I-V (Fillor). Sikurse tregon *Grafikoni 62*, mësimeve të niveleve të ndryshme fillore, dallojnë në qëndrimet e tyre pozitive apo negative ndaj kurrikulës së re.



**Grafikoni 62.** Matja e qëndrimeve pozitive varësisht nga cikli shkollor ku punojnë mësimeve

### 3.4.5. Sa ndikon ora e shkurtër mësimore në rritjen e sfidave për zbatimin efikas të kurrikulës së re?

Ora e shkurtër mësimore është përmendur nga shumica e respondentëve si sfidë në zbatimin efikas të kurrikulës së re. Në hipotezën tonë se, ora e shkurtër mësimore ndikon si sfidë për të pasur shkallë më të lartë të pakënaqshmërisë ndaj kurrikulës së re, nga rezultatet e gjetura hulumtuese, konfirmohet thuajse plotësisht.


91 përqind e respondentëve kanë deklaruar se ora e shkurtër mësimore ndikon shumë në rritjen e sfidave për zbatim efikas të kurrikulës së re; 8 përqind kanë deklaruar se ndikon mesatarisht, 1 përqind se ndikon pak dhe asnjëri nuk ka pohuar se nuk ndikon aspak. *Grafikoni 63* konfirmon thuajse plotësisht këtë hipotezë.



**Grafikoni 63.** *Ndikimi i orës së shkurtër mësimore në rritjen e sfidave për zbatimin efikas të kurrikulës së re*

### 3.4.5.1. A do të duhej sipas mësimeve të zgjatej ora mësimore për t'u përshtatur me kurrikulën e re parauniversitare?


Shumica e mësimeve kanë deklaruar se kurrikula nuk mund të zbatohet pa zgjatje të orës mësimore, por ka edhe të tillë, që nuk pajtohen krejtësisht me këtë. Një nga hipotezat e tjera ndihmëse ka qenë edhe zgjatja e orës mësimore do të ndikonte në përshtatjen me kurrikulën e re parauniversitare. 51 përqind e respondentëve janë pajtuar shumë se kurrikula nuk mund të zbatohet pa zgjatje të orës mësimore deri në 60 minuta; 24 përqind janë pajtuar minimalisht; 15 përqind nuk janë pajtuar, 8 përqind e respondentëve kanë pasur qëndrim neutral dhe vetëm 2 përqind nuk janë pajtuar aspak. *Grafikoni 64* e konfirmon pjesërisht hipotezën tonë ndihmëse, ngase ka pasur edhe shumë respondentë, të cilët nuk pajtohen me këtë.



**Grafikoni 64.** Zgjatja e orës mësimore deri në 60 minuta në zbatimin e kurrikulës

### 3.4.6. Sa shpenzojnë kohë mësime për t'i realizuar përgjegjësitë që kërkohen nga ta me kurrikulën e re?

Ndër ankesat e mësimeve që zbatojnë kurrikulën e re parauniversitare, ka qenë edhe numri i orëve të shpenzuara, për aspektet teknike-përgaditore para mbajtjes së një ore mësimore dhe më tej. Shumica e respondentëve, përkatësisht 46 përqind e mësimeve kanë deklaruar se shpenzojnë kohë për zbatimin e kurrikulës para mbajtjes së një ore mësimore, 2-4 orë në ditë; 30 përqind e tyre se shpenzojnë 1-2 orë në ditë, dhe 24 përqind kanë pohuar se shpenzojnë kohë mbi 4 orë në ditë.



**Grafikoni 65.** Koha e shpenzuar në zbatimin e kurrikulës para mbajtjes së një ore mësimore

## PËRFUNDIME

Kosova në përgjithësi ka arritur rezultate në fushën e reformave, dokumenteve dhe ligjeve për rregullimin e veprimtarisë së arsimit parauniversitar dhe kurrikulumin. Janë miratuar një sërë ligjesh në Kuvendin e Kosovës; janë miratuar një sërë dokumentesh dhe udhëzimesh nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të cilat tregojnë në detaje rreth kurrikulave bërthamë, kurrikulave për çdo fushë, për çdo shkallë kurrikulare, për çdo temë, për çdo lëndë dhe për çdo njësi mësimore. Kurrikula e Kosovës është pjesë integruese edhe e kurrikulave evropiane, përkatësisht shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, por edhe dallon me veçoritë e saj të teksteve jo aq cilësore mësimore, me infrastrukturë akoma joefikase etj. Kosova ka ligjet dhe dokumentet e saj në përputhje edhe me shumë shtete anëtare të BE-së dhe me dokumentet e kësaj superstrukture politike, e cila synon që vendet e Ballkanit Perëndimor, t'i integrojë në gjirin e saj. Shumë modele evropiane dhe ato nga Shqipëria, janë transferuar edhe në Kosovë dhe sot mund të shohim shumë ngjashmëri të kurrikulave evropiane me kurrikulën kosovare. Për dallim nga ta, në Kosovë ka më pakrahasueshëm më pak kushte për të rritur cilësinë e sistemit arsimor, infrastrukturën, stabilitetin më të madh ekonomik dhe social të shoqërisë së gjerë etj., të cilët faktorë ndikojnë në përgjithësi për cilësinë dhe zbatimin e kurrikulave efikase.

Në Kosovë, për dy dekada me radhë, janë bërë disa reforma në arsim, duke kaluar nga mësimdhënia me në qendër arsimtarin, në atë me në qendër nxënësin. Dhuna në shkolla siç ka qenë normale dhe e cilësuar si 'mjet pedagogjik', ka rënë në masë të madhe. Janë ndërtuar qindra shkolla të reja pas luftës dhe janë renovuar po ashtu. Shumë laboratë janë pajisur me mjete teknologjike, ndonëse akoma nuk janë të mjaftueshme për të gjithë nxënësit dhe klasët. Kurrikula ka ndryshuar edhe për gjuhë të reja, duke u lënë më anash gjuha frënge e latine dhe kurrikula e re, duke i dhënë përparësi, si gjuhë të huaj të parë, gjuhës angleze dhe si gjuhë të dytë të huaj, gjuhës gjermane. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka arritur të ketë më shumë përvojë krahasuar me kohën e administrimit ndërkombëtar menjëherë pas luftës në Kosovë.

Me hulumtimin e matjes së qëndrimeve të mësimdhënësve kosovarë ndaj Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës, ne iu kemi përgjigjur disa pyetjeve hulumtuese/kërkimore. Në pyetjen: Cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve kosovarë ndaj Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar dhe Qasjes Integruese Evropiane? Përgjigjet e

mësimdhënësve kanë qenë nga më të ndryshmet dhe opionioni ishte i ndarë në pozicione kundërshtuese. Një nga pyetjet kryesore të hulumtimit ka qenë të kuptuarit e dallimeve në qëndrimet ndaj kurrikulës parauniversitare, varësisht nga përvoja e mësimdhënësve në arsim. Nga *Grafikoni 59*, e pamë se shumica dërmuese e mësimdhënësve me përvojë mbi 10 vjet në arsim, përkatësisht, 59 përqind e tyre, kanë deklaruar se “pajtohen shumë se kurrikula nuk duhet të ndryshon aq shpesh”, 30 përqind e atyre me përvojë prej 5-10 vjet në arsim, si dhe më së paku janë pajtuar me këtë pohim, mësimdhënësit me përvojë të re, gjegjësisht nën 5 vjet përvojë në arsimin parauniversitar.

Në pyetjen ndihmëse: Sa ka dallime në qëndrimet ndaj kurrikulës universitare, varësisht nga përvoja e mësimdhënësve në arsim? Nga *Grafikoni 59*, shiheshin dallime në qëndrime, varësisht prej përvojës së mësimdhënësve në arsim. Ata dhe ato që kanë përvojë mbi 10 vjet në arsim, nuk duan të ndryshon aq shpesh kurrikula universitare, janë më konservatorë dhe më rezistencë ndaj kurrikulave të reja, ndërsa më së shumti që duan kurrikula të ndryshon shpesh, janë mësimdhënësit me përvojë të re, nën 5 vjet përvojë në arsim. Në pyetjen e 6 të pyetësorit, në pohimin “Zbatimi i kurrikulës, varet më së shumti nga:”, kishim renditur këto alternativa: a) Cilësia e mësimdhënësve; b) Mjetet e konkretizimit në dispozicion; c) Numri i nxënësve; d) Mënyra e menaxhimit të përgjithshëm të shkollës; e) Shkalla më e madhe e monitorimit nga inspektorët e arsimit; f) Ndryshimi i teksteve mësimore-shkollore. Shumica e respondentëve e kanë theksuar numrin e nxënësve si faktor në zbatimin e kurrikulës; 23 përqind mjetet e konkretizimit në dispozicion; 23 përqind të tjerë mënyrën e menaxhimit të përgjithshëm të shkollës; 14 përqind cilësinë e mësimdhënësve; 3 përqind shkallën më të madhe të monitorimit nga inspektorët e arsimit, dhe 3 përqind të tjerë ndryshimin e teksteve mësimore-shkollore (*Grafikoni 21*).

Në pyetjen se a janë mësimdhënësit me përvojë më të gjatë se 10 vjet në arsim, më konservatorë në raport me reformat në kurrikulën parauniversitare, po ashtu përgjigjet janë pohuese. 10 përqind e mësimdhënësve me përvojë mbi 10 vjet në arsim, kanë deklaruar se nuk pajtohen aspak se kurrikula nuk duhet të ndryshon aq shpesh; 20 përqind e mësimdhënësve me përvojë 5-10 vjet në arsim, kanë deklaruar të njëjtën gjë, ndërsa më së shumti me përgjigje të tillë, 70 përqind e respondentëve, përkatësisht 70 përqind e mësimdhënësve me përvojë të re nën 5 vjet në arsim. Edhe *Grafikoni 60* e konfirmon pranimin e pjesërishëm të hipotezës se, ka dallime në raport me reformën kurrikulare parauniversitare, varësisht nga përvoja në arsim. Mësimdhënësit me përvojë nën 5 vjet në arsim, nuk janë pajtuar aspak, duke shprehur qëndrim kategorik refuzues, nëse thuhet se kurrikula duhet të ndryshon aq shpesh. Shumica e respondentëve rreth çështjes së njëjtë, 77

përqind e tyre janë pajtuar mesatarisht me këtë; 10 përqind nuk janë pajtuar aspak, 7 përqind janë pajtuar shumë, dhe vetëm 6 përqind janë pajtuar pak (*Grafikoni 20*). Në konstatimin se “Unë dua të ndryshon vazhdimisht kurrikula”, kemi pasur qëllim të kuptonim shkallën e përputhjes për çështjen e njëjtë. Përgjigjet e respondentëve sikur tregojnë *Grafikoni 30*, dëshmojnë për një qëndrueshmëri të qëndrimeve të respondentëve në këtë hulumtim dhe mungesë të disonancës. Në konstatimin e parë, shkalla e mospajtit ekstrem për ndryshimet e kurrikulave, pamë se ishte shumicë dërmuese, 43 përqind e tyre, ishin deklaruar se “pajtohen shumë”, se nuk duan që kurrikula të ndryshon aq shpesh. Ndërsa në *Grafikonin 30*, shohim se respondentët shumicë, 47 përqind e tyre, nuk pajtohen se kurrikula të ndryshon vazhdimisht, 37 përqind nuk pajtohen aspak, 10 përqind neutralë, dhe vetëm nga 3 përqind e respondentëve, kanë përzgjedhur alternativën “Pajtohem shumë” (shkalla absolute) dhe “Pajtohem” (shkalla relative). Kjo tregon se qëndrimet e mësimit ndaj ndryshimit të kurrikulave janë më konservatore dhe nuk duan të ndryshojnë aq shpesh kurrikulat. Prandaj, për të pasur një qëndrim më pozitiv ndaj vetë kurrikulave, duhet të ketë më shumë debat me mësimit, pse nuk duan të ndryshojnë aq shpesh kurrikulat dhe në bazë të përgjigjeve të tyre, të ketë qasje tjetër ndaj kurrikulave dhe zbatimit të tyre.

Sikurse tregon *Grafikonime numër rendor 29*, 43 përqind e respondentëve kanë deklaruar se pajtohen shumë se nuk duan të ndryshon aq shpesh kurrikula, 20 përqind nuk janë pajtuar me këtë konstatim konservator ndaj ndryshimeve kurrikulare; 17 përqind janë pajtuar relativisht, 13 përqind nuk janë pajtuar aspak dhe vetëm 7 përqind kanë pasur qëndrime neutrale ndaj ndryshimeve të shpeshta të kurrikulave. Nga të dhënat e respondentëve tanë tregohet se, ka laramani në qëndrimet e mësimit ndaj ndryshimeve të shpeshta të kurrikulës parauniversitare, por shumica dërmuese e tyre, kanë pasur një qëndrim më konservator dhe më rezistent ndaj ndryshimeve kurrikulare (43 përqind kanë zgjedhur opcionin “Pajtohen shumë”, ndërsa vetëm 13 përqind kanë shprehur mospajtim ekstrem me opcionin “Nuk pajtohem aspak”). Analiza krahasuese e të dhënave gjatë prezantimit të të gjitha rezultateve, do të na tregojnë se kush janë më konservatorë ndaj ndryshimeve kurrikulare, cilat kategori dhe profile të mësimit; sa varet rezistenca ndaj kurrikulave të reja edhe nga faktorë të tjerë. Pra, mund të japim përfundimin e parë se mësimit me përvojë të re, duan ndryshime kurrikulare shpesh, për dallim nga mësimit me përvojë mbi 10 vjet, që nuk duan ndryshime aq të shpeshta të kurrikulave parauniversitare. Hipoteza e parë, se ka dallime në qëndrime në mes të mësimit varësisht nga përvoja në arsimin parauniversitar, konfirmohet pjesërisht, jo plotësisht.



Sa i përket optimizmit të mësimdhënësve ndaj ndryshimit pozitiv të kurrikulave, duke matur qëndrimet ndaj kurrikulës së vjetër dhe të re, në konstatimin “Kurrikulat e vjetra janë më të përshtatshme sesa kurrikulat e reja”, 37 përqind e respondentëve janë pajtuar relativisht se kurrikulat e vjetra janë më të përshtatshme se kurrikulat e reja; 23 përqind kanë mbajtur qëndrim neutral; 20 përqind nuk janë pajtuar relativisht, 17 përqind janë “Pajtuar shumë”, dhe vetëm 3 përqind nuk janë pajtuar aspak. Edhe për kurrikulat e vjetra apo të reja, qëndrimet e respondentëve janë të ndara, por shumica prej tyre i kanë favorizuar kurrikulat e vjetra si më të përshtatshme. Gjatë zbatimit të pyetësorit në hulumtimin tonë, kemi bërë disa nënpyetje rreth shkallës së kënaqësisë dhe pakënaqësisë me kurrikulën e re. Në pohimin “Unë jam shumë i-e kënaqur me kurrikulën e re”, 47 përqind nuk janë pajtuar relativisht; 30 përqind nuk janë pajtuar aspak; 13 përqind janë pajtuar relativisht; 7 përqind janë pajtuar shumë, dhe 3 përqind kanë pasur qëndrim neutral (shih *Grafikonin 8*).

Hipoteza se numri i madh i nxënësve ndikon në qëndrimet më negative ndaj kurrikulës së re, konfirmohet në masë të madhe. Ka gjasa që numri i nxënësve në klasë të ndikon në qëndrimet negative të mësimdhënësve kosovarë ndaj kurrikulës së re parauniversitare. Shumica dërmuese e respondentëve, përkatësisht, 70 përqind e tyre, kanë thënë se ndikon shumë numri i madh i nxënësve në klasë në qëndrimet negative ndaj kurrikulës së re; 16 përqind se ndikon mesatarisht, 4 përqind se ndikon pak dhe vetëm 2 përqind nuk ndikon aspak. *Grafikoni 61* e konfirmon në masë të madhe hipotezën se, qëndrimet negative ndaj kurrikulës janë të varura edhe nga numri i madh i nxënësve në klasë.

Për të kuptuar më shumë arsyet e sfidave në zbatimin e kurrikulës së re, ne kemi bërë disa nënpyetje të tjera, të cilat ndërlidhen me shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në zbatimin e kurrikulës. Një nga to është edhe numri i madh i nxënësve në çdo klasë, kohëzgjatja e orës mësimore etj. Në pohimin se “Kurrikula nuk mund të zbatohet me numër të nxënësve më shumë se 15 nxënës në klasë”, 40 përqind e respondentëve janë pajtuar relativisht, 23 përqind janë “Pajtuar shumë”, 14 përqind me qëndrim neutral, 13 përqind nuk janë pajtuar relativisht dhe 10 përqind nuk janë pajtuar aspak (*Grafikoni 10*). Se numri i nxënësve për çdo klasë ndikon në zbatimin e kurrikulës, e theksojnë edhe një numër i konsiderueshëm i respondentëve. Në *Grafikonin 36*, vërejmë se, 46 përqind e respondentëve janë pajtuar se kurrikula nuk mund të zbatohet nëse në klasë ka mbi 15 nxënës; 27 përqind e tyre janë pajtuar shumë; 10 përqind nuk janë pajtuar aspak; 10 përqind me qëndrim neutral, dhe 7 nuk

janë pajtuar (*Grafikoni 36*). Këto të dhëna tregojnë se, shumica e respondentëve, duke mbledhur respondentët me qëndrim mospajtues maksimal dhe minimal, 73 përqind e respondentëve besojnë se kurrikula nuk mund të zbatohet në rast se ka në klasë më shumë se 15 nxënës. Shumica dërmuese pajtohen me efektin e nxënësve në zbatimin e kurrikulës, por ka edhe nga respondentët, të cilët nuk e shohin efektin e nxënësve në zbatimin e kurrikulës, pavarësisht se numri i këtyre të fundit, është pakrahasueshëm më i vogël, me numrin mbizotërues të atyre që pajtohen. Pra, mund ta japim edhe përfundimin e dytë rreth hipotezës se numri i madh i nxënësve rrit qëndrimet negative ndaj zbatimit të kurrikulës, ka efekt të konsiderueshëm dhe konfirmohet në masë të gjerë edhe kjo hipotezë.

Se a ka dallime në qëndrimet e mësimit në mes të mësimit të nivelit të sistemit arsimor; se a kanë qëndrime më pozitive ndaj kurrikulës, mësimit në shkollave fillore, apo mësimit në shkollave të mesme, kemi vërejtur se ka dallime. Qëndrime më pozitive ndaj kurrikulës së re, kanë shprehur mësimit në klasës VI-IX – nga Niveli i mesëm i ulët. 64 përqind e mësimit në klasës VI-IX kanë shprehur qëndrime më pozitive ndaj kurrikulës së re; pastaj 22 përqind e mësimit në klasës X-XII (I mesëm i lartë) dhe krejt në fund, me qëndrime pozitive ndaj kurrikulës së re, ishin mësimit në klasës I-V (Fillor) me 14 përqind. Sikurse tregon *Grafikoni 62*, mësimit në niveleve të ndryshme fillore, dallojnë në qëndrimet e tyre pozitive apo negative ndaj kurrikulës së re. Sipas të dhënave të marra nga terreni dhe sikur e shohim në *Grafikonin 1*, rezultojnë se 46 përqind e mësimit në nivelit fillor, nuk janë pajtuar relativisht me konstatimin se, “nuk duan të ndryshojnë aq shpesh kurrikula”; 27 përqind e tyre nuk janë pajtuar aspak, 10 përqind janë pajtuar relativisht, 10 përqind kanë qenë asnjëherë (neutral), dhe vetëm 7 përqind e tyre janë pajtuar shumë. Nëse mbledhim të gjithë ata dhe ato që nuk janë pajtuar, del se shumica dërmuese e tyre, gjegjësisht 73 përqind e tyre nuk refuzojnë që kurrikula të ndryshojë shpesh. Vetëm 7 përqind e tyre, më së paku, janë paraqitur më konservatorë, duke mos pranuar shpesh ndryshimin e kurrikulave. Po ashtu, vijmë në përfundimin e tretë se, hipoteza jonë se ka dallime në qëndrimet e mësimit në mes të mësimit të nivelit të sistemit arsimor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë, konfirmohet në parim, por jo plotësisht.

Se sa ndikon ora e shkurtër mësimore në rritjen e sfidave për zbatimin e efikas të kurrikulës së re, gjetjet nga hulumtimi janë se, ora e shkurtër mësimore është përmendur nga shumica e respondentëve si sfidë në zbatimin e efikas të kurrikulës së re. Në hipotezën tonë se, ora e shkurtër mësimore ndikon si sfidë për të pasur shkallë më të lartë të pakënaqshmërisë

ndaj kurrikulës së re, nga rezultatet e gjetura hulumtuese, konfirmohet thuajse plotësisht. 91 përqind e respondentëve kanë deklaruar se ora e shkurtër mësimore ndikon shumë në rritjen e sfidave për zbatim efikas të kurrikulës së re; 8 përqind kanë deklaruar se ndikon mesatarisht, 1 përqind se ndikon pak dhe asnjëri nuk ka pohuar se nuk ndikon aspak. *Grafikoni 63* konfirmon gati plotësisht këtë hipotezë. Në parim, ora mësimore në shkollat e Kosovës zgjat 45 minuta. Në pohimin se “Kurrikula nuk mund të zbatohet me orën aktuale e të shkurtër mësimore”, 35 përqind e respondentëve janë pajtuar maksimalisht; 34 përqind janë pajtuar relativisht; 17 përqind nuk janë pajtuar; 7 përqind nuk janë pajtuar aspak dhe, 7 përqind kanë mbajtur qëndrim neutral (*Grafikoni 11*). Në pyetjen se “Kurrikula nuk mund të zbatohet me orën aktuale e të shkurtër mësimore”, qëndrimet e mësimitdhënësve të klasës prej VI-IX, janë si në vijim: 40 përqind e tyre janë pajtuar relativisht, 30 përqind janë pajtuar shumë, 17 përqind nuk janë pajtuar aspak, 10 përqind nuk janë pajtuar relativisht, dhe vetëm 3 përqind kanë mbajtur qëndrimin neutral (*Grafikoni 37*). Kurse sa i përket vazhdimin të orës mësimore prej 45 minutash në 60 minuta, edhe qëndrimet e mësimitdhënësve të klasës VI-IX, janë të shumëllojshme. Në *grafikonin 38*, gjejmë se 33 përqind e respondentëve, nuk janë pajtuar relativisht për zgjatjen e orës mësimore deri në 60 minuta, për ta zbatuar me efikasitet kurrikulën; 20 përqind janë pajtuar relativisht, 20 përqind janë pajtuar shumë, 20 përqind nuk janë pajtuar aspak dhe 7 përqind me qëndrim neutral.

Ndërsa rreth pengesave që mund të vijnë nga numri aktual i nxënësve dhe ora e shkurtër mësimore për zbatimin e kurrikulave, edhe këtu ka qëndrime të ndryshme. 43 përqind e respondentëve janë pajtuar shumë, se këto janë pengesa për zbatimin kurrikular; 40 përqind janë pajtuar lehtësisht; 10 përqind nuk janë pajtuar relativisht dhe 7 përqind nuk janë pajtuar aspak se numri i nxënësve dhe ora aktuale mësimore është pengesë në zbatimin e kurrikulës (*Grafikoni 39*). *Se a do të duhej sipas mësimitdhënësve të zgjatej ora mësimore për t’u përshtatur me kurrikulën e re parauniversitare*, shumica e mësimitdhënësve kanë deklaruar se kurrikula nuk mund të zbatohet pa zgjatje të orës mësimore, por ka edhe të tillë, që nuk pajtohen krejtësisht me këtë.

Një nga hipotezat e tjera ndihmëse ka qenë edhe zgjatja e orës mësimore se a do të ndikonte në përshtatjen me kurrikulën e re parauniversitare. 51 përqind e respondentëve janë pajtuar shumë se kurrikula nuk mund të zbatohet pa zgjatje të orës mësimore deri në 60 minuta; 24 përqind janë pajtuar minimalisht; 15 përqind nuk janë pajtuar, 8 përqind e respondentëve kanë pasur qëndrim neutral dhe vetëm 2 përqind nuk janë pajtuar aspak. *Grafikoni 64* e konfirmon pjesërisht hipotezën tonë ndihmëse, ngase ka pasur edhe shumë

respondentë, të cilët nuk pajtohen me këtë. Në supozimin se “Kurrikula nuk mund të zbatohet pa zgjatur orën mësimore deri në 60 minuta”, 43 përqind e respondentëve nuk janë pajtuar relativisht; 23 përqind nuk janë pajtuar aspak; 17 përqind janë pajtuar relativisht; 10 përqind janë pajtuar shumë, si dhe, 7 përqind kanë mbajtur qëndrim neutral (*Grafikoni 12*).

Se sa ndikon zbatimi i kurrikulës së re në shpenzimin e madh të kohës në aspekte teknike, gjetjet nga hulumtimi na dërgojnë në atë se, ndër ankesat e mësimdhënësve që zbatojnë kurrikulën e re parauniversitare, ka qenë edhe numri i orëve të shpenzuara, për aspektet teknike-përgaditore para mbajtjes së një ore mësimore dhe më tej. Shumica e respondentëve, përkatësisht 46 përqind e mësimdhënësve kanë deklaruar se shpenzojnë kohë për zbatimin e kurrikulës para mbajtjes së një ore mësimore, 2-4 orë në ditë; 30 përqind e tyre se shpenzojnë 1-2 orë në ditë, dhe 24 përqind kanë pohuar se shpenzojnë kohë mbi 4 orë në ditë. Në pyetjen e tretë, “Ju konsideroni se shpenzoni kohë për zbatimin e kurrikulës para mbajtjes së një ore mësimore”, me alternativat a) 1-2 orë në ditë, b) 2-4 orë në ditë, c) Mbi 4 orë, dhe opcionin e fundit, d) Tjetër, 7 përqind e respondentëve janë përgjigjur se, shpenzojnë 2-4 orë në ditë në shpenzimin e kohës para mbajtjes së një ore mësimore për të zbatuar kurrikulën; 20 përqind 1-2 orë në ditë; 7 përqind mbi 4 orë (*Grafikoni 18*).

Kishte edhe respondentë të cilët besonin se kurrikula më shumë i humbte kohë teknikisht mësimdhënësve, sesa shtonte cilësinë e performancës së tyre në klasë. Lidhur me këtë, kemi bërë edhe një pyetje: “Kurrikula më shumë i humb kohë teknikisht mësimdhënësve, sesa shton cilësinë e performancës së tyre në klasë. Sa pajtoheni me këtë?” Shumica dërmuese e respondentëve, 47 përqind prej tyre, kanë pohuar se mesatarisht pajtohen me këtë; 27 përqind prej tyre janë pajtuar pak, 23 përqind nuk janë pajtuar aspak, dhe vetëm 3 përqind e tyre janë pajtuar shumë (*Grafikoni 23*). Në pyetjen “Kurrikula më shumë i humb kohë teknikisht mësimdhënësve, sesa shton cilësinë e performancës së tyre në klasë. Sa pajtoheni me këtë?”, shumica e respondentëve kanë qëndrime të ndryshme. 33 përqind kanë thënë se pajtohen pak, 30 përqind pajtohen shumë, 30 përqind pajtohen mesatarisht dhe vetëm 7 përqind nuk pajtohen aspak (*Grafikoni 53*).

Pra, hipoteza se rriten gjasat për qëndrime negative ndaj kurrikulës së re, edhe për shkak të kohës së shpenzuar për aspekte teknike parapërgaditore, qëndron, por pjesërisht, jo plotësisht.

Mund të përfundojmë se janë disa sfida në zbatimin e kurrikulës së re në arsimin parauniversitar në Kosovë:

- mospërputhja e kurrikulës me tekstet shkollore;
- mungesa e trajnimeve adekuate mbi kurrikulën;
- paqartësitë që kanë edhe vetë trajnerët në këto kurrikula;
- bashkë me mësimdhënësit; keqkuptimet mbi nocionet e dhëna në kurrikulë;
- duke u kuptuar ndryshe nga secili mësimdhënës;
- numri i madh i nxënësve në klasë në shkollat publike;
- pamundësia për t'iu përkushtuar kurrikulës së re si rezultat i përvojës së re me të dhe si risi; qëndrimet më konservatore të mësimdhënësve më të moshuar dhe me përvojë më të gjatë ndaj kurrikulës së re, duke shfaqur rezistencën ndaj të resë dhe duke u përpjekur të ruajnë të vjetrën dhe ekzistuesen;
- cilësia e dobët e arsimit që nxjerr kuadro jo me profesionalizëm të lartë nga universitetet dhe fakultetet e mësuesisë;
- shpenzimi i madh i kohës për të regjistruar çdo gjë sipas kurrikulës së re, si dhe humbja e kohës më shumë në aspektet e të dokumentuarit, sesa marrja me përmbajtjen dhe zgjerimin e saj, duke shfrytëzuar më shumë burime informacionesh;
- mungesa e kushteve teknike-mësimore dhe shkollore, ashtu siç parashihen me kurrikulë;
- vështirësitë financiare për organizime transporti për të realizuar vizita në institucione të ndryshme, sikur e parasheh kurrikula;
- sfidat e orës së shkurtër dhe orëve-blok, duke u stërlodhur mësimdhënësit, edhe gjer në 6 orë njëpasnjëshëm me klasë të ndryshme;
- menaxhimi i dobët i shkollës nga drejtorët; monitorimi nga numër i vogël dhe i pamjaftueshëm i inspektorëve;
- mungesa e kuadrove të duhura profesionale të vetë inspektorëve të monitorimit pedagogjik; mungesa e pajisjeve teknologjike, si laptop, qasja në internet, për çdo klasë dhe në çdo kohë të nevojshme;
- punësimi dhe angazhimi në kontrata të rregullta e me zëvendësime të stafit të mësimdhënësve, me kritere jomeritokratike, por partiake e nepotiste; mungesa e kohës së mjaftueshme për të zbatuar kurrikulën e re, sidomos në fushën e vlerësimit etj.

## REKOMANDIMET

- Të organizohen trajnime të vazhdueshme mbi kurrikulën e arsimit parauniversitar, por duke qenë të trajnuar në mënyrë efikase edhe vetë trajnerët e mësimdhënësve;
- Të qartësohen më shumë disa nga nocionet dhe kërkesat që kërkohen në Kurrikulën e Re;
- Të qartësohen dallimet në mes të temave, njësive mësimore, rezultateve të të nxënit, kompetencat, duke u kuptuar edhe më shumë përmes debateve, konferencave dhe punëtorive, të organizuara enkas për mësimdhënësit;
- Drejtorët e shkollave, sikur mësimdhënësit, po ashtu të jenë të trajnuar për Kurrikulën e Re, në mënyrë që drejtorët të jenë po ashtu me mundësi për t'i monitoruar mësimdhënësit në shkollat e tyre përkatëse ku i drejtojnë, se a po e zbatojnë në mënyrë adekuate kurrikulën e re, apo jo;
- Të paktën të dyfishohet buxheti i shtetit në fushën e arsimit, e sidomos në ndarjen e buxhetit për komunat dhe drejtoritë komunale në arsim;
- Të ndryshohen urgjentisht tekstet mësimore shkollore, duke u përshtatur me kurrikulën e re, të gjitha botimet;
- Të furnizohen me kohë, me fillimin e vitit të ri shkollor, të gjithë nxënësit me tekstet e tyre mësimore, pasi që shpesh ka pasur raportime se nxënësit nuk janë furnizuar me libra, me kohë, nga Ministria e Arsimit;
- Të krijohen edhe më shumë shabllone apo modele vlerësimesh, duke dhënë ilustrime praktike, vizuele e teknike për mësimdhënësit, që ta kenë më shumë të qartë se çfarë kërkon kurrikula e re;

- Të nxiten shprehitë e të lexuarit të nxënësve dhe të debatohet në shkolla për këtë temë, pasi që nuk mund të ketë zbatim efikas të kurrikulës, nëse nuk përfshihen edhe më shumë nxënësit në procesin dhe orën mësimore;
- Të investohet në transportin publik falas për nxënësit, në mënyrë që të vizitojnë institucione të ndryshme sikurse e parasheh kurrrikula e re, me sa më shumë konkretizim të asaj që shpjegohet dhe mësohet në klasë;
- Të zbatohet kurrrikula e re dhe të kërkohet nga të gjithë mësimdhënësit të dërgojnë vërejtjet e tyre për kurrrikulën, duke marrë më pas masat e duhura, Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, si dhe Drejtoritë Komunale për Arsim;
- Të ketë më shumë bashkëpunime në mes të organizatave joqeveritare dhe shkollave e mësimdhënësve, edhe rreth kurrrikulës;
- Të shtohet numri i mësimdhënësve dhe mësimdhënësit të kenë jo orë të ngarkuara dhe të stërlodhen me orë mësimore të njëpasnjëshme;
- Të furnizohen falas me ditare dhe fletore pune të gjithë mësimdhënësit, si dhe të dizajnohen këto mjete didaktike, në atë mënyrë që të jenë të qarta e të kuptueshme;
- Të mos furnizohen mësimdhënësit me fletore pune, të cilat nuk përputhen me Kurrikulën e Re. Të pajisen të gjithë mësimdhënësit me laptopët e tyre personalë dhe në çdo klasë të ketë së paku nga një projector. Të shfrytëzohet më shumë teknologjia informative, interneti dhe burime të tjera elektronike, qoftë nga mësimdhënësit, qoftë nga vetë nxënësit, duke i mësuar këta të fundit se si ta shfrytëzojnë teknologjinë në mënyrë efikase. Të qartësohen më shumë mënyrat e zbatimit të Kurrikulës së Re të Arsimit Parauniversitar të Kosovës. Të përfshihen në kurrrikulën e re të gjitha klasët, e jo disa të mbesin me kurrrikulën e vjetër, e disa me kurrrikulën e re. Nëse vazhdon zbatimi i kurrrikulës vetëm në disa nivele të arsimit parauniversitar, do të ishte mirë të shfrytëzohej mundësia për studime krahasuese në rezultatet e nxënësve, për të kuptuar se a po ka më shumë efekt pozitiv apo negativ, kurrrikula e re dhe e vjetër, në sukseset e nxënësve.

## BIBLIOGRAFIA

### Literatura:

Bell, Ann. (2005). *Creating Digital Video In Your School: How To Shoot, Edit, Produce, Distribute And Incorporate Digital Media Into The Curriculum*. Washington: Linworth.

Burton, Neil & Brundrett, Mark. (2005). *Leading the Curriculum in the Primary School*. London: Paul Chapman Publishing.

Capon, Noel.(1996). *Planning the Development of Builders, Leaders and Managers for 21st-Century Business: Curriculum Review at Columbia Business School*. Boston/Dordrecht/London: Kluwer Academic Publishers.

Clark, L. John. (1987). *Curriculum Renewal in School Foreign Language Learning*. London: Oxford University Press.

Combs, W. Arthur & Miser, B. Ann & Whitaker, S. Kathryn. (1999). *On Becoming a School Leader: A Person-Centered Challenge*. Wirginia, USA: Association for Supervision & Curriculum Deve.

Cole, Mike. (2009).*Equality in the Secondary School: Promoting Good Practice Across the Curriculum*. Wirginia, USA: Association for Supervision & Curriculum Deve.

Curtis, Audrey. (1997). *A Curriculum for the Pre-School Child: Learning to Learn 2nd Edition*. London & New York: Routledge.

Dave Hill, Dave & Robertson, H. Leena. (2009).*Equality in the Primary School: Promoting Good Practice Across the Curriculum*. London: Continuum International Publishing Group.

D. Rivera, D. Ferdinand. (2011). *Toward a Visually-Oriented School Mathematics Curriculum: Research, Theory, Practice, and Issues*. Netherland: Springer Netherlands.

Evans, W. Ronald. (2011). *The Tragedy of American School Reform: How Curriculum Politics and Entrenched Dilemmas Have Diverted Us from Democracy*. London: Palgrave Macmillan.

Filer, Ann & Pollard, Andrew & Thiessen, Dennis. (1996). *Children And Their Curriculum: The Perspectives Of Primary And Elementary School Children*. Washington, DC: The Falmer Press.

Fourth Cycle MSIP. (2004).*A Guide for Developing Gifted Curriculum Documents*. Missouri: Pattonville School District.



- Franklin, M. Barry. (2010). *Curriculum, Community, and Urban School Reform*. London: Palgrave Macmillan.
- Goodson, F. Ivor. (1993). *School Subjects and Curriculum Change*. Washington DC:Routledge.
- Harvey & Pam Robbins. (2010). *Learning from Lincoln: Leadership Practices for School Success*. Virginia: Assn for Supervision & Curriculum.
- Kitson, Neil. (1996). *Effective Curriculum Management: Coordinating Learning in the Primary School*. London & New York: Routledge.
- Lewis, Martin & Rainer, John. (2005). *Teaching Drama and Theatre in the Secondary School: Classroom Projects for an Integrated Curriculum*. London & New York: Routledge.
- Macgillivray, K. Ian. (2003). *Sexual Orientation and School Policy: A Practical Guide for Teachers, Administrators, and Community Activists (Curriculum, Cultures, and (Homo)Sexualities)*. USA: Rowman & Littlefield Publishers, Inc.
- Marzano, J. Robert & Waters, Timothy & Mcnulty, A. Brian. (2005). *School leadership that works: From Research to Results*. USA: Association for Supervision & Curriculum Deve.
- Mathematical Sciences Education Board, National Research Council. (1990). *Reshaping School Mathematics: A Philosophy and Framework for Curriculum (Perspectives on School Mathematics)*. Washington, DC: National Academies Press.
- Muller, Johan. (2000). *Reclaiming Knowledge Social Theory, Curriculum and Education Policy*. London and New York: RoutledgeFalmer.
- Neziri, Mensur. (2018). *Kurrikula mësimore dhe të menduarit kritik*. Prishtinë: Rozafa.
- Nias, Jennifer & Southworth, Geoff & Campbell, Penelope. (1992). *Whole School Curriculum Development in the Primary School*. London & Washington, DC: The Falmer Press.
- Patterson, L. Jerry & Kelleher, Paul. (2005). *Resilient School Leaders: Strategies for Turning Adversity into Achievement*. Virginia: Association for Supervision & Curriculum Development.
- Perry, Nancy & Vanzandt, Zark. (2006). *Exploring Future Options: A Career Development Curriculum for Middle School Students*. New York: IDEBATE Press Books.
- Rivera, D. Ferdinand. (2011). *Toward a Visually-Oriented School Mathematics Curriculum: Research, Theory, Practice, and Issues*. USA: Springer.
- Reeves, B. Douglas. (2004). *Accountability for Learning: How Teachers and School Leaders Can Take Charge*. Virginia, USA: Association for Supervision & Curriculum Deve.

- Richard A. Villa, A. Richard & Thousand, S. Jacqueline. (2005). *Creating An Inclusive School*. Virginia, USA: Association for Supervision & Curriculum Deve.
- Rose, Heather & Julian R. Betts, R. Julian. (2001). *Math Matters: The Links Between High School Curriculum, College Graduation, and Earnings*. San Francisco, CA: Public Policy Institute Of California.
- Sally, Judith & Sally, Paul. (2003). *TriMathlon: A Workout Beyond the School Curriculum*. USA: A K Peters/CRC Press.
- Smith, K. Peter. (2001). *Psychology of Education: Major Themes, Vol. III - The school curriculum (Major Writings in Education)*. London & New York: RoulledgeFalmer.
- Stanley. B. Willian. (1992). *Curriculum for Utopia: Social Reconstructionism and Critical Pedagogy in the Postmodern Era (S U N Y Series, Teacher Empowerment and School Reform)*. New York: State Univ of New York Pr.
- Themes, Major. (2004). *Psychology of education*. London: Taylor & Francis e-Library.
- Thobani, Shiraz. (2010). *Islam in the School Curriculum*. London: Continuum International Publishing Group.
- Waters, Mick. (1999). *Coordinating the Curriculum in the Smaller Primary School (Subject Leaders Handbooks)*. London: Taylor & Francis Group.
- Whitty, Geoff. (1986). *Sociology and School Knowledge: Curriculum Theory, Research and Politics (Education Paperback)*. London: Taylor & Francis.
- Wright, M. Cora. (2002). *More hot links: Linking Literature with the Middle School Curriculum*. Colorado, USA: Libraries Unlimited.
- White, John. (2004). *Rethinking the school curriculum: values, aims and purposes*. London: RoutledgeFalmer.

## Burimet elektronike:

- European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2012). *Curriculum reform in Europe -The impact of learning outcomes*. Marrë prej [http://www.cedefop.europa.eu/files/5529\\_en.pdf](http://www.cedefop.europa.eu/files/5529_en.pdf)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). *Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës*. Marrëmë 10 Dhjetor 2017, prej <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/9ligji-i-arsimit-ne-komuna2008-03-1068-al-ar-se-kom.pdf>
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2006). *Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik*. Marrë më 10 Dhjetor 2017, prej <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/8-lbtmldp-2008-03-1048.pdf>
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011). *Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës*. Marrë më 10 Dhjetor 2017, prej <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/1-ligji-per-arsimin-parauniversitar.pdf>
- Leslie Owen Wilson, Leslie. (n.d.). Types of curriculum with their definitions. Marrë prej <https://thesecondprinciple.com/instructional-design/types-of-curriculum/>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Dokumentacioni shkollor (pa datë). Marrë më 9 Dhjetor 2017 prej <http://masht.rks-gov.net/dokumentacioni-shkollor>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar)*. Marrë më 9 Dhjetor 2017 prej <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). *Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (klasat 0, i, ii, iii, iv dhe v) (e rishikuar)*. Marrë më 10 Dhjetor 2017 prej <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). *Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës (gjimnazet - klasa x, xi, xii) (e rishikuar)*. Marrë më 10 Dhjetor 2017 prej <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-berthame-3-final.pdf>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Udhërrëfyes për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021. Marrë më 10 Dhjetor 2017 prej <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/udherrefyesh-per-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (pa datë). *Planprogramet*. Marrë më 10 Dhjetor 2017 prej <http://masht.rks-gov.net/planprogramet-1>

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2013). *Planprogramet e rishikuara të lëndëve të përgjithshme të arsimit profesional 2013*. Marrë më 9 Dhjetor 2017 prej <http://masht.rks-gov.net/planprogramet-e-rishikuara-te-lendeve-te-pergjithshme-te-arsimit-profesionale-2013-te-final>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë - Drejtoria e Zhvillimit të Kurrikulës, 2005. <http://www.unitir.edu.al/index.php/rreth-nesh/organizimi/drejtorite/drejtoria-e-kurrikules-dhe-standarteve>

Ontario Institute for Studies in Education/University of Toronto. (Qasur nga Instituti më 30.7.2014 dhe pa datë të publikimit). *Curriculum Theory: Give Me a “For Instance” nga Herbert M. Kliebard*. Marrë prej <https://talkcurriculum.files.wordpress.com/2014/09/kliebard-h-1977-curriculum-theory-give-me-a-for-instance.pdf>

Official Journal of the European Union, 2006. Marrë prej <https://eur-lex.europa.eu/oj/2006/10/direct-access.html?ojYear=2006>

School of Education-Oregon State Universit. (1998). *Integration of the Disciplines Politics of Education*. Marrë prej <http://oregonstate.edu/instruction/ed555/zone2/politics.htm>

## SHTOJCA 1 - PYETËSORI

### PYETËSOR

---

Ky pyetësor zbatohet në kuadër të hulumtimit të tezës së doktoratës me temë: *"Qëndrimet e mësimdhënësve kosovarë ndaj Kornizës së Kurrikulës së Arsimit parauniversitar 2016-2021 dhe qasjes së saj integruese evropiane"*, në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Identiteti i secilit dhe secilës respondentë mbrohet në përputhje me etikën profesionale hulumtuese dhe të dhënat e juaja vetëm janë ndihmesë për të kuptuar qëndrimet e mësimdhënësve ndaj kurrikulës së re.

### I. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

**Mosha:** \_\_\_\_

**Gjinia:** \_\_\_\_

**Përvoja në mësimdhënie:**

- Nën 5 vjet
- 5-10 vjet
- Mbi 10 vjet

**Shkolla:**

- Filllore
- E mesme e ulët
- E mesme e lartë

**Vendbanimi i shkollës:**

- Qendër e qytetit
- Periferi e qytetit
- Fshat

**Punoni me:**

- Kurrikulën e re
- Kurrikulën e vjetër

1. Ju lutemi, t'i plotësoni rubrikat e zbrazëta, duke treguar shkallën e pajtimit dhe mospajtimit me konstatimet e shënuara në anën e majtë!

	Pajtohem shumë	Pajtohem	Neutral	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
<b>NDRYSHIMI I KURRIKULAVE</b>					
Unë nuk dua të ndryshon aq shpesh kurrikula.					
Unë dua të ndryshon kurrikula vazhdimisht.					
Unë dua të ndryshon kurrikula në përputhje me rrethanat dhe mundësitë në Kosovë.					
Unë dua të ndryshon kurrikula në përputhje me kurrikulën e Shqipërisë.					
Unë dua të ndryshon kurrikula në përputhje me shtetet skandinave si Suedia Danimarka, Norvegjia etj.					
Unë jam për një kurrikulë mbarëkombëtare, ku do të ishte e njëjtë për të gjithashkollatshqipe kudo që janë.					
Kurrikulat e vjetra janë më të përshtatshme sesa kurrikulat e reja.					
<b>NUMRI I NXËNËSVE DHE ORA MËSIMORE</b>					
Kurrikula nuk mund të zbatohet me numër të nxënësve më shumë se 15 nxënës në klasë.					
Kurrikula nuk mund të zbatohet me orën aktuale e të shkurtër mësimore.					
Kurrikula nuk mund të zbatohet pa orar të zgjatur të orës mësimore deri në 60					

minuta.					
Kurrikula nuk mund të zbatohet pa rritur numrin e mësimdhënësve.					
Numri aktual i nxënësve dhe ora aktuale mësimore nuk janë fare pengesa në zbatimin e kurrikulës së re.					
<b>Qëndrimet ndaj kurrikulës së vjetër dhe të re</b>					
Unë jam shumë i-e kënaqur me kurrikulën e re.					
Unë jam shumë i-e kënaqur me kurrikulën e vjetër.					
Unë jam i-e kënaqur edhe me kurrikulën e vjetër, edhe me të vjetrën.					
Duhet të ndryshohen paraprakisht të gjitha tekstet mësimore-shkolllore, para se të ndryshohet kurrikula e arsimit parauniversitar.					
<b>Trajnimi i mësimdhënësve</b>					
Zbatimi i kurrikulës varet kryesisht prej shkallës dhe cilësisë së trajnimit të mësimdhënësve për këtë kurrikulë.					
Trajnimi i mësimdhënësve për kurrikulë të re bëhet nga trajnerë profesionistë.					
Trajnimet janë të shkurtëra, prandaj janë joefikase.					
<b>Komenti shtesë:</b>					

2. Sipas jush, cilat janë tri sfidat më të mëdha në zbatimin e kurrikulës?

- a. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

3. Ju konsideroni se shpenzoni kohë për zbatimin e kurrikulës para mbajtjes së një ore mësimore:

- a. 1-2 orë në ditë
- b. 2-4 orë në ditë
- c. Mbi 4 orë
- d. Tjetër \_\_\_\_\_

4. Sa mendoni se ndikon vetëlloji i kurrikulës në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në përgjithësi?

- a. Aspak
- b. Pak
- c. Mesatarisht
- d. Shumë

5. “Mësimdhënësit me përvojë të gjatë në arsim janë më konservatorë në pranimin e kurrikulave të reja, sesa mësimdhënësit me përvojë të re.” Sa pajtoheni me këtë opinion?

- a. Aspak
- b. Pak
- c. Mesatarisht
- d. Shumë

6. Zbatimi i kurrikulës, varet më së shumti nga:

- a. Cilësia e mësimdhënësve
- b. Mjetet e konkretizimit në dispozicion
- c. Numri i nxënësve
- d. Mënyra e menaxhimit të përgjithshëm të shkollës
- e. Shkalla më e madhe e monitorimit nga inspektorët e arsimit
- f. Ndryshimi i teksteve mësimore-shkollore

7. Cilat janë sipas jush, disa nga dobësitë e kurrikulës me të cilën punoni ju aktualisht?

---

---

---

---

---



---

---

---

---

---

---

8. Kurrikula aktuale me të cilën punoni ju, është më e përshtatshme:

- a. Vetëm për ndonjë lëndë
- b. Për të gjitha lëndët
- c. Për asnjë lëndë

9. Kurrikula më shumë i humb kohë teknikisht mësimdhënësve, sesa shton cilësinë e performancës së tyre në klasë. Sa pajtoheni me këtë?

- a. Aspak
- b. Pak
- c. Mesatarisht
- d. Shumë

10. Kurrikula e re është sfidë vetëm për:

- a. Mësimdhënësit me përvojë të re në arsim
- b. Mësimdhënësit me përvojë as të shkurtër dhe as të gjatë
- c. Mësimdhënësit me përvojë të gjatë në arsim
- d. Për të gjithë mësimdhënësit, pavarësisht shkallës së përvojës në arsim
- e. Për asnjë mësimdhënës, pavarësisht shkallës së përvojës në arsim

11. Kurrikula aktuale është më praktike për:

- a. Punën individuale të nxënësve në klasë
- b. Punën në çifte të nxënësve në klasë
- c. Punën grupore të nxënësve në klasë
- d. Nuk varet fare kurrikula për metodat punës me nxënësit

12. Sa jeni të kënaqur me përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e nxënësve me kurrikulën që punoni?

- a. Aspak i kënaqur
- b. I kënaqur
- c. Mesatarisht i kënaqur
- d. Shumë i kënaqur

13. Cili vlerësim ka qenë më i drejtë sipas jush?

- a. Vlerësimi i nxënësve me kurrikulën e mëhershme
- b. Vlerësimi i nxënësve me kurrikulën e re
- c. Me asnjërin kurrikulë, vlerësimi nuk është më i drejtë, por varet prej mësimdhënësve

14. Si i vlerësoni tekstet shkollë-mësimore për zbatimin e efikas të kurrikulës së re?

- a. Aspak të përshtatshme
- b. Pak të përshtatshme
- c. Mesatarisht të përshtatshme
- d. Shumë të përshtatshme

15. Sa mendoni se i kemi kushtet e volitshme në shkollat tona, për të zbatuar modele kurrikulare evropiane?

- a. Aspak
- b. Pak
- c. Mesatarisht
- d. Shumë

***Ju faleminderit shumë për bashkëpunimin tuaj!***